

Faruk Shehiq (lindur në vitin 1970 në Bihaq) është një nga zërat më të fuqishëm të brezit letrar të formuar nga përvojat e luftës në ish-Jugosllavi. Ish-komandant njësie gjatë luftës në Bosnjë, pas përfundimit të saj iu kthye letërsisë dhe u bë autor i njohur për prozën dhe poezinë e tij që ndërthur kujtesën, traumën dhe natyrën si forca kundërshtuese ndaj shkatërrimit. Kritikët letrarë e kanë vlerësuar Shehiq-in si zërin kryesor të brezit të shkrimtarëve të lindur në Jugosllavinë e viteve 1970, dhe librat e tij fituan lexues në të gjithë rajonin dhe e kanë bërë atë një emër të njohur në Europë. Jeton në Sarajevë, ku punon si kolumnist dhe gazetar në gazetën “Oslobodjenje”.

FARUK SHEHIQ

Kam qenë shumë herë pranë vdekjes, saqë mendoj se ajo më ka mbajtur gjallë.

Bisedoi: Milena Selimi



Nuk na e lanë ta jetojmë jetën, Lili!

Ju tregoj për tim atë, poetin Vehbi Skënderi

Nga Elida Buçpapaj

(fq. 8)

Ishte një mbrëmje e bukur qershori. 12 qershor 2011. Nga ato më të bukurat e vitit, kur stina e verës është në prag të shpërthimit me plotmadhësinë e vet prej shumëlaryshisë së ngjyrave, që ngjan si një fillim pa fund e të grish vetëm të jetosh pa sosje. Atëherë kur çdo shpirt njerëzor beson se jeta është e përherëshme, im Atë, poeti Vehbi Skënderi po luftonte me vdekjen.



NDAHEN ÇMIMET E PANAIRIT “LIBRI TË BAN TË LIRE”

(fq. 21)

Me datë 7 qershor, u mbyll edicioni i parë i panairit “Libri të ban të lirë”, organizuar nga Katedralja në qytetin e Shkodrës. Pas dy ditëve plot aktivitete, me promovime dhe lexime autoriale, komisioni organizativ i Panairit ndau edhe katër çmime, duke vlerësuar kontributin e pikasur në fusha të ndryshme.

SHËNIME MBI LIBRAT

FUQIA E FJALËS NË POEZINË E AZEM SHKRELIT

Nga Ali Aliu

(fq. 5)

“Në emër të gjakut” i Ahmet Prençit, “MediaPrint”

Një dëshmi për brezat e ardhshëm

Nga Ajne Ibërhysaj

(fq. 10)

Vështrim i romanit “Gega i Motit” të Ernest Markut

Nga Mirela Papuçiu

(fq. 12)



Ç’është dashuria në prozën e Mira Meksit?

Nga Floresha Dado

(fq. 6)

Nëna e Tolstoit, gruaja misterioze që u bë nëna e një gjeniu

Përktheu Bujar Hudhri



BIBLIOTEKË

Luljeta Lleshanaku

(fq. 14)

Mjerimi i grimcave

Gellu Naum

(fq. 16)

Kalimi nëpër lëkurë

Përktheu: Luan Topciu

Stefan Çapaliku

(fq. 18)

WC

Gabriele D’annunzio

(fq. 19)

Shiu në pishnajë

Përktheu: Denis Gila

Biser Mehmeti

(fq. 20)

Macja me një sy

(fq. 21)

Ylli Pango

Kushëriri i partisë

Arben Meksi

(fq. 11)

Karikatura e së shtunës

“Vallëzim me hënën” i shkrimtarit
Namik Dokle prezantohet në tre
qytete të Spanjës

(fq. 12)

Botohet në Egjipt romani
“Vrasje në kryeministri” i
shkrimtares Diana Çuli

(fq. 13)

Botohet në Rumani romani
“Lindur së prapthi” i
shkrimtares Rita Petro

(fq. 24)

Nuk ka asnjë person apo vend në Ballkan që nuk e ka patur luftën e vet. Në gjuhën e Shekspirit apo të Virginia Woolf, lufta e vet bëhet edhe gjuha e vet. Si boshnjak, si quhet lufta jote dhe gjuha jote?

Lufta ime quhet “lufta jonë e vogël” apo “lufta jonë e parë”, siç e quaj në romanin *fiction* (me elemente autobiografike) *Letra kanelle, krijesa prej diamanti*. E quaj kështu në mënyrë ironike dhe auto-ironike, sepse lufta është personazh në romanin tim; është një qenie e lashtë dhe e pavdekshme që dëshiron të vdesë, sepse është bërë shumë e vjetër. Është ajo Lufta jonë e Parë që në realitet s’po vdes kurrë, sepse trashëgimia e saj — si ajo e çdo lufte tjetër — nuk mund të arkivohet përfundimisht. Pasojat e luftës nuk janë vetëm të vdekurit dhe të plagosurit, qytetet e djegura, apo vendi i shkatërruar, por pasoja kryesore është ajo dhimbja fantazmë – kur humbet një dorë por ndjen se të kruhet. Ashtu edhe ne të mbijetuarit kemi dhimbje fantazmë, ato janë në kujtimin tonë. Mendoj se lufta për të mbijetuarit mbaron vetëm kur ata nuk janë më gjallë. Lufta e çdokujt shkon në varr me atë që e ka përjetuar. Nëse ekziston një botë tjetër, atëherë edhe atje, në kokën e të vdekurit, vazhdon Lufta e tij e Parë. Ose ndoshta nuk ndodh kjo. Ndoshta fantazma e luftës e lëshon trupin e njeriut dhe shkon të parazitojë diku tjetër.

Mendoj se krijimtaria jote i përket Ballkanit por udhëton edhe drejt Europës dhe më tej si modus -shprehje e re letërsie. Si ndjehesh kur librat e tu përktthehen dhe botohen... a të jep botimi përtej kufijve edhe ndjenjën e lirisë?

Më vjen mirë që mendoni kështu. Sigurisht, librat e një shkrimtari u përkasin të gjithëve dhe duhet të udhëtojnë nëpër gjuhë të tjera – është një nder i madh dhe privilegj për një shkrimtar. Libri im bëhet trashëgimi shpirtërore e njerëzve që s’do t’i njoh kurrë në jetë. Libri jeton jetën e vet në përkthim – një jetë të re. Po, është ndjenjë e fuqishme lirie. Për mua, të jesh shkrimtar është ndjenjë e lirisë. Unë jam shkrimtar kozmopolit.

Në cilin qytet jashtë Bosnjës do të doje të jetoje? Ku ndihesh i lirë?

Mendoja se mund të ishte Berlina, por atje nuk ka shumë liri për momentin, nëse shikojmë mbështetjen gjermane për gjenocidin në Gaza. Gjithsesi e dua ende atë qytet dhe gjithmonë do të shkoja atje. Berlina është atdheu im shpirtëror, ndoshta në ndonjë jetë të kaluar, jam i sigurt që kam jetuar atje. Qyteti tjetër është, natyrisht, Stambolli – kërthiza e botës, qyteti më i gjallë në botë. Por me kalimin e kohës njeriu humbet dëshirën për të jetuar në qytete. Jeta pranë një lumi, apo liqeni në ndonjë gjysmë-dëbim më duket shumë më tërheqëse.

Koha – shpesh shkruan për të... thonë që Ballkani ka probleme me kohën. A ekziston një kohë ballkanike që mund të na bashkojë të gjithëve?

Na bashkon fakti që Ballkani është një kategori mendore. Sikur duam të mos i përkasim Europës, edhe pse e duam dhe e kemi zili në të njëjtën kohë. Ndihe mi europianë, por e dimë që jemi thjesht një grup popujsh fshatarë, nomadë, me komplekse të thella ndaj Perëndimit të pasur dhe të zhvilluar. Megjithatë, ne jemi Lindja e Europës, dhe mua kjo më pëlqen, sepse shoh sa të ngjashëm jemi në shumë mënyra. Do të na bashkojë vetëm fakti që jemi bota e varfër e Europës, jashtë mureve të Kështjellës së re Europiane. Nga kjo periferi (që ne e mbiquajmë veten qendër), nga shpërbërja, zakonisht lindin gjëra të mira. Në rastin tonë, është arti – veçanërisht letërsia.

Lumi në Bosnjë-Hercegovinë që të fal ndjesinë më të mirë? Si quhet?

Në radhë të parë është Una – lumi i fëmijërisë dhe i njohjes së botës përmes tij. Kontakti im i parë ka qenë ai me ujin. Në vend të dytë është Neretva, ku shkoj shpesh për peshkim. Ndoshta një ditë do të shkruaj edhe një libër për të, ashtu siç kam shkruar për Unën.

“Atdheu im është prej uji të ëmbël...” – je shprehur. Mund t’a shpjegosh lidhjen tënde me ujin, me lumin? Pse janë gjithmonë të pranishëm në veprat tënde?

Sepse jam rritur pranë ujit, në një shtëpi nga dritarja e së cilës mund të prekje ujin (kur ishte niveli i lartë). Ndoshta sepse kemi ardhur nga uji dhe jemi të ndërtuar prej tij. Lumi Una është gdhendur brenda meje, ishte si një perëndeshë mbrojtëse për ne të dëbuarit nga qyteti ynë. Gjatë luftës,

FARUK SHEHIQ

Kam qenë shumë herë pranë vdekjes, saqë mendoj se ajo më ka mbajtur gjallë.

Bisedoi: Milena Selimi

S’mund të ikja nga Sarajeva pa u takuar me autorin Faruk Shehiq, me penën e fortë boshnjake që gjithmonë ka çfarë të shkruajë për Bosnjën dhe Hercegovinën, për Ballkanin e trazuar dhe njerëzit e tij. Vjen me vonesë, si çdo ballkanas, por justifikohet se sapo mbërriti nga Berlina dhe Baseli, ku prezantoi në gjuhën gjermane librin e tij me poezi “Moje rijeke / Lumenjtë e mi”.

Diskutuam për Sarajevën, për poetin që rrallë e kujton veten të tillë sepse proza i merr më shumë kohë. “Nëntë libra kam botuar,” më tha modestisht, ndërsa unë i kujtova se është përkthyer në 17 gjuhë. E bleva librin e tij “Cimetna pisma, dijamantna stvorenja/ Letra kanelle, krijesa prej diamanti” në Panairin e Librit të Sarajevës dhe fati deshi që të takohemi e të bisedojmë nga afër.

Folëm për luftën e tmerrshme, ku ai shërbeu në forcat boshnjake për katër vite në mbrojtje të Sarajevës, për agoninë e Ballkanit Perëndimor sot, për pakësimin e shpresës për një hyrje të denjë në Europë, për penën e tij si kolumnist në gazetën Oslobodenje, ku liria e mendimit dhe e shprehjes janë të shenjta. Për autorët shqiptarë që ka takuar dhe i vlerëson, si Ledia Dushi dhe Primo Shllaku, për Prishtinën ku janë përkthyer tri vepra të tij, për teatrin politik të Jeton Nezirajt, dhe për Traduki-n që përpiqet të afrojë letërsitë tona.

E ndërsa ecim drejt librarisë Buybook pranë urës Skenderije, më tregon kodrat nga të cilat serbët qëllonin gjatë rrethimit të Sarajevës. Pauzë e gjatë. Fjalët nuk mjaftojnë. Në stacionin e tramvajit shoh disa vajza të reja dhe i them se boshnjaket e Sarajevës janë të bukura, “po aq të bukura edhe kosovaret”- ma kthen. “Eja të shohësh edhe Shqipërinë, edhe ne kemi vajza të bukura- e ftoj.” Pasi marr edhe dy libra të tjerë nga Faruku, në librarinë simpatike Buybook, ndahemi teksa një kalimtar i rastit i jep dorën dhe e pyet “Si je shkrimtar?!”

Sarajeva është e bukur, e dashur dhe e ngrohtë, me njerëz mikpritës që e duan librin, teatrin, muzikën dhe jetën. Diçka nga kultura nuk është fshirë nga kjo Sarajevë e bekuar para viteve ’90 — një trashëgimi e fortë dhe e gjallë që i reziston erozionit të kohës dhe trazirave.

Sapo lexova se pjesa teatrale “Brothers” -nga Ballkani ne Gaza u shfaq ne Teatro Trastevere, Romë, realizuar me tekste të autorit boshnjak Faruk Šehić dhe poetit palestinez Mahmoud Darwish. Bravo!

Në një rajon ku historia shpesh i ka përzier dhimbjet me gëzimet dhe ku kufijtë politikë kanë ndarë njerëzit, kultura mbetet ura më e fortë që i lidh dhe i bashkon. Letërsia muzika, teatri dhe dialogu artistik janë mjetet që na ndihmojnë të kuptojmë njëri-tjetrin dhe të ndërtojmë një të ardhme ku identitetet tona kulturore nuk janë pengesa, por pasuria më e madhe. Në Ballkan dhe më gjerë, arti dhe fjala e lirë janë hapësira ku krijojmë lidhje njerëzore, shprehim vlerat tona dhe ruajmë shpresën për një Europë më të hapur dhe më të bashkuar.

Me premtimin se një nga romanet e tij do të jetë puna ime e ardhshme, mendoj se ma bukur se kaq nuk do të mbyllej Sarajeva ime e rezidencës. Faleminderit Faruk, jo vetëm për urat e bashkëpunimit rajonal, por edhe për kujdesjen tënde të vazhdueshme që lumenjtë poshtë tyre të mos thahen!

Sarajevë, prill 2025

Una ishte kufiri, vija ndarëse mes nesh dhe armikut. Për mua personalisht, ishte burim shprese se do të ktheheshim në qytetin tonë dhe do të vazhdonim jetën e para-luftës. Noti në verë ishte një festë për ne që jetonim në brigjet e Unës.

Cili është qoshku yt i dashur në Sarajevë?

Këndi im i dashur është libraria Buybook, njëherësh edhe botuesi im. Për vite të tëra ka qenë tarraca e restorantit “Dva Ribara/ Dy Peshkatarët” dhe shumë vende të tjera – veçanërisht kafeneja dhe jazz club-i Clou, që nuk ekziston më.

Në librin tënd, tema e luftës në Bosnje del nga kujtesa dhe përpunohet. Faruk, mund të na shpjegosh procesin e shkrimit mes realitetit dhe shkrimit, dhe veçanërisht kuptimin e natyrës në poezinë dhe prozën tënde?

Në natyrë përfshihet edhe uji, marrëdhënia ime me lumin. Natyra është një ngushëllim i madh, shpëtim, të paktën për mua. Ajo është e përjetshme, ne jo – a nuk është kjo vetë harmonia? Filozofi amerikan Emerson dhe Whitman (dhe të tjerë) më kanë ndihmuar të vetëdijësohem për afërsinë time me natyrën. I gjithë romani “Libri për Unën” flet për këtë. Së shpejti pritet të dalë në Prishtinë në gjuhën shqipe. Kur kridheni në ujë – lumë, liqen apo det – ju bashkoheni me natyrën, bëheni një me ujin, ndoshta zgjat pak, por nëse jeni

të vetëdijshëm për këtë teksa zhyteni, mund të përjetoni atë ndjesinë hyjnore të unitetit me ujin, natyrën, me gjërat që e tejkalojnë jetën njerëzore. Afërsia me natyrën fsheh sekretin e ekzistencës sonë. Ne jemi të pandashëm nga natyra, edhe kur kemi ndërtuar qytete për t’u ndarë nga origjina jonë shtazore. Biologjikisht, i përkasim mbretërisë së kafshëve.

Ku ndihesh më mirë – në poezi, prozë apo dramë?

Nuk e di, jam pak “transgjinnor” në këtë aspekt. Nuk jam provuar në dramë, (por veprat e tij janë dramatizuar) por poezia dhe proza janë terreni im. Kritikët thonë se veçoria ime më e madhe është proza me një dozë të fuqishme poetike – pra jam një lloj kentauri letrar.

Gjithmonë themi: kurrë më... por ja ku jemi sërish me luftë – në Ukrainë, në Gaza e gjetkë . Ke qenë ushtar i mobilizuar dhe, si dikush që ka mbijetuar një lufte, pse bota sot ka humbur ekuilibrin? Pse Europa dhe Amerika nuk interesohen për shoqëritë njerëzore dhe për këtë luftë në Gaza?

Sepse themelet e Europës dhe Perëndimit janë kolonializmi, pushtimi i tokës së huaj, vrasja e vendasve, plaçkitja dhe lufta. SHBA-të, duke mbrojtur Izraelin, mbrojnë mënyrën si janë krijuar vetë – duke marrë tokën dhe duke vrarë masivisht. Kjo është një nga arsytet. Tjetri është ndoshta

natyrë imagjinare dhe surrealiste: urrejtja ndaj Tjetrit. Në rastin konkret të Gazës, është islamofobia dhe arabofobia, urrejtja ndaj myslimanëve.

Si mund të shpëtosh nga lufta kur koha dhe hapësira janë lineare? Kush të shpëtoi në luftë?

Koha dhe hapësira nuk janë kurrë lineare, vetëm vetëdija jonë i paraqet kështu, për të përballuar më lehtë jetën. Nëse e kuptojmë jetën si një zgjatje neurotike në letër, jo si një vijë e drejtë nga pika A në B, do të na dukej e padurueshme. Në luftë më shpëtoi vullneti i fuqishëm për të jetuar, energjia e madhe që kisha, dhe, paradoksalisht edhe gatishmëria për të dhënë jetën çdo çast për idenë e Bosnjës së lirë dhe tokën e Bosnjes. Kam qenë shumë herë pranë vdekjes, saqë mendoj se pikërisht ajo më ka mbajtur gjallë.

Pas 30 vitesh, a ke shpjeguar ndonjëherë – “më dëbuan nga banesa, rruga dhe lagjja vetëm se kisha ngjyrë tjetër sysh?”

E di racionalisht pse ndodhi, por është e vështirë të jesh gjithmonë racional, sepse jemi qenie të imagjinatës për një botë më të mirë se kjo ku jetojmë. Është e vështirë të shpjegosh të keqen njerëzore kur ëndërron për një shoqëri më të mirë. Kurrë nuk duhet të ndalojmë së ëndërruari – përndryshe, jeta do të dukej e tmerrshme.

Kur flasin me ty, të gjithë duan të të kujtojnë luftën, luftëtarin, librat për luftën... më lejo një pyetje të thjeshtë: sa dashuri ka në jetën tënde?

Po, pyetje e mirë. Ka shumë dashuri – kishte edhe gjatë luftës. Dhe për t’iu kthyer pyetjes për atë që më shpëtoi gjatë luftës – ndër të tjera, më shpëtoi edhe dashuria për një person. Më dha vullnet për të mbijetuar. Edhe natyra është dashuri, si dhe dashuria për ujin dhe lumenjtë.

A është shkrimi misioni yt?

Disa njerëz thonë se po, por nuk do t’i jepja letërsisë fuqinë dhe rëndësinë që nuk e ka më sot.

Ke thënë: “Nuk më shqetëson dështimi i shoqërisë njerëzore. Më intereson apokalipsi që e jetoj çdo ditë”. Cili është mesazhi universal për lexuesin?

Që edhe në rrethana më të këqija të mbetesh qenie njerëzore – kjo është fitorja më e madhe. Gjyshti im dhe vëllai i tij kanë qenë në kampin e përqendrimit Jasenovac. Pas punës skllavëruese, ata pastronin rrobat e tyre – donin të ishin të rregullt edhe në kamp. Njeriu duhet të jetë më i fortë se rrethanat që e rrethojnë.

A je ti një shkrimtar dhe njeri i suksesshëm?

Mendoj se jam i realizuar si shkrimtar dhe çdo ditë realizohem më shumë. Por, që të jem i suksesshëm në Sarajevë – kjo jo. Jam një qiramarrës dhe nuk kam sigurim



Përkthyesja Milena Selimi dhe Faruk Shehiq

shëndetësor apo pension. Asnjëherë nuk kam marrë ndonjë nderim nga shteti ku jetoj. Pra, si shkrimtar, jam i suksesshëm vetëm jashtë vendit. Në vendin tim jam emigrant.

Dikur Ballkani mund të krenohet me territorin e vet kulturor; sot është vetëm një shenjë, një valixhe. A është kjo ura për në Europë?

Po, ne jemi tranzit – apo thjesht hapësira jashtë mureve të kështjellës së re të djathtë europiane. Dhe do të jemi për shumë kohë.

Ndonjëherë kjo nuk është vetëm nevojë, por edhe zgjedhje – zgjedhja për të qenë fqinj i mirë, për të mos shembur atë që është e shenjtë për një komb: Zoti, Identiteti, Politika, Kultura. Duhet të harrojmë apo të kujtojmë për të ecur përpara?

Nëse shohim ku po shkon bota – është në drejtimin e gabuar. Një nga figurat udhëheqëse të Amerikës së Trump-it ka tatuazh me thirrje kryqtare. Nuk është ajo Amerikë që kam dashur dhe respektuar – kultura e të cilës më ka formuar. Kjo epidemi po përhapet gjithkund. Të gjithë duan të jenë fashistë. Fashizmi është në modë. Në këtë kuptim, edhe identiteti, politika, kultura – të gjitha bëhen armë që do të përdoren kundër atyre që nuk ndajnë këto qëndrime ekstreme.

Si është Traduki si shembull bashkëpunimi dhe mirëkuptimi letrar në Ballkan? A njihni letërsinë dhe shkrimtarët shqiptarë?

Njoh veprat e Shpëtim Selmanit, Arben Idrizit, Ali Podrimjes dhe disa shkrimtarë të tjerë nga Kosova. Nga

Shqipëria njoh Kadarenë, siç e njohin të gjithë. Kam takuar disa poetë dhe poete në një festival në Prishtinë. Por, për fat të keq, nuk njoh shumë shkrimtarë shqiptarë. Ajo urë letrare duhet ndërtuar më mirë – dhe kjo është edhe puna juaj si përkthyes.

Çfarë po ndodh sot me Bosnjën, nisur nga përvoja jote?

Është pyetje e vështirë. Shkurt: Kroacia dhe Serbia duan të arrijnë objektivat e tyre të luftës përmes mjeteve politike – një ndarje e qetë e vendit tonë. Kanë ambicie të pangopura për zgjerimin territorial. Po përfitojnë nga momenti kur islamofobia është popullore në Perëndim dhe në SHBA. Me ardhjen e Trump-it, edhe kufijtë mund të ndryshojnë. Bosnja është një tortë që Serbia dhe Kroacia duan ta ndajnë. Ne, boshnjakët, nuk do të lejojmë këtë – ashtu siç nuk e lejuam gjatë luftës. Nuk do të bëhemi kurrë palestinezët e Ballkanit – njerëz pa atdhe, mbi të cilët ushtrohet terror prej 70 vitesh që tani ka kulmuar në gjenocid.

Çfarë do të doje të ndodhte në vendet tona si ballkanas?

Do të ishte mirë të hynim në BE, por jo në këtë version të djathtë e krypto-fashist, por në një BE normale. Por kjo nuk do të ndodhë në kohën tonë. Do të dëshiroja që politikatat nacionaliste të pushojnë së qeni dominues në vendet dhe shoqëritë tona.

Të premtova që do të përkthej një nga veprat e tua. Cila do të doje të të përfaqësojë në Shqipëri?

Ndoshta “Libri për Unën”, por ai po botohet në Kosovë, ndaj ndoshta të përkthehej “Nën presion” ose romani i fundit “Letra kanelle, krijesa prej diamanti”. Ose ndoshta të përkthehen të dyja – pastaj edhe të tjerat.

Faleminderit, Faruk !

Shënim: Vëllimi poetik “Libri mbi Unën” u botua në Kosovë gjatë realizimit të kësaj interviste. Mirënjohje përkthyesit Fadil Bajraj, që disa poezi nga krijimtaria e autori Faruk Shehiq, botohen për herë të parë në Ex Libris dhe në Shqipëri.

PARFUMET E ORIENTIT

Ndërsa kthehem me trenin Nantes - Luarë, dikush në Gaza jep frymën e fundit. Ndërsa shoh Hënën që shfaqet në largësi, mbi hekurudhën drejt Angers Saint-Laud dhe foto bëj ta hedh në instagram, flokët e dikujt po digjen në Gaza, në Libanin jugor. Instinkti i shtyn njerëzit në harresë, e lehtë është të harrosh dhe të vazhdosh, *i paprekur* nga foto e trupit të dikujt mbështjellë me pëlhurë. Shumica asnjë ngrohtësi s’kanë për ç’është njerëzore, Jam në urën e gjatë mbi Luarë, hëna ngadalë ngrihet nga lumi, ngjitet e qashtë në sfondin e orës blu.

Atëhere ndërgjegjësohem se imazhet e fëmijës së copëtuar, zhyten ndër ne si lumenjtë nëntokësorë karstikë. Hëna është e fuqishme, e madhe, plot jetë, Ora blu është këtu, mbi Angers Saint-Laudit, përhapet kah vendi ku po jetoj tani. Nuk shkruaj, por ec nëpër Nantes, ndiej parfumet e Nices, dyshoj mes *Musc Ravageur* të Frederic Malle, dhe *Chergui* të Serge Lutens. I njoh mirë përbërësit e tyre: bergamot, tuberoz dehës, qelibar, aromë duhani, Pi kafe në Bistro de Cours, dhe lexoj lajme në celular, kalimtarët, pamje e ngadaltë. Kafeja është e mirë, dopio ekspres, 3.6 euro, Drita e diellit ngroh edhe njerëzit në Gaza, por atyre, dielli i njerëzimit shpinën u ka kthyer. Çdo euro ka një pikë gjaku të pafajshëm, të gjithë jemi fajtorë, Tadeusz dikur thoshte. Hëna e artë mbi Luarë, derdhet e plotë Hëna ngrihet mbi shinat që shkojnë për në Angers, dhe përtej... Shpejt u mësua me gjenocidin, si me shiun e verës, (pasi edhe atë lart e mënjanuam) më shpejt se sa të gjerbet një kafe në Bistro de Cours. Hëna krijon



një shirit të artë prej shine
që shtrihet poshtë Luarës,
ndërsa qëndroj në urë,
shirit i artë më kalon përmes,
dhe shkon drejt Atlantikut,
thyhet nëpër planet, e pamposhtur, forcë hëne,
bukuri e natyrës, gëzim që përjetoj këtu,
parfum që thahet në pëllëmbë, myshk dhe oud,
dhe fajin që do të bartim shekujve,
asnjë Luarë e universit nuk do ta lajë dot.
Hëna do të shkëlqejë dhe qeshë mbi varrezat e qyteteve
tona.

Tetor 21, 2024
Përktheu: Milena Selimi

MISS SARAJEVO

Ne, të lëçiturit nga autoritetet e Sarajevës, të shqetësuar me trupat tanë duke u kthyer nga vija e frontit të cilën po e mbrojmë vetë në kafenenë ‘Ferari’ shikojmë MTV-në kjo është dritarja jonë magjike për në Rugën e Qumështit sepse për të gjitha jashtë Qarkut të Bihaçit është Rugë e Qumështit, ekzotike dhe areale bile edhe në ëndrra

ngjyrat në ekran janë më të gjalla se kostumet tona civile i kemi lëshuar flokët, jemi të rinj dhe dëgjojmë grunge Nirvana, Pearl Jam, Soundgarden, Alice in Chains shikojmë CNN se si zhduket Mostari në shtyllat e tymit dhe se si Juka Prazina u hedh bukë banorëve të Dobrinjes derisa spikeri flet: the man called Juka... na duket se jemi njerëzit më të vetmuar në tokë

atëherë ende nuk i dallonim fjalët: trishtimi apo vetmia kemi sall emocione të çiltra dhe fuqinë e muskujve në natën e trazuar që godet dritaret e kafenesë si shpend pa mend kjo është elegji për gjeneratën që do të dale nga lufta

e çliruar nga çfarëdo idealizmi valëvitës

në ekran janë Bono Vox dhe Luciano Pavarotti këndojnë Miss Sarajevo në koncert në Modenë vashat në kostumet e larjes mbajnë transparentin: DON’T LET THEM KILL US një vajzë bëhet gati të kalojë me vrap shtegkalimin e snajperit gjithçka është e ngadalësuar, ajo kthehet dhe shikon në kamerë buzëqeshjen e saj diellore do ta mbaj mend deri në vdekje si dhe lotët që rridhnin teposhtë faqeve kur për herë të parë pamë Sarajevën e rrethuar.

KUR HERËN E PARË PASHË NJË COPË TË KAFKËS SË NJERIUT

Isha njëzet e dy vjeç
sapo patëm mbërritur në linjë
dhjetori solli një dimër të thatë
gjethet e mveshura me ngricë
kërcitnin përfundi çizmeve
në një dhiare pashë
disa pika gjaku
një copë të kafkës së njeriut:
nga ana e jashtme një tufë flokësh
nga ana e brendshme, një sipërfaqe e vrazhdë
mukozë e ngjashme me të hënës
kjo ishte krejt çfarë kishte mbetur në tokë
prej Shariq Seduanit.

SHËTITJA NËPËR SREBRENICË

Kur isha në Srebrenicë për herë të parë
Duke depërtuar nëpër ajër për shkak të lebetisë i dendur si xhelatinë
Ecja nëpër qytet që është zhvendosur nën dhe
Në të më shumë kishte qen endacakë sesa njerëz në rrugë
Gjithçka që shihja shndërrohej në diçka tjetër
Shtëpia këtu nuk është shtëpi si kudo tjetër
Rentieri i saj është vdekja
Flora për mua ishte diçka e huaj, edhe pse ngado që shkoj së pari i njoh bimët
Ama gjithçka që shihja më tregonte se këtu kisha qenë

goxha moti
Aq shumë fotografitë dhe imazhet televizive m’u kishin ngulitur në kujtesë
Forca e gravitetit ngadalëson hapat dhe gjuhën
Çdo vizitë në këtë qytet është e barabartë me pelegrinazh, sidomos kur je në të për herë të parë, atëherë je i mahnitur dhe i pagojë
Me t’u kthyer në Sarajevë më është dashur të jepja gjak
Pulsi i natës të lodrojë në trup dhe që të pashisë dhimbjen
Mospajtimin midis forcës fizike dhe trishtimit të humbjes njerëzore, sall aty e kam kuptuar

Kur isha në Srebrenicë
Një herë pata shkuar nga drejtimi i kundërt, nga Beogradi
Më pat kapur një sulm alergjik në fillim të rrugës
Dhe një frikë paniku se do të vdisja nga zënia e frymës
Pastaj natën shëtisja rrugëve të Srebrenicës i shëruar
U ktheva në shtëpi në zemrën më të zezë të errësirës
Përgjatë bahçes së Mësuesit dhe Reuf Selmanagiqit të Ziut
Dritaret ishin pasqyra të errëta
Nga oxhaku shpërthen vetmia në vend të litarit të tymit
Këtu mbizotëron një heshtje e tmerrshme, elementi i pestë, gjuha e atyre që nuk janë më
Shtëpitë i kam imagjinuar si qenie të gjalla
Që në kokën time këtë hapësirë ta popullëzoj me jetë
Përroi gurgullonte midis vendbanimeve të errëta
Në anën tjetër të perdes errësira lëshonte miceliet e veta
Shkëlqenin si argjend shpirtrat e të vdekurve
Shtëpitë pa fasadë të vringëlluara thellë në natë
Shkallët e betonit në të cilat një mace ishte kruspullosur – rrokë e ngrohtë gëzofi
Dhe një ftua i lënë në shkallë për t’u pjekur


Shëtitja gjatë natës në Srebrenicë më mbush me shpresë
Më afron te yjet e shpëtimit
Dhe ia kthen dinjitenin qenies sime

Kur isha në Srebrenicë
E ndieja rrëmujën kolosale të kozmosit pa zot
Peshën e trupit tim, të cilin, këtu, thuajse e bartja sipas dënimit
Po, ndjenja e fajita është ajri që e thithim
Asnjë poezi për Srebrenicën kurrë nuk do të arrijë fundin e vet
Trishtim i pafund është muzika e saj
Trashëgimi e shpirtrave tanë

2013

PAS KATAKLIZMËS QË DO TË VIJË NJË DITË

Temat e tyre janë më të rëndësishme
Ata shkruajnë në gjuhë të madhe



Temat tona janë të parëndësishme
Ne shkruajmë në një gjuhë të padukshme

Gjithçka e tyre është më e madhe nga gjithçka jona
Penisi i tyre është më i madh, edhe vaginën e kanë më të madhe
Edhe bombat e tyre janë më të mëdha, varret e tyre janë XXL
Varret tona, përsëri, të gjitha janë të vockëla, të padëgjueshme deri në pikën e dhimbjes

Gjuhën e kemi sistem të ndërlikuar zërash me brirë
Të vështirë për t’u shqiptuar, edhe temat i kemi të rënda, librat të rënda plumb
Gjithçka e jona e parëndësishme, jemi hapësirë fantazie, arabeskë
Gjithçka e tyre më e madhe, e jona gjithnjë e vocërr dhe më e vocërr

Kurrë nuk do të bëhesh i famshëm si ata
Nuk e ke emrin bombastik, i yti është bezdisës për vesh
Ti nuk shkruan sipas diktatit të tregut as të epokës
Çfarë janë idhujt e tyre për ta për ty janë polakët

Me lojëra fjalësh jashtëzakonisht të rëndësishme hipsterësh
Me finesë në gjuhë, ndërsa gjuha jonë çjerrë qiellin
Ne shprehemi me vetëtima dhe bubullima
Ne nuk jemi të aftë për mendime të rëndësishme filozofike

Emri yt nuk është as River as Oqean
Nuk ke vuajtje që është ikonike, dhe e përshtatshme
Shpina jote e djegur nuk e ka parë ballinën e Time-it
Edhe lufta është jote hiçasgjë, krejt ç’është e jotja është e paktë,
një mostër e AND-së i nxen

Betejat e tyre janë të mëdha
Poetët e tyre dolën nga frymëzimi që ua ka dhënë zoti
Mendimi, ideja, gjithçka mbufatet nga forca
Aty ku ne kemi parë një vijë të thjeshtë, ata kanë parë labirinte

Derisa ne ndanim para në delirin e epokave
Qerasnim muzikantët e zjarrit flakërues dhe të pastrimit
Ata i kursenin monedhat, i ruanin për brezat e ardhshëm
Për këtë arsye s’na nxen kund vendi vend, nomadë pa busullë

Na pret i njëjti fat, e njëjta fatkeqësi jofilmike
Këngët tona janë më të mira se tuajat, të pagëzuara me gjak
Sinqerisht, ngado që ia mbajmë,
Një ditë ju do të na admironi si ne Homerin.

2018.

JETOJ NË SHTETIN KU NXJERRJA E KUFOMAVE NGA VARRI ËSHTË LAJMI KRYESOR NË TV

Lulëzon atdheu prej eshtrave të ushtarëve
liria na ka ardhur si rrebeshtuhie
pas bubullimave të zgjatura dhe reve të dendura
toka po avullonte nga era therëse e kalbjes

lulëzon atdheu prej eshtrave të ushtarëve
tufat e formave njerëzore
që shkojnë në treg, në funerale dhe koncerte
u ngajnë skulpturave të Henry Moore-it

lulëzon atdheu prej eshtrave të ushtarëve
e ka ngjyrën e fosforit të djegur, buzëqeshjen e pehlivanit
në herbariumin e kujtesës thahen fytyrat e të vdekurve
të gjitha varrezat e luftës janë turke sepse pranë tyre kalohet në heshtje

lulëzon atdheu prej eshtrave të ushtarëve
përbindëshi i zëshëm që premtonte zbritjen e mitit në realitet
sidoqoftë, miti është, bash sikur secili rrugë deziluzion
farë e padukshme nga e cila piqen varrezat masive

Përktheu: Fadil Bajraj

Azem Shkreli poet, gjatë udhëtimit 50 vjeçar, artikuloi poezinë ndër më eliptike të shqipes; verbi i kësaj poezie, me brumosje të hapësirës së vet kohore - që nga gjysma e viteve 50 të shekullit njëzet dhe deri në përmbyllje të tij, formon obelisk poetik, ngjizur nga bëmat më dramatike kosovare dhe arbërore; thurje mozaiku kronologjik të gjysmë shekullit Kosovë; muza e tij e epërme, e këtij harku kohor, vetvetiu e ka ndriçim të brendshëm këtë ndjeshmëri; në këtë sfond, poezia, për llogarinë e vet, për shtysën e patjetër, gjatë udhëtimit, natyrshëm mëkohet nga trazimet kërcënuese për Kosovën , sidomos gjatë decenieve të fundit të shekullit; prandaj e përfshirë brenda tetë vëllimeve, ajo është kompakte në ngjyrim ndjeshmërie dhe kronologji hapësire, homogjene si një sagë, si cikël i madh poetik; shtegu frymëzues i komunikimit me Kosovë është bashkëhapërim i pandërprerë, bashkëbisedë dhe bashkëvajtje - ardhje me dhe në Kosovë; në këtë grykë kohe, sfondi kronologjik, me ndjeshmëri dhe tensionim të pandërprerë vjen natyrshëm; dhe, siç u theksua, sa më afër fundshekullit, përkatësisht sa më pranë zjarrit të luftës, që e parandiente saktësisht poeti, aq më dramatik ekspresioni lirik i poezisë; shtresimi eliptik në muzën e Shkrelit, shndërrohet në vatër refleksesh estetike dhe etike; referenca të kësaj sinteze perfekte, përcjellin ekspresionin lirik të tij me trazime tensionesh të brendshme, shtrëngata vetëtimash frenuar, siç ndodh edhe me ciklin e lirikave mbi dashurinë e poetit.

Duke u shkëputur nga entuziazmi për lirinë e fituar pas luftës së Dytë Botërore, poezia e Shkrelit, pas çdo libri të radhës vjen më tunduese, më mosbesuese për pozitën dhe fatin e Kosovës dhe shqiptarëve, për situatën dhe të nesërmen e etnisë; shkallëzimi i tensioneve dhe tendosjes në rritje, do arrijë, në mbyllje të shekullit, përmasën e makthit për ekzistencën e saj për bërjen dhe zhbërjen e saj, siç janë vargjet e poezisë “ *Motiv pa qiell*”, artikuluara në librin e fundit botuar për së gjalli “*Lirikë me shi*” (1994);

*as bimë as qumësht as zogj as hije pas shtatit
as kremte as flamur as fjalë
as plis majë mendimit
as vig as breg as pushkë as kohë për nesër
As qiell...*

(*Motiv pa qiell*)

vetëm brenda shtatë vargjeve, një hapësirë, ambient, popullatë mbërthyer brenda një ferri, pa jetë, pa nesër, pa flamur, pa pushkë, pa urti për të dalë prej tij, - as qiell për ëndrra, ngjashëm me kohën e shtetrrethimit policor mbi Kosovë...

Shqetësimi i parë i Azem Shkrelit lidhet me statusin e fjalës, që, me këtë rast është statusi i folësit të saj; fjala, figurë poetike, e këtij hapërimi, do reflektojë edhe ajo shkallëzim statusesh tensionimi dhe iluminimi të brendshëm; nga tundimet dytësore, nga statusi i strukur në pritje, në vigjilim, sa e heshtur, - të mos qenit prani e duhur në çast të duhur, sa e shqiptuar pas së vjelave, sa e tillë që s’i duhet askujt;

*Tani s’i besoj më
as kështjellës sate prej guri*

*Këtu e tej detit
po shembet mbretëria jote*

*M’i kthe të pathënat
t’i mbuloj me plisa me bar*

*Mbase do lulojnë
fjalë që u zihet besë*

(*Pas heshtjes*)

kështu, nga të qenit “*Kështjellë e Shenjtë*”, sa të qenit fjalë “*prej guri*”, tundohet nga zvetënimi, dorëzimi; në këto çaste poeti i kthehet vendlindjes, lartësive rugovase, për t’i mbushur bateritë; çaste këto, shtrirë sidomos në ciklin e lirikave dukagjinçe,

FUQIA E FJALËS NË POEZINË E AZEM SHKRELIT

Nga Ali Aliu

por edhe sa here e zë veten, qëndresën, boshtin kurrizor përballë tundimeve, vërvitet majave të mendimit majë plisit; fjalën Azem Shkreli e ndjen si genie të gjallë, ajo është krejt çfarë je; ajo edhe kur thuhet dhe heshtet, edhe kur mbahet dhe shkelet, kur zvetënohet dhe s’thuhet kur e do koha, dhe e kundërta, përshfaq zërin e folësit, subjektiv dhe universal; mprehtësia e kësaj ndjeshmërie e poetit, për ta rrahur nga të gjitha perspektivat, në jetë dhe përjetësi, joshjeve dhe tundimeve, fjalën e bën kult dhe art poetik; e degdis atëherë atë dhe veten, majave të vendlindjes, lashtësive urtake dhe burrërore të fisit dhe etnisë; janë të shpeshta kthimet dhe rishtazi kthimet e poetit në bashkëbisedim me urtakun Dasho, në kërkim të përgjigjeve për enigmat dhe misteret e njeriut, të botës, të Kosovës, përgjigje për fatin e saj në situata dramatike, të bubullimave në horizont dhe mbi Arbëri; takime këto që, sa më shumë shtyhen drejt fundshekullit njëzet, bëhen më të shpeshta, fjala ndërsa më e ngjeshur tensionesh, më e thukët dhe më paralajmëruese për rrezikun e ekzistencës mbi Arbëri; prandaj, leximi i vëmendshëm, e ka më të lehtë të dekodojë vargjet e tij të viteve shtatëdhjeta, dhe atyre të viteve tetëdhjeta dhe lirikave të fund shekulli, tek dy librat e fundit të tij: “*Lirikë me shi*”, sa qe gjallë dhe “*Zogj dhe gurë*”, lënë dorëshkrim; anash kësaj, Azemi do të “grindet” edhe vetë, me fjalën e vet kur s’thuhet në kohë, kur nuk ecën me të, si dhe situatave kur do ta dojë të heshtur, të mosfolur siç është poezia, “*Ajo që s’e them*”;

*Ajo që s’e them s’është foshnjë që përkundet
kot së koti dhe rritet. S’është as vala
që lyp brigje të tjera dhe nuk mundet –
është burim për të cilin digjet etjes fjala.*

*Ajo që s’e them s’është hije. As tehu që hasi
Në gurin e së pathyeshmes dhe u lakua në
dëshpërim –
Dhunë e dhembjes është. Klithja që plasi
Kupën e ëndjes sate dhe të durimit tim.*

*Ajo që s’e them s’është kullë e shembur
brenda,
S’është dënim i dashjes dhe nuk është e
huaj –
Njerëz dhe njolla dhe gjithë ç’ju përmenda,
Ajo nuk është guri im mbi varrin tuaj.*

*ajo që s’e them s’është heshtja. As magjia
e lashtë e saj që ia dimë të fshehura halët.
Dhe do t’i trembet kobit të vet zbrazëtia
kur t’ia flak unë fytyrës, lecat, fjalët...*

(*Ajo që s’e them*)

Azem Shkreli është ndër poetët me më shumë vargje për heshtje, për heshtjen e fjalës, për ta sprovuar atë nga të gjitha statuset dhe perspektivat e saj të heshtur; për heshtjen e saj në poezi, por jo vetëm; janë të njohur botërisht, hamendësime, tundime mendimtarësh, filozofësh e shkrimtarësh të njohur, që, sidomos pas çastesh apokaliptike globale, kanë shtruar dilemën: a ka më kuptim poezia, fjala e saj pas Hiroshimës, apo Aushficit; heshtja e Shkrelit, heshtja e lirikës së tij është klithje për dhe me Kosovë, atë të fundshekullit të kaluar; e këtij soji ishte edhe heshtja e poetit tjetër të madh, Fatos Arapit, por në kontekst dhe rrethana tjera; ishte zhgënjim i madh nga kakofonia dëshpëruese pas monizmit, që e bëri poetin t’a heshtë fjalën dhe ta mbyllë veten brenda katër mureve, gjatë dhjetëvjetëshit të dytë të këtij shekulli, deri sa mbylli sytë...

I tillë ka qenë Azem Shkreli edhe në jetë; është rast emblematik i të qenit një, - pot dhe njeri; fjalë pak dhe i përmbajtur; as në situata më acaruese, nuk e ka dëgjuar kush ta ngrejë zërin; as në rastet e dhembjeve fizike, të vetat a të familjes, as përballë goditjeve të liga, nga pas, nuk e luhatin qetësinë e epërme të tij; e tillë edhe përmasa e tij mirënjohëse, deri adhuruese ndaj miqve, siç është sjellë në poezinë kushtuar Ismail Kadaresë:

Plot fjala është me ju, plot gjiri i nënës



*Kudo dhe ngado është e juaja, pos mohit,
pos orës së prapë
Dhe krismës pra pa shpinës, po unë me se
t’ju
zbukuroj në baladë, o miq, o dega ime e
epër e fisit
atij tisi të hollë e tisi të rrallë, tri here të zier
Në ashtin tuaj dhe timin, po unë me se të
ju kem me se
Të ju përynoj, e vetëm ju e dini atë bar të
mirë
Atë lëng rrzëzë fjale me të cilin m’i mëkoni
plagët
Ethet dhe qentë m’i përzeni kur kam
zjarrmi, kur digjem,
Ujë etjes m’i jepni bri Kroit të Martinit e bri
Kruje
Ullirin e moshës m’a pigni, zotynë shëndet
u dhashtë
Nga jeta e vet e popullit, nga gjaku, nga
shpendi ynë
Ju dhashtë, me se të ju di, me se të ju
zbukuroj në
ba-Ladë, e jeni sa krip ka koka, sa fije bari,
sa deti,
Alkal. Më Alkal ju dërgoj dhe më ktheni me
mollë në
Shtizë. Të gjallët m’i gjalloni, të lënguarit
m’i shëroni me
frymë. Të vdekurit m’i paloni sikush në
Kosovë të mirë
në zemër. Ju falem që jeni, o të mirë, ju
falem që jeni, ju
falem. Plot fjala është me ju, plot kupa, plot
gjiri i nënës*

“Përhëndetje me miq”
(I. Kadaresë)

Besoj se i vetmi çast, e vetmja situatë kur Shkreli ka qarë për vërteti, ka qenë një ditë pranvere e vitit 1997; njëra nga ato ditë kur marrosja shqiptare, tiranase, ka qenë në përmasa apokaliptike; më vjen i gjallë edhe sot zëri dramatik i një gazetari që raportonte nga një pike e kryeqytetit: rafalë Kalashnikovë nga të gjitha anët, ulërima frike, tmerri dhe rebelim lebetitës, dhe zëri gjysmë në vaj i gazetarit që i dorëzohej çmendurisë publike dhe dorëzimi i qytetit; atë ditë janë shkruar vargjet e poezisë “*Këngë e turpshme*”:

*Sonte
Qava sonte për ty
Arbëri*

*Nuk më vjen turp
Pse qava
Më vjen turp se s’munda
Të bëj tjetër*

Nga turpi qava

Para se të kalonte në përjetësi, në një takim nga të fundit, si shpesh edhe herëve tjera, nga fondi i poezive që po përgatiste për botim, ma dha në dorëshkrim këtë poezi, e cila e përmbyll librin “*Zogj dhe gurë*”, pas vdekjes së poetit.

(Fragment)

Poeti Gazmend Krasniqi, autor i librit “Sprovë antologjike, (2003) dhe “Antologji e poezisë shqipe” (2014), lexues ekselent i poezisë, në këtë të fundit, për dyzetetë (43) poetët e përfshirë, për secilin, sjell edhe bibliografi fare të shkurtra, tek ajo për Azem Shkrelin shkruan: “është një mjeshtër i poezisë kosovare dhe i asaj shqipe në përgjithësi”.



Është një personazh imagjinar, i padukshëm, por magjik, që e ndjek lexuesin me lazdrime të ndryshme, që e magjeps edhe atëherë kur shfaqet e ëmbël, apo mizore! Ajo ka nevojë për pasion të fuqishëm, të jetë e lirë, është diçka hyjnore, mistike, e gjithëpushtetshme ; është liri, triumfuese ndaj presionit shoqëror; fshin kufijtë midis reales dhe të vdekshmes; jeton si një ndjenjë e papërmbajtshme, në zjarrin e saj shkakton drama e tragjedi... Prozatorja nuk moralizon, nuk zgjedh modelin e arësyes në këtë raport çmëndurak, por thotë atë që, ndonëse logjika normale nuk e pranon, ajo artistikisht e sfidon. Dashuria nuk konceptohet thjesht në raportet midis dy personazheve, por në thellësinë e një force magjike, universale. Prandaj, në prozën e Mira Meksit dashuria nuk ka vlerën ‘e reales’, por ‘formësohet’ në disa qasje, sa origjinale aq edhe të guximshme:

Dashuria, për këtë autore, nuk është ndjenjë por magji dërrmuese, nuk zotërohet, por të mposht: “...ishim verbuar, ishim karfosur nga magjia, kishim humbur atë pjesë të ndjeshmërisë së shpirtit njerëzor që na lidhte me të tjerët, gjaku na ishte bërë ujë dhe ishim gati të shkelnim mbi kufomat e njerëzve tanë më të dashur! i mohoni ata, vetëm që të shuanim flakën që tani na përvëlonte trupin...” f.18 “Pa zemër në krahavor”

Dashuria perceptohet në një hapësirë jo reale, por mistike, universale, që i përket çdo qenieje njerëzore. Mjeshtri e përshkrimi të kësaj ndjenje, e cila shfaqet më shumë si figurë magjike, e gjithëpushtetshme, ajo është në të vërtetë lëvizje që rrok realen me hyjnoren. Rrëfimi i Mira Meksit i jep konceptit të dashurisë vlerë gati hyjnore; çdo moment apo skenë e përshkrimi të saj është larg banalitetit, pushteti seksual; është diçka që lexuesit i krijon një ndjeshmëri sa njerëzore, aq edhe magjepsëse. Mishëruar te personazhi i novelës “Pa zemër në krahavor” rrëfimi shpall pa kompleks: “ndjeva të më kaplonte të gjithën ndijesia e mrekullueshme mjaltëse e takimeve të para dashurore, puthjes së parë, prekjeve të drojtura, aromës së l’eau d’issey, më pas ndijesia e ekstazës së ndjenjës më të fuqishme që na gufon shpirtin dhe na jep shijen e pavdekësisë” f.14

Sublimimi është i jashtëzakonshëm, ideja kapërren çdo konceptim letrar, sado i bukur e i realizuar të jetë ai. Në mënyrë metaforike pohimi i Besës (“Buzëqeshja e fundit e Beatrices”) se kish bërë dashuri duke menduar tjetër person, shpreh kontrastin me kuptimin e zakonshëm, fizik të dashurisë, misterin e kësaj ndjenje, formën e pazakontë që merr ndonjëherë ajo, një kapërcim e ndjeshmëri që njerëzit pothuajse nuk e njohin. “Sa kohë kam që mëdyshem dhe vuaj pa e kuptuar dot thelbin e dashurisë time, dashurisë tënde... Do të thotë se gjatë gjithë kohës kam dashur tjetër kënd, pa e kuptuar. Dhe kam bërë dashuri me ty”. Paralelizmi me Beatricën e Dante Aligerit i jep konceptit të dashurisë misterin e një kompleksiteti përjetimesh delikate, aromash të pakuptueshme, ajo guxon për ta ndarë dashurinë e vërtetë, që është diku tjetër, me dashurinë që duket se e ka pranë. Në konceptin e prozatores dashuria shfaqet si mister, shpesh i pashpjegueshëm në forcën apo kthesat që merr, në lumturinë apo rrënimin që shkakton.

Dashuria është lidhje e dy shpirtave të lirë, në universe që bashkohen, por që papritur edhe mund të largohen nën pushtetin e pasionit të pakomanduar, që duket se risjell një betim të lashtë ritual për dashuri në jetë dhe në vdekje. (zhvillimet në shpirtin e heroinës në pasionin për poetin e adhruar, të vdekur, Carlos Fuente). Ndonëse në situatë halucinative, në këtë motiv shkrimtarja i jep ndjenjës një kuptim sa mistik, aq edhe të përtejjetshëm. “A dashurohet i gjalli me një shpirt?” vjen në mendjen e saj pyetja më e vështirë, për këtë raport universal, misterioz, që ka njohur ndjenja njerëzore. “Ndieja sikur shpirti më kish marrë përmasat e kozmosit dhe trupit më kishin mbirë flatra. Ditët dhe netët e mia nuk ishin ato të mëparshmet, ishin një rrugëtim përmes dritave dhe dehjes së një feste të përhershme. Si një fillim dashurie

Ç’është dashuria në prozën e Mira Meksit?

Nga Floresha Dado

që përsëritet pafundësisht.” (“Pa zemër në krahavor”).

Dashuria në prozën magjike të Meksit, merr një kuptim tjetër, shumë të gjerë, kapërcen raportet midis dy personave dhe shkrihet në përmasa qiellore, në një çlirim të madh, në liri të pamatë, përfshin shekuj të lashtësisë njerëzore, për t’i dhënë një kuptim universal kësaj ndjenje që lindi bashkë me njeriun. Një kuptim i tillë filozofik që e përcjell këtë ndjenjë në horizonte të tjera, përtej raportit të ngushtë ndërnjerëzor, sjell një qasje të re në letërsinë tonë, e bën më meditative përjetimin e lexuesit. “...njoha Erosin e aztekëve. Njoha vuajtjen, torturën, dhembjen njerëzore, të pandara nga qiellorja dhe lumturia e perëndishme” f.60 (Po aty).

Dashuria është sfidë, që të vendos në udhëkryq të vështirë, për të gjetur rrugën e arsyeshme. Është kumtim filozofik në romanin “Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë”, ku madhështia historike e princësës ilire vihet në sfidë nga dashuria. A është boshti filozofik përplasja misterioze midis ndjenjës dhe instiktit të papërmbajtur të dashurisë?

Është personaliteti historik, thelbi i këtij personazhi, apo përmasat mitike që merr dashuria në përjetimin e vrulleve që shpërthejnë në brendësinë e ndjenjës ? Këto pyetje na çojnë të besojmë se ky roman nuk ka në themel thjesht boshtin historik, por më shumë boshtin e mitizimit/çmitizimit të figurës, parë në një aspekt sa historik por dhe më fuqishëm, në aspektin lirik/dashuror. Jo shumë e njohur nga dokumente të sakta historike, figura e mbretëreshës ilire, vlerësuar si e jashtëzakonshme, lejon fantazi, trillim ndjenjash e përjetimesh emocionale më lehtë në linjën erotike, ku çdo lloj trillimi është i pranueshëm. Robëria shpirtërore apo shpëtimi përbëjnë boshtin filozofik, një problem universal, sa vetë letërsia, i ekzistencës së njeriut. Te «Puthja e Amazonës» dashuria është tronditja e madhe midis ekzistencës, misionit historik (mitik) dhe ndjenjës, dëshirës së natyrshme: «Brenda kllapisë vajtoi shumë herë duke ulëritur për gjëmën që i pati ndodhur. Kur çeli sytë, kuptoi me tmerr se më shumë kish vuajtur nga malli për kolkidasin». f.87 Në këtë raport dashuria sjell dhimbje,


dëshpërim, kapërcim bindjesh e dëshirash. Kjo është beteja më e madhe shpirtërore e njeriut, nënkupton romani i M.Meksit.

Dashuria u jep ngjyrë e tingëllim skenave erotike, krijon një ndjeshmëri shpirtërore, në akord të përsosur me ndjeshmërinë tingullore ? Në tregimet e Mirës kjo ndjenjë përjetohet nga lexuesi si ngjyrë, aromë, freski. “...duke mësuar të dëgjonte muzikën që shkaktonin ledhet e dorës dhe të gishtërinyve mbi lëkurë; prekje pas prekjeje Teuta dëgjoi dhe shijoi tingujt prej harpe që lëshonte qafa e saj e gjatë dhe e drejtë ...fërfëllimën e kordave të kitharës që i shpërthenin nga gjoksi i lartë dhe i fuqishëm, muzikën e pipizanes që drithmonin thithkat rozake e të majëta të gjoksit, melodinë e ëmbël prej lire të vitheve të kërcyera dhe mrekullisht të lëmuara, lutin që luhej nga harku i mermertë i belit; mbajti vesh me dorën mbi kërthizë frymëmarrjen e përvëluar të flautist të Panit që frymëzonte barku i saj i njomë dhe i paprekur...” “...duke mësuar të dëgjonte muzikën që shkaktonin ledhet e dorës dhe të gishtërinyve mbi lëkurë; prekje pas prekjeje Teuta dëgjoi dhe shijoi tingujt prej harpe që lëshonte qafa e saj e gjatë dhe e drejtë ...fërfëllimën e kordave të kitharës që i shpërthenin nga gjoksi i lartë dhe i fuqishëm, muzikën e pipizanes që drithmonin thithkat rozake e të majëta të gjoksit, melodinë e ëmbël prej lire të vitheve të kërcyera dhe mrekullisht të lëmuara, lutin që luhej nga harku i mermertë i belit; mbajti vesh me dorën mbi kërthizë frymëmarrjen e përvëluar të flautist të Panit që frymëzonte barku i saj i njomë dhe i paprekur...” f.76

Ndërsa në tregimin “Buzëqeshja e fundit e Beatrices” autorja ‘zbulon’, në një gjetje të pazakontë në letërsinë tonë, ‘ngjyrën’, thelbin e dashurisë, si kombinim aromash që shtresat e ‘koktejit parfumor’ krijojnë një kënaqësi të stërholluar, që nuk mund të ishte një marrëdhënie që s’e ndjente aromën, një marrëdhënie që mund ta flakte në çdo çast, për ta ruajtur më pas vetëm si një material kujtese’.

Dashuria është mister për personazhin, është një forcë, para së cilës ai gjendet i pafuqishëm, i paaftë të zotërojë imagjinatën e pushtetit misterioz mbi mendjen dhe ndjenjën e tij. Teuta “Mendonte për zemrën njerëzore dhe thelbin e saj, dashurinë; vriste mendjen se si ishte e mundur që ky thelb zemre të ishte aq i fuqishëm sa dhe malet të mund t’i lëvizte nga vendi po të donte, dhe me vdekjen të luante siç luan era me gjetet e rrëzuara të pemëve. Dhe të ishte aq i dobët njëkohësisht, sa t’i nënshtrohej dhe t’i shërbente ambicieve të përbindshme që ushqeheshin me gjakun e tij, dhe që lypnin fljimin e gjithkujt dhe të gjithshkaje, gjer edhe të lirisë. Po ia vlente të jetohej. Teuta kish parë Afërditën në universin e pavdekshëm me lëndën e dashurisë që dilte nga zemra e saj dhe shënërrohej në pije për hyjnitë; kishte pirë në kupën e mbushur buzë me buzë me atë pije ngjyrëgjaku, duke e shijuar njësh me perënditë.” f.360 Marrëdhënia e mbretëreshës ilire, me komandantin grek, sa e dëshiruar, aq edhe brengsjellëse, bëhet personazh fuqiplotë, duke mishëruar planin e dytë të përfytyrimit mbi Teutën e Ilirisë, aspektin personal të saj, i ndërtuar thelbësisht përmes imagjinatës krijuese të romancieres...

Dashuria është sublimim i shpirtit ! Kapërcen çdo kufi të reales, të zhyt në përjetime imagjinare, halucinante (tregimi ‘Nobelisti’).



I gjithë përjetimi i vajzës është magjik, imagjinar me zërin e shpirtit, halucinant, me ngjyra të realizmit magjik. Në fytyrëzimin e kësaj ndjenje realja merr kuptim tjetër : s’ka të bëjë me ngjarje, veprime në vetvete, por me pushtetin dërrmues të ndjenjës. Në disa krijime të saj personazhet përjetojnë dashurinë e fuqishme, të pamëshirshme, në situatë halucinante. Ajo shfaqet dhe e mbërthen personazhin me ngjyra si të reales, e fut heroinën në përjetime sa mahnitëse aq edhe zhgënjyese. Dashuria, sipas autores, nuk ka fytyrë, nuk lidhet domosdo me ekzistencën e prekshme; ajo është përtej çdo imagjinate dhe interpretimi. Është një pushtet misterioz, që shkon përtej marrëdhënies reale, që fshin kuptimin e raporteve të drejtpërdrejta mes dy njerëzve, ku shpirti i të adhuruarit të vdekur robëron shpirtin e të gjallit... Personazhi, që nuk jeton, shpirtërisht bëhet robërues i zemrës së personazhit-rëfimtari, zhytet në shpirtin e atij (*“Pa zemër në kraharor”*). Njeriun e udhëheqin forca të brendshme misterioze ? A është dashuria një ndjenjë reale, apo imagjinare, halucinante ? (Puthja halucinante me Fuentesin e vdekur).

E pafuqishme ndaj kësaj ndjenje, që për të është misterioze, heroina tronditet para faktit se u bë “dashnorja e një shpirti! Të jetoja pasionin e një shpirti”. Sipas saj, një ndjenjë e tillë krijohet veç nga sublimimi i shpirtit. Në aspektin filozofik autorja e shenjtëron dashurinë si përjetim shpirtëror, si diçka që ka lidhje me njeriun, por edhe me një frymë të shenjtë që e lumturon ose e mjeron atë, që e bën të shohë me sytë e shpirtit të padukshmen, të parealizueshmen. Kuptimi se *“të jetoje për dashurinë nuk do të thoshte të jetoje për atë që doje,...se dashuria është brenda shpirtit, jo patjetër njeriu me të cilin e ndan atë”* i jep një përmasë të jashtëzakonshme kësaj ndjenje.. Edhe tek *“Parisi vret”* në planin thelbësor të marrëdhënies së personazhit me dy vajzat, franceze dhe shqiptare, nuk kemi thjesht dashuri njerëzore, por një dashuri e përtejme, universale, e lirisë, e shpëtimit, e rilindjes mistike në një personazh tjetër, mishërim i një jetë tjetër.

Dashuria personizohet, në qasje dhe përjetime të shumanëshme, në ngjyra e trajta që ndryshojnë, lëvizin, trondisin, si në pamjet befasuese të një kaleidoskopi gjigand. Mjeshtre e përshkrimit të brendësive të shpirtit dhe ndjenjës ajo bën që lexuesi të ‘shohë’, të ndjekë dashurinë si një personazh tjetër, më magjik, më të fuqishmin në korpusin artistik të saj. Te *“Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë”* dashuria fytyrëzohet edhe si personazhi i lirisë, i krijuar prej shekujsh e parashekujsh: *“Ndihej sikur rrëke dhe përrenj magme të zjarrtë të ishin krijuar brenda deje tanë, për shumë vite me rradhë, tinëzisht dhe tradhëtisht, diktuar nga gjaku i të parëve tanë të lashtë dhe të ndrydhur me mijra herë nga dogmat, normat dhe ligjet e kohëve, që tani kishin përmbytur tërë trupin dhe kërkonin të shpërthenin jashtë shtratit të tyre: shumë pak vend kish mbetur, për shpirtin. Porse ndiheshim njerëz të vërtetë dhe të lirë. f.18* (po aty). M.Meksi e ka ***‘shpirtin’ njerëzor*** personazh të shumëgjendur në krijimtarinë e saj.

Dashuria është guxim në përballjen midis realitetit sfidues, të rrezikshëm dhe kënaqësisë trupore, pasionit të pakontrolluar. Autorja nuk ka asnjë kompleks të trajtojë pushtetin e ndjenjës mbi arësyen, qoftë te Teuta e Ilirisë, qoftë te personazhi historik Muktar Pashai, apo figura historike e letrarizuar e Frosinës. *“Ai i qe ruajtur si djallit dashurisë femërore...dhe nuk kishte dëgjuar së joshja prej mishit të tyre të shkallonte e të shtynte në marrëzi ? Muktar Pashai e kish besuar me shpirt se dashuria ishte një prangosje e rëndë dhe si e tillë, ku e ku më e rrezikshme se frika prej seksit të tyre. Por, me sa duket, fati i pat luajtur një reng të madh dhe pashai tridhjetëvjeçar kish humbur mëndjen për Frosinën”* f.115 Është e njejta stuhi që rrëmben edhe gruan e jashtëzakonshme, deri në tradhëti të fatit të saj të parë.

Dashuria, në disa tregime të saj, e vendos rrëfimtaren në situatën e përjetimit mistik, qiellor, ndonëse po aq edhe real, të dashurisë. Në tregimin *“Tlëni i dashurisë”* rrëfimtaria përball guximshëm dy trajtat e dashurisë

: njera *“dhuratë e helmatisur që hyjnia u bënte njerëzve kishte vërtetë lëndë hyjnore, por njerëzit, pasi pinin dhe shijonin nektarin e qiellorëve, e vuanin me jetë, marroreshin nga dhembja dhe binin e bëheshin copë në honin e mohimit të vetvetes. Sepse ajo dashuri u bindej ligjeve hyjnore, të cilët të vdekshmit nuk i kuptonin dot dhe as mund të mbroheshin prej tyre”* f.96. Nga ana tjetër personazhi kërkon *“pa pranga dashurie, krejt të lira, për të ndërtuar ndoshta të tjera lidhje çasti, botë të tjera, dimensione të tjera lumturie. E ndërtova Tlënin të dashurisë e kredhur në harmoninë e një figure të Bahut dhe ndjeva vërtetë paqe dhe siguri dhe një lloj përjetimi shumë të ngjashëm me atë që ndoshta jep amshim.”* f.97

Te *“Hakmarrja e Kazanovës”* dashuria përjetohet si diçka mistike, e pakapshme në kuptimin e saj, mister tronditës, gërryes; një përballje e pamëshirshme midis prejkes reale dhe imagjinatës halucinante, një takim i pavetëdijshëm i piktores me portrtetin: *“ndërsa rrinte e vëzhgonte profiling e panjohur të së shoqes...i feksi në mendje fakti se universi i largët ku gjendej Enerieta brenda gjumit pluskonte në rrethinat e hapësirës së portretit”*.f.64 Rrëfimtaria e quan Kazanovën « kryemjeshtër të artit të dashurisë, ku femra është përëndesha dhe mashkulli skllav i saj ». Metaforikisht ndeshja tragjike e këtij koncepti me dashurinë e zakonshme, të gërryer nga xhelozia, fundi tragjik i personazheve përballë triumfit të portretit-simbol mbi këtë ndjenjë, sfida e autores me historitë reale të aventurierit të famshëm venecian, krijon qasje të re te lexuesi, sfidon opinionin dhe namin e përcjellë në disa shekuj mbi të famshmin Kazanova, i jep një përmasë të jashtëzakonshme kësaj figure, që rrëmben, trondit edhe pa qenë i pranishëm....Novela tingëllon si magji e lirisë së dashurisë, si përballje sfiduese ndaj kodeve dhe skemave ...

Dashuria, në rrëfimet e M.Meksit, ka

brenda vetes edhe misterin e rrëmbimit të shpirtit në pushtetin e asaj ndjenjë që, ndonëse mund të kish rrënuar më parë, shfaqet përsëri si strehë ngushëlluese. (*“E kuqja e demave”*). Përpara kësaj dileme personazhi vuan brenda vetes se përse iu dorëzuan përsëri asaj ndjenje që i pati dërrmuar zemrën. Lëvizjet brenda shpirtit janë misteri që personazhi nuk arrin t’i kuptojë, ndonëse e ndjen se *“kishim bërë gabimin e pafalshëm: kishim guxuar që, me shpresën e shpëtimit, ta vështronim dashurinë drejt në sy duke e provokuar paq, dhe kjo ishte njëlloj e rrezikshme si t’ia ngulje sytë e zhveshur diellit apo vdekjes...”* f.51 Te *“Frosina e Janinës”* dashuria mposht pushtetin e fuqishëm të birit të Ali Pashës: *“kishte aq shumë dhembje në sytë e pashait...kish ngjarë vërtet një mrekulli që Muktar pashai po provonte dhembjet e dashurisë.”* f.119

Dashuria është kompleksitet, është ngjyrë dhe formë, ku bashkohet realja me të magjishmen, realizmi me surrealizmin, dashuria me pabesinë, ndjeshmëria njerëzore me triumfin e dëshirës... Dhembja e zemrës së tradhëtuar dhe pasioni i pikturave ‘si shakullina të irnosura’, dhembja në krahërorin e majtë *‘siç ndjejnë sëmbime njerëzit në vendin e munguar të gjymtyrës së prerë’* krijojnë një raport tjetër midis reales dhe përjetimeve të reja të dashurisë. Realja dhe irealja mpleksen magjishëm, përpiqen të sfidojnë njera tjetrën, por është ndjenja që mposht realen. Një ndër dilemat e disa novelave është : dashuri e lirë, apo hakmarrje ? Ka një demon në brendësi të shpirtit njerëzor ? Njeriun e udhëheqin forca të brendshme misterioze ? A është dashuria një ndjenjë reale, apo imagjinare, halucinante ?

Fundi imagjinar-halucinant i novelës *“Pa zemër në kraharor”*, me shkuljen e zemrës së heroinës në altarin aztek të sakrifikimit, trondit me filozofinë që përshkon strukturën kuptimore të saj: lëvizjet që ndodhin në

shpirtin e të tradhëtuarve, ngjallja e demonit të brendshëm, që mposht çdo ndijesi të logjikshme, e gjithë vepra, thekson një mister në raportin midis logjikës dhe pushtetit të dëshirës, përplasjen midis ndjenjës së papërmbajtur, instiktive me ndjenjën e raportit njerëzor, si përplasje e dy përjetimeve të fuqishme *“njoha Erosin e astekëve. Njoha vuajtjen, torturën, dhembjen njerëzore, të pandara nga qiellorja dhe lumturia e përëndishme.”* f.60 Simbolikisht shkulja e zemrës duket sikur do të shuajë këtë konflikt që ka lindur bashkë me dashurinë e njeriut. Ndryshe nga trajtime të zakonshme, në këtë novelë imagjinata krijuese e autores shkon përtej dilemës, duke i dhënë pushtetit të së brendshmes njerëzore një përmasë tjetër, që i zgjon heroinës, pavetëdijshëm, dashurinë imaginative për poetin e famshëm të vdekur, Carlos Fuentes, apo të mos gjejë dot shpjegim në lidhjen mistike me piktores e famshme, të vdekur, Frida Calon... Sipas meje kjo është lidhja mistike që lidh botën e artistëve, që shkrin instiktivisht pasionin, ngjyrën, tingullin fjalor të tyre. Nuk është personi real, por shpirti krijues që e çon ‘dhunshëm’ krijuesen Meksi drejt magjisë artistike të këtyre magjistarëve të artit të fjalës dhe të ngjyrës. Për këtë arsye raporti i reales me magjien përbën shtratin themelor, zhvilluar përsëri në dy linja, që në vështrim të parë duken si pa lidhje. Nga njera anë. tradhëtia nga i dashuri, rrëmbimi i dashurisë së motrës, ftohja shpirtërore edhe nga dashuria e dytë, dashuritë e një lloji tjetër, halucinante, ndaj artistëve të mëdhenj; nga ana tjetër imagjinata, gjithashtu halucinante, e sakrifikimit të tempullin e lashtë të Meksikës, janë dy linja që përplasen, për t’i dhënë peshë idesë së misterit të ndjenjës.

Por ***dashuria***, për personazhin e Mirës, është e vështirë, sepse kur kthehet në rutinë *“ai ndihej i zënë në një kurth ekzistencial që i merrte frymën. ...Mungesës së lirisë së përgjithshme që krijonte vetmi dhe zvetënim i shtohet edhe robërimi i dashurisë, aq sa i ishte krijuar bindja se dashuria dhe liria ishin një binom vrastar, e hiqnin qafe njera-tjetrën pa pikë mëshire”*.(*“Parisi vret”*)f.34

Dashuria është poezi, është shkëlqim, magji, është zhvillim, përjetim, krenari, merr ngjyrë e formë, sa ‘të dukshme’ aq edhe magjepsëse... Ky është plani më i zakonshmi në letërsi, kur kjo ndjenjë njerëzore përjetohet në raportet e drejtpërdrejta midis personazheve. “Pasion shpirti” është një ndër levat që lëviz, qetësisht apo dhe fuqishëm, fatin e personazheve të saj, *“e kush mund ta besonte?”* fola me vete, *“të bëhesha unë dashnorja e një shpirti! Të jetoja pasionin e një shpirti!”* Dashuria, për autoren, nuk është një marrëdhënie e zakonshme por *“histori dashurie që vazhdon me shekuj, realitet dhe ëndërr dhe fantazi që s’mund të ndahen”*. Dhe ky pasion vjen i lirë, i papërkufizuar, s’ka kufi, s’ka përcaktim, s’ka qartësi, sepse në krijimtarinë e saj (*Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë, Diktatori*-linja e Gutenbergut dhe Jolandës...) lexuesi ndjen filozofinë, sipas së cilës universi i individit është i pafund, i mistershëm, i pakontrollueshëm, sepse dashuria është për prozatorin realitet dhe ëndërr. Gjithashtu në gojën e Teutës ilire autorja shpreh konceptin e dashurisë së epërme: *“dashuria e vërtetë është për atë që kemi brenda nesh, por që s’është ne : për hyun tonë”*. Te Kazanova dashuria është ndjenjë romantike, e kombinuar me një lirizëm magjik *« ajri ishte i kthjellët, i parfumuar lehtas, si për një takim dashurie, dhe mbante një aromë të thekshme misterir, përzier me një romantizëm elegant italian »*. f.21....

Mund të themi me bindje se korpusi i prozës së Mira Meksit vihet në lëvizje nga ***dashuria***, e cila, siç e theksova që në fillim, nuk është thjesht marrëdhënia midis dy personazheve, por një raport i jashtëzakonshëm, hyjnor, sa i mistershëm, aq edhe emocionues për lexuesin. Në këtë drejtim ajo ***zgjeron përmbajtjen kuptimore*** njerëzore dhe flozofike të dashurisë, duke i dhënë një konceptim të jashtëzakonshëm në prozën e saj.



Ishte një mbrëmje e bukur qershori. 12 qershor 2011. Nga ato më të bukurat e vitit, kur stina e verës është në prag të shpërthimit me plotmadhësinë e vet prej shumëlaryshisë së ngjyrave, që ngjan si një fillim pa fund e të grish vetëm të jetosh pa sosje. Atëherë kur çdo shpirt njerëzor beson se jeta është e përherëshme, im Atë, poeti Vehbi Skënderi po luftonte me vdekjen.

Në një mbrëmje të tillë qershori, im Atë do të ishte dehur nga abazhuri i hënës në qiell. Ajri i ngrohtë i përzierë me aromat e akacjeve e jargavanëve do ta ngazëllente për të krijuar pastaj në laboratorin e tij poetik përfytyrimet ekstravagante në skulptura poezish.

Asaj nate hëna shembëllente me një UFO, anije kozmike e sheshtë, gjigande, që dukej ishte ndalur mbi kokat tona për të marrë shpirtin e tim eti drejt parajsës. E shihja krejt e shpërqendruar hënën dhe yjet rreth saj pa sjellë ndër mend asnjë nga poezitë që im Atë iu kish dedikuar, kur hënën e quante mëmën e yjve, fëmijëve të universit. Nuk m'u kujtua as Thuaja Hënës një baladë e tim eti po aq e bukur sa ajo e Alfred De Musset, shqipëruar mrekullisht nga Sotir Caci, ku poetit hëna mbi kumbanore i ngjante si një pikë mbi “i”. Im Atë në baladën e tij gjen shpëtimin tek Hëna sepse fara njerëzore është krejt indiferente ndaj dhimbjes /“Sado e largët që të shtiret e mizantropë/ndoshta dhe të mjekon?/ Ndoshta të nxjerr nga llumi i kësaj bote?/ Dhe në mos të shpëtoftë ajo,/ndoshta të merr me vete në hapësirë/Ku në mos qofsh e lumtur/të paktën je e lirë.” Jo, asnjë varg nuk kujtoja, vetëm iu luta me përgjërime, t'i shpëtonte jetën tim eti. Në fakt, po ndodhte sikur e kishte parashkruar ai, Hëna ishte stacionuar në spitalin ku dergjej im Atë, për ta marrë me vete e çliruar nga cinizmi i llumtë i kësaj bote, si një shpirt i lirë.

Në një natë qershori të tillë të vitit 2005, një dorë kriminale na kishte vrarë rrugës së kthimit nga Prishtina në Gjilan për në shtëpi ku e priste nëna kolegun tonë 28 vjeçar, Bardhyl Ajetin, duke krijuar tragjedinë dhe gërryerjen prej dhimbjes nga një absurd surreal në Kosovën e gjashtë viteve të pasluftës. Si është e mundur të vritet njeriu kur lufta ka mbaruar, aq më tepër një gazetar për ato që shkruan. Të pritet një jetë në mes pa mbushur ende 28 vjeç. Pastaj vrasja të mbulohet nga malet e heshtjes apo nga ngritjet e supeve, që do të thonë “e ku e di unë, e ç'më duhet mua”. Vrasja e këtij djaloshi ka mbetur ende e pazbardhur. Si shumë vrasje të tjera gazetarësh e veprimtarësh politikë të krahut të Rugovës.

Shoqëria shqiptare është tërësisht e çorientuar nga politika tribale dhe kaosi prej eskortave të elitës, që e kanë kthyer në tabu nocionin e drejtësisë, e kanë zhdukur sensin për të kërkuar e gjetur të vërtetën dhe e kanë shpërbërë në antivlerë kulturën. Elitat e botës së civilizuar janë ato të parat që rebelohen, ato që zgjojnë shoqërinë nga apatia, përkundrazi në shoqërinë shqiptare eskortat e elitës janë të emëruara nga politika, të zgjedhura nga politika, të shnderuara nga politika.

Im Atë ishte një njeri krejt ndryshe, ishte një libër i hapur, një kryevepër. Ai gjithmonë iu fal së drejtës, si Zotit, si një konstitucioni universal, që nuk varet nga konjunkturat por nga ndërgjegjja njerëzore e gjithsecilit prej nesh, që të shtyn të gërmosh me shpresë për ta zbuluar e shpëtuar njeriun apo njerëzimin. Im Atë, ishte besimtar i madh i së vërtetës dhe drejtësë. Ndërsa poezia kishte lindur në një ditë me të. Poetët nuk bëhen me urdhër politik, poetët lindin. E vërteta, drejtësia dhe poezia janë të lidhura si trinitet nga filli hyjnor.

Kur të gjithë thonë se drejtësia ka vdekur, drejtësia nuk vdes kurrë, veç nëse njerëzimit i vjen fundi. Në gjurmët e tim eti rropatëm të kërkoj të drejtën edhe unë. Kur vështrimet cinike çinovnikase të superstrukturës komuniste, me pseudonime gërnetaresh e dajresh, që gjatë

Ju tregoj për tim atë, poetin Vehbi Skënderi

Nga Elida Buçpapaj

tranzicionit kanë trashëguar e forcuar pozitat e tyre duke e degraduar plotësisht sistemin politik dhe kulturën, më thonë “e nuk nxore mësim nga vuajtjet e tyt eti”, ua kthej, se deri sa të kem frymë, nuk do të heq dorë nga kredot e trashëguara prej tij, sepse vetëm kështu do mund ta vijoj denjësisht jetën si bija e poetit. Nuk ka retorikë, është thjeshtë një reaksion, si kundër rrjedhë ndaj një shoqërie në krizë të thellë, me të cilën po tallen deri në poshttrim.

Mbrëmja e 12 qershorit 2011 na përhumbi e na e mbushi mendjen se jeta gjithmonë ia del e triumfon mbi vdekjen, se jeta triumfon edhe ndaj prognozave të mjekëve. U bëmë naivë. Me vullnetin tonë. Aq më tepër duke e njohur dëshirën e paepur të tim eti për të jetuar, si poeti i zhgënjyer, që për të sfiduar rrokaqiellat e cinizmit, kishte krijuar botën dhe universin e tij poetik.

Sot familja shqiptare i ngjan një kështjelle prej rëre e lumturia një misioni të pamundur, sepse njerëzve u është shtuar makutëria, babëzia e lumturinë e kërkojnë tek paratë, pasuria, mantenuat, makinat, vilat, tradhëtitë ndërsa ne e kemi përpara syve, lumturia është gjithmonë me ne, ne jemi lumturia e njëri-tjetrit. Im atë e kishte zbuluar Amerikën tek poezia dhe familja e tij. S'kishte qenë asnjëherë një rebus as dilemë, por dashuria dhe poezia i dhanë kuptim jetës së tij për të mbijetuar në kohën e kolerës komuniste dhe postkolerës së tranzicionit. Për të mbijetuar si shpirt i lirë, megjithë injorimin si mjeti efikas që kryepolitika përdor për t'i vrarë poetët. Poetin Vehbi Skënderi nuk e varën në litar si Havzi Nelën apo me një skuadër pushkatimi, por me indiferencë. Institucionet e shtetit, nga niveli më i lartë deri tek Ambasadat që ushtrojnë në heshtje indiferencën ndaj vlerave të vërteta, duke promovuar antivlerën e përdhunuar shijet që krijojnë arti i vërtetë, janë sot dhomat e hetuesisë që në diktaturë torturonin dhe vrisnin elitën e vërtetë dhe poetët.

Të gjitha dramave të jetës së tij, për fajin e një regjimi monstër, ai iu kishte mbijetuar për arsye, për shkak, për hir të familjes që, me të njëjtën monedhë, ia kthente dashurinë me dashuri e nuk e tradhtoi kurrë.

Të dy prindërit e mi regjimi i vuri në provë, i thirrën veçmas dhe i thanë seicilit “prishe familjen e pastaj do t'i kesh të gjitha”. Por e gjitha dhe gjithçkaja për të dy ishte familja. Për t'i mbijetuar atij ferri ishim ne të tre të pandarë.

Kur nuk kishte nisur ende gjuetia e shtrigave, të dy prindërit e mi kishin gjithçka. Poezinë, dashurinë dhe mua. Më 1964, tridhjetë e sa vjeçar im atë ishte vlerësuar me çmimin e Republikës për vëllimin poetik “Fletë nga Ditari im”, ku përfshihej edhe poema e Ofelisë, libër që do të botohej në Prishtinë me titullin “Vdekja e Ofelisë”.

Isha mësuar ta shihja time më me buzë të kuqe, ngjyrë scarlet, të thellë, me thonj me manikyr të kuq të ndezur, mahnitesha prej bukurisë së saj, qeshja edhe unë pa e kuptuar se përse prej të qeshurave të saj, që e bënin shtëpinë të kumbonte. I vetmi shqetësim i sime mëje ishte kur unë nuk e pija gotën e qumështit apo nuk e mbaroja pjatën e supës me lëng mishi e zarzavate. Ajo m'i krihte flokët, më mësonte të laja

dhëmbët. Unë nga ana ime përpiqesha të plotësoja gjithçka që më lutej, si të ulesha në tryezë, si ta mbaja trupin, shpinën duhej ta mbaja drejt, bërrylat nuk duhej t'i vendosja mbi tryezë. Edhe ushqimin e mbaroja me zor veç ta kënaqja atë.

Pastaj erdhën ditë të mbyllura. Jetonim në një bunker pa frëngjij, ime më nuk i lyente më buzët, as thonjtë, qante fshehur për të mos e parë unë. Tek kopshti për të më çuar e marrë vinte gjyshja nga im atë.

Gjithë dielli që kishte pasur apartamenti ynë i vogël u fundos. Jeta jonë dukej si e një të varuri që nga nga çasti në çast do t'ia shkelmonin karriken, për t'ia këputur fillin.

Ishte 1966-67, kur im atë u akuzua si pjesëtar i një “grupi armiqësor”. Ai ishte autori i një fejttoni kritik për Institutin e Gjuhësisë dhe Historisë që nuk u botua kurrë. Si redaktor i revistës Ylli e kishte përgatitur këtë fejtton mbështetur tek të dhënat e një ekipi pune të nivelit më të lartë akademik me Profesor Selman Rizën, Profesor Ligor Milen, Profesor Dhimitër Pilikën, Profesor Zija Shkodrën, ku bënin pjesë edhe kolonel Dilaver Radeshi e majori Bektash Bedo. Ai fejtton ka humbur pa nam e pa nishan. Im Atë dhe ime më më kanë treguar se gjatë gjyqit politik, kopjen e fundit kishte ardhur dhe ua mori në shtëpi Xhelil Gjoni, i cili sapo e kish nisur karrierën tek Zëri i Popullit, pas martesës me motrën e Hysni Kapos, por që nuk u bë dot kurrë gazetar. Ylli ishte një organ që botohej nga Zërit të Popullit. Prej asaj kohe Xhelil Gjoni njëri nga persekutorët më të egër të inteligjencies shqiptare, nuk iu nda tim eti dhe për pasojë edhe mua. Pas vdekjes së diktatorit, kur do t'i shkonte në zyrë ish Prokurori ushtarak Sali Hoxha me të cilin im Atë kishte qenë në Medrese dhe pastaj të dy bashkë adoleshentë kishin lënë studimet për t'iu bashkuar në vitin 1943 Çetës së Dibrës, Xhelil Gjoni do të reagonte me egërsi, duke përjashtuar çdo mundësi që unë të vazhdoja studimet universitare.

Një ditë, kur u ktheva nga kopshti, e pashë tim Atë që qante. Nuk do të qante kurrë më në jetën e tij veç asaj here, megjithë ferrin e vuajtjeve. Ime më i lutej të qetësohej. U frikësova shumë. Më vonë do të më tregonin se Bektash Bedo kishte vrarë veten, ngaqë nuk e kishte përballuar dot torturat e presionit psikologjik, pasi “grupi armiqësor” krahasohej me atë të “Konferencës së Tiranës”. “Vehbi Skënderi është i lidhur me armiq të partisë”. Kjo ishte “damka” e diktatorit për tim atë. Më kujtohet se nganjëherë e shoqëroja edhe unë tek apartamenti i Profesor Dhimitër Pilikës, i cili i kishte mësuar tim eti një soj fërgese me domate, vezë e djathë që unë nazelia e pëlqej shumë. Sa për miq, im Atë kishte mendje të ndritura. Po përmend Nonda Bulkën, Skënder Luarasin, Petro Markon, Petro Zhejin, Sterjo Spassen, Zisa Cikulin me familjen e tij, të cilët e mbajtën afër duke rrezikuar. I ndjeri poeti Llazar Siliqi i thosh tim eti me humorin shkodran, se me u ndalë me Vehbi Skënderin asht sikur me dalë n'bulevardin e Tiranës me kallashnikov.

Me mendjen e një fëmije të mitur nuk po kuptoja asgjë se çfarë po ndodhte tek ne. Gjithçka e mësova kur u rrita. Nuk kuptoja gjë, por përjetoja si fëmijë mungesën e tim eti mbrëmjeve pasi seancat e pyetjeve në Komitetin Qendror të Partisë zgjasnin deri në mesnatë. Zakonisht përpara se të shkoja për të fjetur në orën 20:00, im atë më recitonte poezi, më lexonte libra ose më



tregonte përralla.

Kisha qenë deri atëherë një fëmijë shumë e lumtur. Kisha gjithçka, dy prindër që i mbanin sytë tek unë, shkoja në kopësht me gëzim, ku zysh Nazmia na mësonte të performonim me recitime dhe kërcime, ndërsa zysh Lirika na lexonte një libër që nuk i shterrnin kurrë përrallat, prindërit më çonin rregullisht në Teatrin e Kukullave, në cirk, bënim vizita rregullisht tek dy gjyshet, ku kënaqesha pa masë, kisha shoqet e shokët e pallatit me të cilët luaja me orar. Në verë shkonim në plazh dhe në Pogradec tek daja, ku takohesha me dy kushërinjtë e mi që i doja shumë, Mozën dhe Maksin.

Dukej se si me gomë ishte fshirë ky vizatim i bukur, por një natë, në shtëpinë tonë u duk se u kthye gëzimi. Nuk e kisha nocionin e kohës se, kur errësohej, për mua ishte vetëm natë. E asaj nate im atë, që u kthye më shpejt se zakonisht, iu tha të mëdhenjve se do të shkonte në Vaun e Dejës. Nisa të qaja me të madhe. Kush do të më recitonte poezi, kush do të më mbante në prehër e tregonte përralla aq të bukura! Ndërsa prindërit e mi dhe më të afërmit tanë, që na kishin ardhur ndiheshin të gjithë të çliruar. Sepse mendohej se im atë i kishte shpëtuar burgut. Për ta festuar i thanë gruas së xhaxhait të vogël, Myneverit, të më merrte mua e të shkonim të blinim tullumba tek pastičeri Agimi. Disa ditë më vonë im atë do të nisej në Vaun e Dejës si punëtor në Hidrocentralin që po ndërtohej. Do të ishte ndarja e parë me tim atë. E fundit do të qe kur na la më 13 Qershor 2011.

Në Vaun e Dejës im Atë qendroi për riedukim mbi pesë vjet, punonte saldator me tre turne pranë gjirit të klasës punëtore. Vinte në shtëpi një herë në muaj ose edhe më rrallë. Në dimër mbante një xhup punëtorësh, ku vendet e grisura ishin qepur me tela të hollë. Me punëtorët mbante marrëdhënie shumë të mira njerëzore. E donte fort inxhinier Sokrat Kalivopullin. Si do të na tregonte më vonë, u shmangej provokimeve. Për një kohë ndau dhomën e barakës me piktorin e talentuar Nexhmedin Zajmi, me të cilin u bënë shumë miq. Në Tiranë u kthye në 1972. E punësuan në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”, në fillim si korektor e më pas në redaksinë e poezisë si redaktor. Ishte rikthyer dielli në shtëpinë tonë. Unë kisha mbaruar filloren dhe vazhdoja 8 vjeçaren tek Emin Duraku. Shkëlqejja në të gjitha lëndët dhe dallohesha në letërsi. Krenohesha gjithmonë me prindërit e mi. Dhe, kur më pyesnin se e kujt isha, iu përgjigjesha shkurt: Jam vajza e poetit Vehbi Skënderi.

Por shpejt do të vinte marsi i 1974. Ime më me shoqet kishte shkuar në Durrës për të festuar 8 marsin e do të kthehej në mbrëmje. Unë e shihja tim Atë shumë të shqetësuar. Shtypte diçka në makinën e shkrimit, e pastaj e hiqte fletën i pakënaqur dhe e fuste direkt në sobën e druve. Kur mbaroi, faqet e shtypura i mbajti vetë, fshehur në dosjen e poezive që ripunonte. Si një fëmijë kurioz, por edhe për të kuptuar se çfarë halli mund të kishte im Atë, mora fletët e kopjativit dhe nisa të lexoj. Aty lexova për herë të parë fjalën “korrupsion” dhe “qendër korrupsioni”.

Në ditët e mëpastajme, për familjen tonë do të niste një kalvar i gjatë, i mundimshëm, i frikshëm, nga ato që tregohen natën e varrit. Ne të tre do të përpiqeshim ta

përballonim duke dashur njëri-tjetrin sa më fort. Vetëm një herë, ishte qershor, unë posa e kisha mbaruar vitin shkollor, kur tim eti iu shemb toka nën këmbë dhe u nis i sigurt drejt vetvrasjes, për t’u hedhur nga ballkoni i apartamentit tonë në katin e tretë, me emrin tim në gojë dhe me brengën se nuk mundi ta mbronte dot familjen e sidomos të bijën e vetme nga ndëshkimi i të qenit bija e tij, bija e poetit. Për fat u ndodh xhaxhai im, Skënderi, që ishte oficer artilerie në Durrës, e që më vonë do ta përjashtonin nga partia dhe nga rradhët e ushtrisë sepse do të takohej me tim Atë ditën e varrimit të nënës së tyre, dmth gjyeshes time. Ai e shpëtoi tim Atë. Kjo ndodhi kur e thirrën në lagje, pasi e kishin lënë të papunë, kur i dhanë urdhër që, brenda javës, duhet ta nisej me familjen në internim në një fshat të humbur pas Dajtit.

Atë moment e humbi busullën im atë, në një ditë të bukur qershori tiranas nën prangat e burgut të braktisjes nga pjesa më e madhe e miqve dhe kolegëve, të cilët iu larguan dhe ai nuk kishte një derë ku të trokiste për ndihmë. E shihnin në rrugë drejt e në sy dhe bënin sikur nuk e njihnin, kishte nga ata që ndryshonin rrugën se ndofta iu vinte keq ose viheshin në pozitë të vështirë, kishte edhe nga të tjerë që e fyenin apo e kërcënonin me emrin e partisë në gojë. Im atë vritej pak e nga pak. Jo për vete. Vuajtja më e madhe e tim eti vinte nga pafuqia për të mos mundur t’i ndalte që pasojat e dënimeve të tij t’i vuante ime më dhe unë, bija e tij me flokët e verdha si Ofelia e tij, por që im Atë i thosh sime mëje të m’i krihte me kordele alla Jacky Kennedy. Nuk e përballoi im atë kur i thanë se brenda javës do të vinte makina të na internonte dhe unë do ta kisha të pamundur vijimin e shkollës. Sa ëndrra kishin thurur bashkë me time më për Lidkën, domethënë për mua. Dhe e gjitha ishte përmbysur bashkë me jetën e tonë në apartamentin tek Pallatet e Aviacionit, shkalla 12, apartamenti 84.

Përpara se të banonin në apartamentin tek Pallatet e Aviacionit, prindërit e mi të posa martuar, jetonin në dy dhoma të një vile buzë rrugës Kajo Karafilii afër ish Kursalit, që im Atë e kishte marrë me qira kur ishte beqar e punonte si gazetar duke vazhduar studimet. Ato dy dhoma, kur erdha në jetë, u bënë edhe shtëpia ime. Përpara se të martohej, im Atë kishte tërhequr në Tiranë gjyshe Selimen, nënën e tij dhe vëllain e motrën e vogël, xhaxhi Habipin e halla Bukurijen, që unë e thërrisja Tatale. E kam para sysh atë vilë, se aty jetoj gjyshja me familjen e xhaxhi Habipit, nusen e tij e dy vajzat e tyre, Enkeledën e Irmën deri sa morën një apartament me punë vullnetare, të ndërtuar në lagjen e Kombinatit të Tekstileve nga punëtorët e Fabrikës së Qelqit ku punonte xhaxhai. Dy dhomat me qira ishin në katin e parë të vilës me një oborr të brendshëm. Në të njëjtin oborr ku ndodhej një pus ngrihej edhe një vilë tjetër tipike tiranase me verandë ku jeshilonin gjethet e hardhive të rrushit. Të dy ndërtesat ishin ngjitur me Hotel Internacional përballë Shtëpisë së Oficerëve, që më vonë do të bëhej Lidhja e Shkrimtarëve. Korridor i madh i katit të parë ku ndodheshin dyert e dy dhomave gjithmonë në gjysmë errësirë ishte me dysheme prej dërrasash që, prej vjetërsisë, kërciste. Në njërën nga dy dhomat që përdorej edhe si guzhinë e dhomë ndejtje e gjumi me dritaren nga Hotel Internacional flinte gjyshja me xhaxhain dhe hallë Tatalen, ndërsa dhoma tjetër me dritaren nga Shtëpia Qendrore ishte jona. Në atë dhomë me tavane të lartë ndodhej një shtrat i madh me një mbulesë të bukur, që ime më e kishte sjellë në pajë, ngjitur të cilit kishin vendosur krevatin im të vogël, që, pa mbushur vitin, fillova ta kapërcej për t’u hedhur në krevatin e madh. Në atë dhomë të mbushur me flutura ëndrrash dhe dashuri im Atë do të shkruante poezitë me makinën e tij të shkrimit Corona që e solli edhe këtu në Zvicër.

Edhe kur ndërruam shtëpinë, aty vinim çdo ditë, deri kur im atë mori dënimin e parë me riedukim pranë klasës punëtore në Hidrocentralin e Vaut të Dejës. Unë e desha



shumë atë shtëpi me atë oborr. Im atë më ka fiksuar aty me aparatin e tij Laika që kur isha bebe deri sa mbusha dy vjeç, kur ndërruam shtëpinë, në disa foto më ka fiksuar me time më në oborrin e vilës ku unë luaja. Më ka fiksuar edhe në trotuarin buzë rrugës pranë portës kryesore nga hyhej në oborrin e bukur të ndërtesës. Aparatin fotografik e kishte blerë gjatë një udhëtimi në Riga, kryeqytetin e Republikës baltike të Letonisë. Që kur isha e vogël më fliste për poetin Rainis, se si adhurohej në vendin e tij. Kishte sjellë edhe albume fotografike ku e shihja Rainis në foto dhe monumente. Ai është poeti kombëtar i Letonisë që kishte vdekur më 1929, vitin kur im atë kishte lindur. Atëherë isha e vogël dhe nuk e kuptoja se përse im atë më fliste aq dendur për Rainis, se si letonët e adhuronin. Më vonë, kur u hap Shqipëria, mësova se Rainis me veprën e tij si poet kombëtar kishte qenë udhëheqësi shpirtëror për një Letoni indpendente.

Ne i qendruam tim eti rreth shtratit mbrëmjen e 12 qershorit, duke e kundruar e kundruar. Fytyra e tij ishte e bukur. Ngjyra e lëkurës ishte rozë. Im Atë nuk e tregonte moshën, ai është dukur gjithmonë i ri, i mbushur me energji të pashterëshme. Kjo bënte që unë të ndihesha gjithmonë fëmijë. Edhe mbrëmjen e 12 qershorit. Unë i vërtitesha rreth dhe ia puthja duart e faqet, ia prekja këmbët e bardha. Kisha një kaskatë lotësh që e mbaja me zor, duke iu lutur Zotit siç më kishte mësuar nënka, mamaja e sime mëje. Im atë ishte i pastër si drita. Unë e përkëdhelja, Babush, Babush i flisja, po të presim në shtëpinë tonë të kthehesh. Të lutem Babush. Ai nuk reagonte. Flinte. Nën efektin e qetësuesve. Që kur u shtrua në spital ai kishte qenë nën efektin e qetësuesve dhe vetëm një herë ishte zgjuar sa për të thirrur vetëm një emër: „Lili“. Emrin e gruas së tij e nënës sime. Librin e tij të parë me poezi titulluar “Këngët e para” im atë ia kishte dhuruar sime mëje, posa kishte nisur lidhja e tyre me një dedikim fatalist të shkruar me një kaligrafi të bukur të një 28 vjeçari “Me ty do të shkruaj edhe këngët e fundit Lili”. Dhe ashtu kishte ndodhur.

Duke e parë të flinte i qetë, dikur vonë, ne vendosëm të ktheheshim në shtëpi. Të bindur se të nesërmen do ta gjenim më mirë. Ishte mbrëmja e vonët e së dielës. Jeta gumëzhinte. Në tram u takuam me Endritin që kthehej nga kinemaja, e kishin marrë me zor shokët, sepse e dinin lidhjen e tij me gjyshin. Përpara filmit Endriti kishte qenë në spital. Zbritëm të tre nga trami në stacionin tonë dhe kur iu afruam shtëpisë, dritat e apartamentit tonë nuk ishin të ndezuara si zakonisht. Shtëpia jonë gjithmonë ishte e hapur, gjithmonë kishte njerëz e drita. I ramë ziles dhe derën na e hapi Prizreni. Ai po vuante. Im atë i kishte rritur djemtë. I kishte marrë sa kishin

ardhur në shtëpi nga materniteti, bebka dhe iu kishte përkushtuar kohën dhe jetën. Me një dashuri pa cak e kufi. U ka treguar me mijëra përralla, edhe ato që nuk m’i kishte treguar dot mua, i krijonte enkas për ta, u ka mësuar alfabetin e shqipes, gjuhën, u ka lexuar libra, u ka recituar poezitë e tij, poezitë e tij për ta. Midis tyre mbretëronte një aleancë sublime. Të dy djemtë tanë kanë qenë me fat që i ka rritur një gjysh si ai. Megjithëse të gjithë gjyshat e gjyshet e botës janë të mrekullueshëm.

Tani në shtëpi ishim të katërt. Familja Buçpapaj. Familja Skënderi ishte në spital. Folëm fare pak midis nesh. Djemtë ishin bërë burra papritmas. Pastaj mora në telefon time më që nuk i ishte ndarë kurrë tim eti. Edhe ajo më qetësoi. Po fle i qetë, më tha. Unë i qetësova të tjerët. Dhe u shtrimë të flemë si robotë.

Kishim fjetur pa ëndrra, shpejt, përhumbshëm, për t’iu larguar një frike. Deri kur ra zilha e telefonit, në mesin e natës që na ngriti menjëherë të katërve, gatitu. Zëri i panjohur matanë telefonit jepte lajmin që ne nuk do të donim ta dëgjonim kurrë.

Kur po gëdhihej 13 qershori dhe kalendari shënonte ditën e Shëna Ndout, shpirti i tim eti u largua prej trupit të tij. Në agun që ai e ka përmendur shpesh në poezitë e tij, ku ai e ka përshkruar me laryshi nuancash e ngjyrash, hijesh e dritash të pafundme. Por agu i ikjes së tim eti ishte i vërejtur, i humbur në tymnajën e mjergullave dhe ngjante e pamundur që kjo ditë të kish lindur prej barkut të një nate magjike qershori, kur ne u larguam nga spitali dhe e lamë tim atë në një gjumë të thellë e shpresëdhënës.

Gjithçka ishte përmbysur brenda dy-tri orësh, ashtu si jeta që ishte shndërruar në ikje, largim e vdekje. Për dy-tre orë qielli kishte ndryshuar uniformë në një antitezë të plotë. Ishte zhdukur hëna, yjet, magjia e natës kur ne i dhamë përshëndetjen, pa e ditur se do të që përshëndetja jonë e fundit në këtë tokë, pak përpara kur fryma e tij do të fluturonte si zog i çliruar nga prangat e një kohe mistrece, që tim atë e zhgënjeu fund e krye.

Kur ne vendosëm të largoheshim nga spitali, në prag të shkëmbimit të 12 me 13 qershorin, im Atë ngjante sikur flinte si normalisht. Nuk e kishte më frymëmarrjen e dendur, të vështirë, të mundimshme që e kishte pasur prej ditës së mërkurë, që do të na detyronte të premten të thërrisnim urgjencën, 144. Një ditë më parë, dmth të martën, ai bile kishte bërë një shaka me ne. Ime më ashtu si e kanë zakon gratë përdori klishenë e njohur se po vdiste prej lodhjes, dhe im Atë, që rrinte me orë e ditë të tëra pa folur, ia ktheu me buzën në gaz, « po për mua kush do të kujdeset atëherë?!» Reagimi i tij ne na hodhi të gjithëve përpjetë. Na zgjoi. Sepse sëmundja

e kishte transformuar. Ngjante si Mbreti Lir. Tragjik, i madhërishtëm, i vuajtur, i heshtur e solitar në botën e tij të mbyllur. Kështu e përjetonte largimin apo distancën nga mungesa e tij fizike me botën që kish patur rreth tij, nga mosprania në rrjedhat e ditës, në rrugët që ai i kishte kaluar çdo ditë, që edhe sot i mbajnë gjurmët e tij, siluetat e tij me republikë dhe një xhakëtë Hugo Boss të blerë në një dyqan me second hand.

Reagimi i tij na e ktheu humorin. Kujtuam se ishte shenja e rikthimit në jetë, për të shpëtuar nga sëmundja e zezë, që është depresioni, ashtu si kishte shpëtuar edhe në vitet ’70. Unë e mbaj mend atë kohë, se si vuante im Atë, si lëngonte. Pranë tij ishte im më dhe unë, fëmijë. E vizitonte rregullisht, për çdo ditë njëra prej hallave të mia, Lumja me fëmijët e saj dhe vëllai i tij i vogël, sepse të tjerët nuk vinin dot pasi kishin frikë nga partia kuçedër. Atëherë im Atë sapo i kishte mbushur 40 vjeç dhe ngjante i moshuar si një plak. Por një mëngjes papritmas u ngrit nga shtrati e ul në makinën e shkrimit dhe rinisi të shkruante poezi. Prej asaj dite nisi të dilte nga shtëpia e të shëtiste nga Kodrat e Liqenit. I vetmuar. Kolegët i largoheshin, shokët i fshiheeshin, të afërmit kujdeseshin për biografitë.

Por atë të martë, reagimin e tij e morëm si shenjë fatmirë, të daljes nga kështjella që kishte ndërtuar me mure qiklopikë prej heshtjes së vet. U lumturuam pasi e dinim se im Atë dinte të ngrihej gjithmonë më këmbë, se im Atë do ta kalonte edhe këtë sprovë, pas aq provash e vuajtjesh, që i kishte e kishim kaluar së bashku.

Por ndodhi e papritura dhe ai u përkeqësua papritmas të mërkurën. Iu vështirësua frymëmarrja. Ne u trembëm. Filluam t’i luteshim të hante. Sepse kishte dy vjet që kishte hequr dorë nga e ngrëna. E ushqente me shumë mundime ime më. Im Atë refuzonte ushqimin, refuzonte ujin, po ime më nuk dorëzohej deri sa e ushqente çdo ditë, çdo vakt, dalë e nga dalë, një kafshore, një lugë, ishte një fitore, një gllëngjë ujë, një gotëz me lëng frutash, ishte jetë për tim atë.

Unë po punoja në kompjuter atë të mërkurë, kur ime më më erdhi pranë e më tha se ai nuk po hante dot më. U ngrita menjëherë. I shkova pranë dhe i vura buzët në ballë. Si veproja me djemtë. Kishte temperaturë. I dhamë menjëherë një dafalgan dhe e shtrimë në shtrat. U qetësua pak. E zuri gjumi dhe frymëmarrja ju bë normale. Pasdite bashkë me Skënderin blemë biskota fëmijësh që ime më t’i shtypte e ta ushqente më lehtë.

Hëngri nga mbrëmja pa e refuzuar ushqimin si bënte zakonisht. Dukej se e mendonte atë që i ishte afruar dhe donte ta shmange vdekjen. Por ne nuk na shkonte mendja fare tek vdekja.Kur ra nata i shkova në dhomën e tij ku flinte. Dhe qava e qava me lot e pa zë. Për të gjitha vuajtjet që kishte hequr, pa i bërë kujt keq në jetën e tij. E pastaj iu luta Zotit që vetëm ta linte të jetonte. Edhe me depresion. Veç të jetonte. Ishim mësuar tashmë edhe me këtë gjendjen e tij. Ai rrinte i ulur në kolltukun e tij në një cep të dhomës. Hijerëndë, pa folur, duke na parë herë herë ne. Herë i përhumbur në mendimet e tij, herë me sy të trishta e herë me sy të trembura, sepse e shkuara i kthehej si fantazmë, si makth e ankth. Mallkuar qofshin ata që e kanë bërë tim atë të vuante. Që nuk kanë marrë mundimin kurrë të kërkojnë ndjesë. Një pjesë e tyre kanë shkuar në ferr. Në ferr shkofshin të gjithë që e kanë merituar. Sepse nuk e njohin ende pendesën.

Im Atë ishte shtruar në spital edhe në marsin e 2011, për rehabilitim, pas një reaksioni që pati prej një pomade me antibiotikë. Një natë vonë na mori ime më në telefon, kur nuk kishte shumë që kishim shkëmbyer me njëra tjetrën natën e mirë, pasi ajo rrinte me tim Atë. Nga telefoni ime më ngashërente. U tremba. Jo, jo, mos u bëj merak, ma ktheu ajo. Desha t’ju tregoja se pak para se ta zinte gjumi Vehbiu më tha « ata nuk na lanë që ta jetonim jetën tonë, Lili». « Ata » nuk ishte thjeshtë një përemër vetor në numrin shumësh. “Ata”

(vijon në faqen 11)

Libri “Në emër të gjakut” i autorit Ahmet Prençi, L nuk është vetëm një përmbledhje tregimesh dhe novelash; është një thirrje, një gjëmë, një përulje përpara së vërtetës së hidhur që përshkroi Shqipërinë në vitin 1997, vitin e krizës më të madhe të pasluftës, vitin e zhveshjes së shtetit, të thyerjes së njeriut dhe të përplasjes mes jetës dhe instinktit për të mbijetuar.

Në një kohë kur shumë ngjarje tronditëse të historisë sonë moderne janë lënë në harresë ose janë trajtuar me heshtje të qëllimshme, libri “Në emër të gjakut” i Ahmet Prençit vjen si një akt i fuqishëm i kujtesës, një thirrje e zëshme kundër harresës kolektive dhe një përulje ndaj atyre që u flijuan përballë rrënimit të shtetit dhe strukturave të tij. Autori nuk shkruan nga jashtë, si vrojtues i ftohtë, por si pjesëmarrës dhe dëshmitar i një kohe të çakorduar, i një shoqërie që në vitin '97 përjetoj kolapsin më të thellë moral, institucional dhe njerëzor pas diktaturës komuniste.

Autori, librin e fillon me një deklaratë të qartë: “*Në emër të gjakut është një kujtim, një përulje dhe një zë që sdo të shuhet kurrë.*” Kjo fjali nuk është vetëm hyrje stilistike, por edhe një formë betimi. Në frymën e filozofisë ekzistenciale, ku njeriu është përgjegjës për të dhënë kuptim ekzistencës së tij, Prençi i jep kuptim të kaluarës përmes aktit të kujtimit dhe rrëfimit. Ai vendos të flasë për ata që nuk mundën me të tjerët të flisinin.

Ahmet Prençi, ish-drejtues i Policisë së Shtetit, autor i librave “Anja”, “Brenga e Prokurorit”, edhe në këtë libër po ashtu ndërthur përvojën personale dhe dëshminë institucionale me rrëfimin artistik, duke ndërtuar një mozaik letrar dhe dokumentues, ku historia e afërt merr formën e artit letrar. Ai nuk ka zgjedhur një rrugë të lehtë: Të shkruash për një plagë të gjallë kërkon guxim dhe ndershmëri. Por, më shumë se kaq, kërkon edhe dhembshuri. Dhe këtë e gjejmë në çdo rresht të librit. Libri “Në emër të gjakut” është i ndarë në tregime dhe novela ku secila e shton një gur të rëndë në mozaikun e kujtesës.

Nëpërmjet këtyre rrëfimeve, Prençi na fton të shohim jo vetëm një të kaluar të afërt, por edhe peshën e asaj tragjedie që ende nuk është tejkaluar. Kjo nuk është letërsi e së shkuarës, por letërsi e një plage që akoma rrjedh. Këto tregime dhe novela flasin për katrahurat e kombit, por në to spikat një dimension tjetër: guximi i individit për t'i dalë zot vendit të tij, jo me fjalë, por me jetën e vet. Për autorin, viti 1997 në Shqipëri nuk është thjesht një datë, por një rrëfim kolektiv i kolapsit moral dhe institucional. Filozofi gjerman Friedrich Nietzsche shkruante se “*kur shikon gjatë në humnerë, edhe humnera fillon të shikojë brenda teje.*” Këtë e ndiejmë në çdo faqe të këtij libri. Prençi i afrohet asaj humnere të errët që ka qenë dhuna, shteti i rrëzuar dhe drejtësia e zhdukur. Ai e sheh dhe e përshkruan atë, por mbi të gjitha, e bën lexuesin të ndjejë se kjo humnerë ende na shikon me kundërriminin e saj.

Në “Pallati presidencial që nuk ra”, autori e përshkruan qartësisht rrezikun e zhdukjes totale të strukturave, por gjithashtu lartësimin e dinjitetit njerëzor si një formë rezistence të vetme. Ndërsa te “Masakra e romëve”, ballafaqohemi me një të vërtetë të hidhur: Kur humbet drejtësia, fillon ligësia të shfaqet pa maska. Janë rrëfime që përshkojnë dramën e një kombi, por që gjithashtu tregojnë se në rrënojat e një shteti të shkatërruar, njeriu mbetet e vetmja fije shprese ose akti i fundit i dhunës. Nëpërmjet tregimeve dhe novelave të këtij libri si: “Në emër të gjakut”, “Ditari i marsit të zi”, “Pallati presidencial që nuk ra”, “Masakra e romëve”, “Emblema e kujtesës”, dhe “Pse më vrave?”, autori rindërton një tablo të thellë të shpërbërjes së shtetit dhe të përpjekjes njerëzore për të mos u shuar shpirtërisht. Këto rrëfime janë zëra që vijnë nga buzë humnerës, ku njerëzit nuk kanë më asgjë për të humbur, por ruajnë akoma një grimë nderi, besimi, dhe përgjegjësie për të mos rënë si kafshë në thikën e një çrregullimi total.

Në novelën “Masakra e romëve”, autori shkruan: “*Në mendjen e një banditi gjithmonë mbetet një qelizë e errët, një fije instinkti që nuk shuhet: për hakmarrje ose për marrëzi.*” Kjo është pikërisht ajo që Nietzsche përshkruan si vullnet për fuqi jo në kuptimin e dominimit brutal, por në atë të mbijetesës dhe përpjekjes për të krijuar një rend në kaos. Kur shteti mungon, drejtësia ajo më e ftohta dhe më e egra e gjen vetë rrugën e saj. Në atë moment, populli që s’e pyet askush, vendos vetë të mos shkelet më. Revolta bëhet formë ekzistence. Në novelën tjetër, “Në emër të gjakut”, Shqipëria përshkruhet si një vend që “ziente”, një vend ku “*ajri kishte aromën e frikës dhe të heshtjes së rëndë që pason para se të ndodhë e keqja.*” Prençi e sheh këtë jo vetëm si krizë politike, por si çarje ontologjike, morale dhe shoqërore. Një moment thellësisht filozofik është përshkrimi i gruas shqiptare që i thotë burrit të saj: “*Unë s’jam më ajo që ke lënë.*” Ky është çasti kur përmasat e dhunës nuk janë më vetëm fizike, por shkojnë deri në rrënimin e identitetit. Në atë botë të rebeluar, sipas Nietzsche-s, vlerat tradicionale zhduken dhe krijohet hapësira për një “rilindje të vlerave të reja” por jo gjithmonë të drejta.

“Në emër të gjakut” i Ahmet Prençit (Botim i MediaPrint)

Një dëshmi për brezat e ardhshëm

Nga Ajne Ibërhysaj

Për personazhin kryesor të novela “Në emër të gjakut”, gjendja shpirtërore arrin kulmin kur ai thotë: “*S’e bëra për hak. Jam bosh. E bëra në emër të gjakut.*” Ai nuk ka urrejtje, por një boshllëk ekzistencial që ngjason me konceptin e absurdit tek Albert Camus kur njeriu nuk gjen më kuptim në asgjë dhe veprimi i tij është një akt i fundit i revoltës dhe mbijetesës morale. Ai nuk kërkon drejtësi për hakmarrje, por për të shlyer një mallkim që nuk mund të lejohet të trashëgohet. Në përmbyllje të kësaj novele, autori shkruan: “*Jetojmë në një botë ku burrat flasin me plumba, gratë me heshtje dhe drejtësia ka çmimin e shpirtit.*” Kjo është një botë ku e vërteta nuk është më objektive, por një zgjedhje morale. Nëse, siç thoshte Martin Heidegger, “*njeriu është qenie për vdekje,*” dhe është pikërisht kjo vetëdije që i jep thellësi jetës atëherë të shkruash për jetën në prag të vdekjes është akti më i lartë i përgjegjësisë ndaj të ekzistuarit. Këto janë histori që nuk qëndrojnë vetëm në nivelin e një përshkrimi faktik, por hyjnë në psikiken e individit, në plagët që nuk shihen. Shtëpia pa oxhak, fjala e thyer, njeriu që i lutet Zotit pa e ditur më si, djali që nisët për t’u kthyer si hije të gjitha këto krijojnë një atmosferë që lexuesin e përfshin të tërën.

Viti 1997, “Ulërima që u shua në letër”, vit i cili për Shqipërinë përfaqëson një plagë të hapur. Rënia e skemave piramidale, përplasja civile, rënia e strukturave shtetërore dhe shpërbërja e rendit publik u kthyen në një spirale dhune, frike dhe anarkie. Prençi përshkruan këtë realitet me një stil lakonik, të matur dhe emocionalisht të ngarkuar. “1997-ta, viti që la Shqipërinë pa frymë; nënat shikonin qiellin pa e ditur se për çfarë t’i luteshin

Zotit.” Ky përshkrim nuk është vetëm letrar. Ai është ekzistencial. Shqipëria e asaj kohe nuk është më vetëm një vend pa rend, por një vend pa frymë, pa orientim, pa Zot. Në këtë boshllëk, njeriu përballët me thyerjen e plotë të kuptimit dhe qëllimit dhe ky është rreziku më i madh që sjell dhuna kolektive: Jo vetëm shkatërrimin fizik, por rrënimin e ndjenjës së përkatësisë dhe shpresës për një të nesërme pa dhunë. “Një tregim nga Varshava”, ku autori rikthen kujtimet e një studenteje të huaj gjatë sistemit dhe martesës së saj në Shqipëri, me përplasjen e shpirtit njerëzor me realitetin brutal. Kjo dëshmi e gjallë na bën të kuptojmë se sa thellë u godit shoqëria dhe sa shumë ëndrra u shuan.

Libri i Ahmet Prençit është zëri i grave të atij viti ku në mënyrë të veçantë, autori sjell në qendër të vëmendjes dhimbjen e grave shqiptare: nënat që nuk dinë ç’t’i luten më Zotit, që ngelen me sy nga qielli, pa përgjigje, pa drejtësi. Në një prej faqeve apo shprehjeve më të fuqishme të librit thuhet: “*Nëna shikon qiellin pa e ditur çfarë t’i lutet Zotit.*” Është një imazh që bart brenda gjithë tragjedinë shpirtërore të asaj kohe. Jo vetëm për humbjen e jetëve, por për humbjen e besimit te një rend shoqëror dhe etik. Autori nuk e shmang përgjegjësinë, as nuk e zbukuron të vërtetën. Ai e thotë qartë se: “*keqja shqiptarëve u vjen nga vetvetja, nga vetë gjaku i tyre.*” Dhe në këtë mendim të dhimbshëm, por të ndershëm, qëndron qartësia më e madhe që ofron libri.

Në thelb, ky libër është një përpjekje e vetëdijshme për të mbajtur gjallë kujtesën kolektive në një shoqëri që ka tendencë të harrojë. “Është një ulërimë e shuar në letër”, thotë autori, duke i



dhënë librit një dimension metaforik të thellë. Libri nuk është thjesht përshkrim i dhunës, por akt i ripërjetimit të saj, jo për të traumatizuar lexuesin, por për ta ndërgjegjësuar atë. “*Është përpjekje për të mbajtur mend kur gjithçka rreth nesh na mëson e na dikton të harrojmë.*” Kjo thirrje nuk është vetëm për të mos harruar viktimat, por për të mos lejuar që një realitet i tillë të rikthehet. Për autorin, të shkruarit është një formë e aktit civil, e qëndresës kulturore dhe morale.

Një nga linjat më të forta të librit është raporti mes individit dhe shtetit. Në shumë prej tregimeve të autorit, protagonistit është një qytetar, një polic, një prind një njeri që papritur gjendet vetëm përballë një realiteti të egër ku shteti është zhbë dhe drejtësia është zhveshur nga kuptimi. “*Nuk kemi shtet. Nuk kemi drejtësi. Kemi vetëm njëri-tjetrin.*” Kjo fjali përmbledh krizën themelore: Njeriu është lënë vetëm, pa institucione, pa garanci, në një hapësirë ku çdo vendim bëhet në bazë të ndjenjës, jo ligjit. Në këtë përmbysje të vlerave, njeriu përballët me zgjedhjen e madhe: të bëhet një me kaosin, apo të qëndrojë me dinjitet! Shumica e personazheve të Prençit zgjedhin këtë të fundit, duke i dhënë librit përmasën e tij më të thellë: njerëzimi në kohë errësire.


Stili i Ahmet Prençit është i matur, i ngjeshur, por jashtëzakonisht i ngarkuar emocionalisht. Ai nuk bie në retorikë, nuk shfrytëzon patetizmin, por ndërton me fjalë të zgjedhura një atmosferë që lë gjurmë të lexuesi. Ka një theks të qartë të zbërthen kompleksitetin dhe një rrjedhshmëri që ngjall reflektim. “*Shtëpia jonë s’ka më oxhak, as zë, as jetë.*” Me pak fjalë, autori arrin të përshkruajë një boshllëk ekzistencial. Ai nuk përpjet që t’ na bindë me argumente, por me ndjeshmëri dhe kjo e bën veprën më të thellë se një libër historik apo sociologjik. Është një libër që bën atë që nuk e ka bërë dot sistemi: gjykon padrejtësinë. Jo me urrejtje, por me kujtesë. Jo me dënime, por me rrëfim. Çdo faqe është një formë e hapur e shprehjes: “*ja çfarë ndodhi – mos e harroni.*” Dhe kjo, në vetvete, është një akt i jashtëzakonshëm në një shoqëri që shpesh ka heshtur përballë të vërtetave të dhimbshme. Në këtë mënyrë, vepra e tij bëhet më shumë se një akt letrar bëhet një akt etik, një akt qytetar. Është një përkujtimore për ata që u flijuan dhe për ata që mbijetuan me plagë të heshtura. Është një udhërrëfyes për ata që sot kërkojnë të kuptojnë rrënjët e çarjes shqiptare, dhe një paralajmërim për brezat që nuk e kanë jetuar atë kohë. “Në emër të gjakut” nuk është libër që lexohet lehtë sepse nuk mund të lexohet pa u ndjerë, pa të dhënë të drejtën të mendosh dhe të kujtosh atë kohë. Është një vepër që nuk flet vetëm për vitin 1997, por për fragjilitetin e njeriut dhe shoqërisë përballë kolapsit institucional. Është një himn për qëndresën dhe një lutje për drejtësi.

Për lexuesin shqiptar, ky libër është një thirrje për reflektim. Për brezat e rinj, është një mundësi për të mos e harruar atë, se çfarë ka ndodhur në atdheun e tyre. Për studiuesit dhe kritikët, është një dëshmi letrare e një periudhe që duhet trajtuar jo vetëm me ftohtësi historike, por edhe me ndjeshmëri njerëzore, për të vërtetën.

Ahmet Prençi nuk shkruan për të fituar zemrat e lexuesve, por për të zgjuar ndërgjegjen e tyre. Libri “Në emër të gjakut” nuk është një libër që lexohet lehtë por është një libër që duhet lexuar. Ai nuk kërkon keqardhje, por reflektim. Nuk kërkon lavdërim, por drejtësi. Dhe kjo e bën librin e tij një nga veprat më të rëndësishme të letërsisë shqiptare bashkëkohore që merret me tragjeditë e kombit në mënyrë të ndershme, të thellë dhe njerëzore. Edhe vet titulli i librit “Në emër të gjakut” në kontekstin e Ahmet Prençit, ai përfaqëson kujtesën, përgjegjësinë dhe ndëshkimin moral që mungon nga institucionet e shtetit. Ai shfaqet si një etikë individuale, një nevojë për të lënë gjurmë në një vend ku e vërteta mbulohet: “*si bora mbi varre – mbulon gjithçka por nuk ngroh asgjë.*” Këtë recension të librit e përfundoj me një thënie që përmbledh më së miri thelbin nga autorja Isabel Allende: “*Vdekja nuk ekziston, njerëzit vdesin vetëm kur harrohen; Nëse mund të më mbani mend, unë do të jem gjithmonë me ju.*” Atëherë sipas autorit A. Prençi, “*jo çdo plagë kërkon drejtësi.*” Dhe krejt në fund ky libër është një dëshmi e fortë për brezat e ardhshëm, sepse ata duhet të mësojnë nga e kaluara e tyre, për ta ndërtuar një të ardhme më të drejtë dhe humane për atdheun e tyre.



Karikaturë nga Arben Mexsi



(vijon nga faqja 9)

identifikohen me emra e mbiemra. Shkofshin në djall, në ferr. Sepse na e kishin ndryshuar tërësisht rrjedhën e jetës, brutalisht, na kishin detyruar të jetonim kalvarin dhe kanë mbetur deri në fund përbindsha. Sa e sa mijra jetë kanë shkatërruar “ata”, ai regjim.

Sot është e trishtë kur lexojmë se disa shkrimtarë qahen nga vuajtjet që paskan përjetuar në diktaturë. Shkrimtarët e regjimit, tani të tranzicionit, të superstrukturës staliniste, tani të superstrukturës së tranzicionit që ka shpopulluar vendin. Një farsë e vërtetë cinike ndaj vuajtjeve, dramave dhe tragjedi të vërteta, ndërsa kultura shqiptare sot po identifikohet me antikulturën.

Ne e shtruum në spital të premtën, kur frymëmarrja iu rëndua rishtas. Ishte 10 qershor, paradite. Sa herë i shoh sot makinat e verdha të urgjencës më kaplon trishtimi, një makinë e tillë na e kishte marrë edhe time më. Kur erdhi urgjenca, im Atë nuk ishte më im Atë. Erdhën e morën lart me barelë sepse ishte krejt i pafuqishëm. Mezi merrte frymë. Nuk më kërkonte mua me sy, por time më e cila hypi me të në makinë. Ne i shkuam pas. Pas kësaj ai nuk u kthye më në shtëpinë tonë. Ishte ikja e tij e fundme.

Frymëmarrjen e tij të rënduar e kam edhe sot në vesh, si asaj të premtë. Dukej sikur prapë po luftonte, deri në frymën e fundit.

Pasi e shtruum në spital të premtën, e pasi biseduam me mjekët u kthyem për t’u kujdesur për fëmijët. Sa hymë në shtëpi, na ra në sy kolltuku i tij bosh, që priste më kot. Në dhomën e tij makina e shkrimit rrinte e heshtur, me tastet e ngurta si copa kalldrëmash, të palëvizur nga gishtat e bukur të tim eti. Gjithmonë im atë na e kujtonte se si një pianiste e njohur shqiptare mahnitej nga gishtat e bukur të tim eti, që tani rrinin të palëvizur dhe nuk krijonin vargje e rima me makinën e tij të shkrimit. Makina e shkrimit ishte si faltore për tim atë. Atje ai falej duke zbrazur shpirtin e tij të kthjellët si kristali. Kanë qenë shumë të rrallë shkrimtarët bashkëkohës me tim atë që e kanë patur shpirtin e pastër si të tijin. Pa asnjë njollë. Shpirt njeriu. Ecce Homo ishte im atë.

Ne vazhduam që t’i luteshim Zotit që im atë ta kalonte edhe këtë furtunë. Ishim mësuar tashmë edhe me këtë situatë. Ai rrinte i ulur në kolltukun e tij dhe na ndiqte me sy. Nganjëherë i shpinte sytë diku larg, nganjëherë i mbyllte si për të mos lejuar që tmerret e së shkuarës t’i ktheheshin si fantazma për ta marrë e larguar nga familja, për t’ia marrë e djegur librat, për ta dërguar në riedukim apo internim, duke i lënë në mes poezitë apo treguar përgjysëm përrallat që ia tregonte së bijës, dmth mua. Aty i ulur në kolltukun e tij, ai me pamje epike, ngjante si një personazh i dalë nga cikli i kreshnikëve. Nganjëherë, dikur, rrallë e përherë rrallë e më rrallë, kur na hidhte ndonjë fjalë, si meteor, na bënte të hidheshim përjetë dhe kaq pak na dukej aq shumë, sepse mendonim se po i mblidhte forcat për të dalë nga ky tunel i errët. Por fjalët që i tha sime mëje se “ata nuk na lejuan ta jetonim jetën, Lili” përmblodhën gjithë jetën e tij përfshi edhe frymën e fundit. Ky është epitafi i pashkruar i tim eti aty ku prehet. A prehet i qetë? Nuk besoj. Poetët janë rebelë, kudo qofshin në tokë apo në Qiell.

Sapo zëri në anën tjetër të telefonit do të na jepte lajmin, thirrëm taksinë dhe në minutat që prisnim i qetësuam sa mundëm fëmijët. Nuk kishte zbardhur ende kur taksia mori rrugën nga spitali Bruderholz, qielli ishte i mrrolët, i errët dhe temperaturat ishin ulur menjëherë. Sapo arritëm në spital vrapuam tek dhoma e tim eti, ku na priste ime më. Im Atë i shtrirë në shtrat, ende i ngrohtë. Të tre qanim në heshtje, unë herë pas here ngrihesha dhe e përkedhelja, duke ia numëruar me zë vuajtjet.

Një javë më parë se im Atë të sëmurej kisha rilexuar Testamentin e Mitrush Kutelit për gruan e fëmijët. Kuteli u largua nga kjo jetë 59 vjeç, i sëmure, i helmuar nga vuajtjet duke jetuar në “një tokë tek gëlojnë gjarpërinjtë e të vrasin shokët, se u bën hije”. Mitrushi kishte kaluar 22 vjet në emigrim dhe amaneti që i linte bashkëshortes ishte: “Fëmijët i porositi ta duan vendin dhe gjuhën tonë gjer në vuajtje. Të mos u shkasë zemra kundër Shqipërisë as kur do të vuajnë pa faj. Atdheu është atdhe, bile atëherë kur të vret.” Mitrush Kuteli iku i helmuar. Lazgush Poradeci iku i helmuar. Buratinët e sosrealizmit, ata që sot mbajnë flamurin e kulturës trash dhe shpërndajnë urrejtje nuk kishin marrë mundimin që ta takonin, ta intervistonin, ta filmonin.

Unë e shihja tim Atë të shtrirë pa jetë dhe pyesja veten a duhet të ndihesha fajtorë që i luta prindërit të jetonin me ne në Zvicër. Im Atë ishte Atdheu për ne. Atdheu i bukur, delikat, që përkujdesej për ne, që shkruante poezi, si tragjedi të kohës kur jetoi. Im Atë ishte Atdheu, aq shumë e deshi. Ishte Atdheu që përhap dashuri, se Atdheu nuk vret.

Prindërit na ishin bashkuar në Zvicër më 15 qershorin e 1996, ndërsa im Atë ndahej nga jeta më 13 Qershor 2011. Përveç dy viteve të fundit, im Atë kishte qenë shumë aktiv. Ai shkrunte rregullisht publicistikë tek Bota Sot dhe i ishte përkushtuar poezisë, i çliruar totalisht nga censura dhe autocensura. Janë vitet më të frytëshme të krijimtarisë së tij poetike. Pas librit “Bëjmë sikur”, botuar në Tiranë më 1995 me redaktore Donika Omarin, botoi në Tetovë më 1996 librin Hënë e vjedhur me redaktor Agim Vincën, ndërsa më 2004 Faik Konica në Prishtinë do t’i botonte Zvicra, Shqipëria ime. Në 2012 postmortum Omsca-1 do të botonte Mirëmëngjes Shqipëri, libër voluminoz me poezitë e fundit të jetës. Gjithëçka e mbuluar nga indiferenca, nën tingujt e dajrexhijve shkrimtarë ku përdridhen çingjitë e zhveshura nga çdo lloj shije arti në sallat bosh të paguara nga arka e shtetit atje ku vritet kultura shqiptare dhe promovohet antikultura.

Mos harroni. Po e ripërsëris. Poetin Vehbi Skënderi nuk e varën në litar si Havzi Nelën apo me një skuadër pushkatimi, por me injorim dhe indiferencë. Indiferenca është krim. Institucionet e shtetit, nga niveli më i lartë deri tek Ambasadat që ushtrojnë në heshtje krimin e indiferencës ndaj vlerave të vërteta, duke promovuar antivlerën e përdhunuar shijet që krijon arti i vërtetë, janë sot dhomat e hetuesisë që në diktaturë torturonin dhe vrisnin elitën e vërtetë dhe poetët.

2014-2025

“Vallëzim me hënën” i shkrimtarit Namik Dokle prezantohet në tre qytete të Spanjës

(Madrid, Cadiz dhe Benalmádena)

Në ditët e fundmajit dhe fillimqershorit, në tre qytete të Spanjës (Madrid, Cadiz dhe Benalmádena) u bë prezantimi i librit të shkrimtarit Namik Dokle “Vallëzim me Hënën, libri i legjendave të Gorës, i përkthyer dhe botuar në spanjisht pak kohë më parë.

Prezantimi në Madrid u bë në librarinë e famshme “Tierra del fuego”. **Botuesja Ana Cristina Herreros**, në katalogun e së cilës numërohen libra legjendash nga shumë vende të botës, tha që ky libër i shkruar aq bukur nga Dokle, ndryshe nga libra të tjerë që kemi botuar nga vende dhe kontinente të mëdhenj, vjen nga Gora, një krahinë e vogël, e ndarë në tre shtete, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedonia e Veriut. Legjendat magjike të Gorës na tregojnë se popujt, të mëdhenj apo të vegjël qofshin, kanë shpirt të madh, tradita dhe zakone të bukura, legjenda e ballada të pavdekshme. Ato i bëjnë të tilla vetë popujt, por edhe shkrimtarët si Namik Dokle, që i shpëtojnë ato nga greminat e harresës.

Ilustruesi i librit, Jesus Gabán, një nga më të njohurit në Spanjë, fitues i disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në katalogun e të cilit bëjnë pjesë shkrimtarë nga më të njohurit e vendit të tij, por edhe autorë të huaj, mes të cilëve Dostojevski, Gorki dhe Çehov, tha që ilustrimi i librit të Namik Dokles më solli kënaqësi estetike, me thjeshtësinë dhe magjiken që bartin legjendat e tij. Të vështirë e pata me kopertinën e librit, ngaqë doja të përfshija në të tre vajzat, hënën dhe blirin nën të cilin ato vallëzonin dhe zgjidhjen e gjeta me duart e vajzave që luajnë magjishëm me hënën, duke ndriçuar kurmin e tyre të bukur. Më vjen mirë që lexuesit dhe autori e kanë pëlqyer shumë, ndëkohë që nga META është censuruar paksa.

Përkthyesja e librit, Maria Rocés Gonzales, tha: “Në krahinën ballkanike të Gorës, e ndarë në tre shtete, e banuar nga goranët; me të folmen e tyre të veçantë, me rrënjët e origjinës në një lashtësi heretike, është fshati Borje, në pjesën shqiptare të kufirit, ku dielli lind dy herë në ditë dhe hëna perëndon dy herë natën, ku dihet se tre vajza kanë vallëzuar me hënën, ku rriten bimë dhe lule të shenjtëruara, zogjtë e Gorës këndojnë çdo pranverë nëpër botë për t'i lajmëruar goranët të kthehen për festën e ndritur të Shën Gjergjit; atje ka ditë që hapet edhe qielli për të plotësuar dëshirat e njerëzve, ka përrenj të shurdhër dhe rrëqe që flasin, ka yje që bien në prehërin e nuseve të fshatit, ka këngë e melodi që e çajnë edhe gurin dhe, aty jeton edhe një plakë treqind vjeçare që rrëfen kronikën dhe kujtesën e të gjithë kohërave.

Në këto troje ballkanike dhe legjendare udhëton Namik Dokle, i prirë nga bashkëbanorët mitikë të krahinës së tij, të cilët, për herë të parë, si në shqip edhe në spanjisht, përshfaqen në një libër.”

Ajo citoi edhe artikullin e botuar nga historiani dhe **shkrimtari Emilio Sola**, i cili ka shkruar se “ larmia e këtyre tregimeve është e pasur, me një mjedis rural dominues, me gjallesa të humanizuara dhe magjike, histori familjare dhe të emigrantëve, me ndodhi nga epoka otomane, siç është ajo e “Mallkimit të Sinan Pashës”, dëshmi impresionuese e vështimit të asaj periudhe nga perspektiva popullore, si një prani e largët dhe e egër. Shumë nga këto legjenda reflektojnë po atë botë si edhe romani i Namik Dokles “Vajzat e mjegullës”, dy lexime, pra, përplotësuese dhe me burim të njejtë frymëzimi. Në këtë ndikon autorësia e Dokles, po ashtu edhe përkthimi i dy veprave nga Maria Rocés, e cila gjen bjeshkët e Asturias së saj në tokën dhe kullotat e krahinës ballkanike.”

Prezantimin në Cadiz e hapi **Ricardo Carpintero, kryetari i fundacionit Fernando Quiñones** me fjalët: “ Jemi shumë të kënaqur që në qendrën kryesore kulturore të qytetit, të presim shkrimtarin shqiptar Namik Dokle. Fodacioni ynë mban emrin e një shkrimtari dhe gazetari të shquar me origjinë nga provinca e Cadiz-it. Edhe Dokle është

shkrimtar dhe gazetar. Të dy të pasionuar; Quiñones pas flamencos legjendare gaditane dhe Dokle pas legjendave gorane.”

Shkrimtari Juan José Tellez e vlerësoi veprën si “ një libër surprizues, i cili na sjell një botë të panjohur, Gorën Ballkanike, nëpërmjet një letërsie magjike që mua më kujton legjendat e Guatemalës, të letrarizuara nga Miguel Ángel Asturias. Nëse Faulkneri e krijoi në imagjinatën e tij Yoknapatawpha-n e tij dhe Markesi Macondon, Dokle shkruan për një krahinë reale, të panjohur por magjike, të largët por që e ndiejmë të pranishme nëpërmjet librave të tij, “ Vajzat e mjegullës” dhe “Vallëzim me Hënën “ të botuar në spanjisht. Namik Dokle nuk ka thirrur imagjinatën; legjendat dhe baladat e Gorës kanë jetuar në brendësinë e tij që nga fëmijëria dhe deri sot që i ndan me ne.”

Fjalën e mirëseardhjes në prezantimin e librit, në sallën e evanteve të kështjellës Bil-Bil të Banalmadenës e mbajti nënkryetarja e bashkisë, **Presi Aguilera Crespillo**, e cila, ndër të tjera tha: “ Është për mua nder dhe kënaqësi të prezantoj sot këtë vepër të veçantë për Vajzat që vallëzuan me hënën, të autorit shqiptar Namik Dokle. Është për t'u shënuar që ky libër vjen në spanjisht dhe, kur autori është shqiptar, nuk mund të kalojë pa u vënë re. Është një zgjedhje që flet shumë për ndjeshmërinë kulturore të autorit, të dashurisë së tij për gjuhën spanjolle, për letësinë dhe historinë e saj, për Spanjën. Libri i legjendave të Gorës është një vepër unike, e mbushur me lirizëm, emocion dhe kujtesë.”

Kryetari i shoqatës së shkrimtarëve të Kastija La Mançës, Alfredo Villaverde Gil, theksoi se “ Dokle rikrijon një histori sa reale aq edhe magjike, me zakonet, traditat, mitet dhe legjendat, duke na paraqitur një afresk letrar të cilësisë së lartë, me vlera emocionale, të cilat, me romanin “Vajzat e mjegullës” dhe tashmë edhe me legjendat e Gorës, mund t'i njohim dhe t'i shijojmë edhe në spanjisht, falë përkthimit mjeshtëror nga Maria Rocés.” Pasi e vlerësoi librin si një dëshmi e padiskutueshme e traditave të bukura dhe vlerave të kulturës shqiptare si edhe të talentit të autorit, e nderoi atë me **medalionin Cervantes**, në emër të shoqatës që ai drejton.

Ndërsa **shkrimtari Pedro Delgado**, i pranishëm në event, ka shkruar: “ Disa prej legjendave të këtij libri i kemi hasur edhe në romanin “Vajzat e mjegullës”, por shumica e tyre janë një risi për mua dhe lexuesin spanjoll. Një surprizë magjike që, përveç se të jep mundësinë të njohësh një trashëgimi kulturore krejt të veçantë, krijon mundësinë që të mos humbasin këto përjetime legjendare. Talenti krijues i Dokles na ka ritreguar 52 legjenda të Gorës, një pjesë prej të cilave ende jehonin në krijimtarinë popullore, disa prej tyre pëshpërisnin dhe të tjera që ishin në grahmat e fundit të kujtesës. Ato karakterizohen nga lirika, më shumë se nga epika, nga këngët e dashurisë më shumë se ato të luftës, nga përjetimet e viktimitave të historisë se sa ato të heronjve të saj. Por nuk janë të pakta edhe ato legjenda ku ndëthuren lirizmi me tragjizmin e dashurive njerëzore.”

FERIA DEL LIBRO
DE MADRID

Sábado
31 de mayo
De 12h a 13h



NAMIK DOKLE
firmarë “Las muchachas que
bailaron con la luna y otras
leyendas de Gora”



ESPACIO MAR DE IDEAS
CASETA 398

Vështrim i romanit “Gega i Motit” të Ernest Markut

Nga Mirela Papuçiu

Romani *Gega i Motit* i Ernest Markut është romani i krizës së thellë të identitetit të njeriut dhe të burrit që përballlet me transformimet dramatike në Shqipërinë totalitare dhe post-komuniste.

Përmbledhja e veprës

Romani përqendrohet tek Adami Liburni, një ish-i burgosur politik që kthehet në një Shqipëri të transformuar, por ende të dominuar nga hija e së shkuarës. Ai përjeton humbjen e identitetit në një botë ku vlerat janë përmbysur dhe ku traditat ende dominojnë marrëdhëniet shoqërore. Përplasja e tij me të kaluarën dhe përpjekjet për t'u integruar në një realitet të ri, krijojnë një narrativë që shpalos tensionin midis së vjetrës dhe së resë, mes fatit të shkruar dhe vullnetit të lirë.

Pjesa e dytë e romanit sjell thellimin e konfliktit të Adamit me komunitetin dhe të kaluarën e tij. Përmes një qasjeje retrospektive, lexuesi zbërthen mekanizmat e një shoqërie të mbyllur, ku nderi dhe gjakmarrja vazhdojnë të mbijetojnë, pavarësisht ndryshimeve politike e social-kulturore. Figura e Adamit bëhet një simbol i njeriut që përpiqet të thyjë prangat e së shkuarës, por që përballlet me një mur të padepërtueshëm të normave të pashkruara. Në këtë luftë të brendshme, ai ndodhet mes ndjenjës dhe detyrës, mes humanizmit të tij si individ dhe detyrimit ndaj kodit të pashkruar të gjakmarrjes.

Në këtë vepër autori eksperimenton me strukturën narrative dhe ndërtimin stilistikor në një mënyrë sfiduese për prozën tonë. Por, ajo që i jep më shumë denduri dhe kompaktësi veprës janë temat dhe diskutimet që ngre njëherazi me to. Temat nuk janë të ngurta por brenda secilës prej tyre çelen sythe nënçështjesh disa prej të cilave lulëzojnë përmes ngjarjeve.

Temat dhe nëntemat e romanit

- Pesha e së kaluarës – Romani tregon se e kaluara nuk është diçka që mund të fshihet; ajo është gjithnjë e pranishme dhe formëson të tashmen.
- Identiteti dhe rrënjët – Protagonisti përpiqet të kuptojë nëse mund ta rifitojë identitetin e tij të humbur apo nëse duhet të krijojë një identitet të ri. Kjo krizë identiteti vihet re edhe te mënyra si Syblerta përballlet me fundin e Adamit. Po ashtu reflektimi mbi marrëdhënien e saj me Albanin tregojnë një personazh në kërkim të vetvetes, të ndarë mes të kaluarës dhe të ardhmes.
- Drejtësia dhe relativiteti i saj – Romani sugjeron që drejtësia nuk është një koncept absolut, por varet nga këndvështrimi dhe rrethanat. Autori trajton çështjen e gjakmarrjes dhe përpjekjet për t'i kështur zinxhirët e saj, duke ngritur pyetjen nëse është e mundur që një shoqëri të çlirohet nga hija e së kaluarës.
- Përplasja e individit me kolektiven – Adami përfaqëson individin që kërkon të çlirohet nga prangat e së shkuarës, ndërsa shoqëria përpiqet ta mbajë brenda normave të saj. Kjo përplasje e brendshme e bën atë një figurë tragjike, një njeri që nuk mund të shpëtojë dot nga rrjeta e fatit të tij. Por vendimi që merr në fund duket se i jep atij lirinë e aspiruar. Ai nuk mundi të zgjedhë si

të jetojë por zgjodhi si të vdesë. Pra, Adami i vetëm përballë fatit të tij por një vetmi në dy kohë. Në këtë të dytën si zgjedhje dhe akt lirie. Ai zgjedh të largohet në një mënyrë që e refuzon dramën e ekzistencës dhe që e pranon vdekjen si një proces natyral, duke u shkëputur në mënyrë të heshtur dhe pothuajse metafizike.

- Tragedia e njeriut që nuk mund të zgjedhë – Romani na tregon sesi një individ mund të mbetet i burgosur midis ndjenjës dhe normës sociale, një konflikt që shpesh nuk ka zgjidhje. Kjo jepet te figura e Adamit, por mishërohet te Albani.

Struktura narrative dhe ndërtimi stilistikor

Ernest Marku eksperimenton me strukturën narrative të romanit duke i dhënë lexuesit një rrëfim në spirale, ku e kaluara zbulohet nëpërmjet kujtimeve, reflektimeve dhe monologut të brendshëm të protagonistit dhe ndërthuret në mënyrë të natyrshme me të tashmen. Ai shmang rrëfimin linear tradicional duke kaluar nga përshkrimet intensive të realitetit në introspeksionet e protagonistëve, pa shkëputje të dukshme stilistike.

- “Përroi i ndërgjegjes” ku rrjedha e mendimeve dhe ndjenjave të personazheve pasqyrohet në mënyrë të pandërprerë dhe të papërpunuar, është teknikë që e gjejmë në narracionin e Ernestit.


- Një teknikë tjetër është ajo e zbulimit të ngjarjes gradualisht. Në roman nuk na jepet menjëherë një pamje e qartë e fatit të Adamit, por ajo na ravijëzohet hap pas hapi, përmes gjurmëve të mbetura pas zhdukjes së tij.

- Ndërlidhja e kujtesës me realitetin – Në fund, kujtimet e Syblertës për aromën e mishit të djegur dhe referencat ndaj të shkuarës janë përdorur si elemente të një narrative rrethore, që lidhin fillimin dhe fundin e historisë së Adamit.

- Përdorimi i një perspektive të shumëfishtë – Narratori nuk kufizohet vetëm në përjetimet e Syblertës, por përfshin në mënyrë indirekte edhe realitetin e Albanit, duke e bërë të ndjehet si një figurë qendrore që ndikon dhe ndikohet.

- Rrëfimi i ndërfutur si te mesazhet e

ERNEST MARKU
ROMAN
GEGA I MOTIT



“Një dëgj, një gjuhë dhe një identitet i nëpërkumbur!
Roman që ndërlikohet, e dëshmon dhe e
vetëmbështet për një të ardhme prometicë,
shpesh, dheqer materiale...”

BUZUKU

postës elektronike apo te “Ndërkallje” i japin një tjetër frymëmarrje romanit. Këto thyerje nuk janë dalje nga tema, por një cekje e saj nga një kënd tjetër. Aty gjuha bëhet poetike dhe meditative, mbushur me imazhe të fuqishme simbolike, si “bedenat” e gruas, “kafkat e thyera të burrave” dhe “gjurmët e ujkut”, që ftojnë për një lexim të shtresëzuar.

- Një tjetër element që e veçon romanin është ekonomia e gjuhës. Autori përqafon një stil «lakonik», me fjali të shkurtra, të thukëta, që përcjellin ngarkesë emocionale apo tension dhe krijojnë ritëm. Ky stil i afrohet prozës moderniste të Folknerit me një gjuhë të gjallë dhe të thellë, ku çdo fjalë ka peshën e vet, por ruan një lidhje të fortë me traditën tonë të rrëfimit epik.

- Një nga risitë kryesore të veprës është mënyra se si Marku përdor gegërishten si një mjet të plotfuqishëm artistik. Ai krijon një variant të pastër dhe të kultivuar të gegërishtes, duke i dhënë gjuhës një tingëllim të natyrshëm dhe poetik. Kjo nuk është një zgjedhje thjesht gjuhësore, por një manifest artistik që kërkon të ringjallë një traditë letrare të lënë pas.

- Në këtë roman psikologjik sfidohet koncepti i protagonistit heroik. Adam Liburni nuk është një figurë e pozicionuar moralisht sipas kodeve shoqërore por një njeri i shpalosur në brishtësinë dhe dyshimet e tij, i munduar nga zgjedhjet që bën. Kështu ndodh edhe me personazhe të tjerë si Albani apo Syblerta.

Qasja me ekzistencializmin

Gega i Motit është një roman që shkon përtej rrëfimit të një kohe a njeriu, ai është reflektim i dhimbshëm mbi natyrën e njeriut dhe fuqinë e tij për të mbijetuar në mes të dhunës dhe tragjedisë por edhe mes dilemave të tij etike dhe morale. Epilogu i romanit ka një simbolikë të thellë ekzistenciale. Ai përmbledh të gjitha temat e tij kryesore me një fokus te vetmia dhe liria e fituar përmes humbjes. Tema këto që për nga optika e trajtimit të thellë e qasin këtë roman me prozën filozofike të Hesse apo Camus. Çështja nëse ekzistenca e dikujt është dhuratë apo barrë për të tjerët, shkrirja fizike e Adam Liburnit e cila është po aq edhe simbolike, shishja me hirin e trupit të tij si metaforë e ekzistencës së përkohshme dhe ikjes së pashmangshme, janë të gjithë elementë të një optike ekzistencialiste.

Një figurë e pazgjidhur

Albani, ndonëse në sfond, mbart një peshë të madhe simbolike në roman. Ai përfaqëson një figurë që qëndron në mes të dy realiteteve, as të përfshirë plotësisht, as të shkëputur plotësisht. Pavarësisht se është i pranishëm, Albani nuk ka një ndikim të drejtpërdrejtë në dramën e Adamit apo në përjetimin e Syblertës. Ai është një vëzhgues pasiv, i cili as nuk shfaq ndonjë shqetësim të thellë, as nuk përpiket të kuptojë plotësisht atë që ndodhi. Ky mosangazhimi emocional na çon tek Merso i Camus. Në kontrast me Adamin, i cili ka marrë kontrollin mbi jetën dhe vdekjen e tij, dhe Syblertën, e cila është në një proces reflektimi dhe ndryshimi, Albani duket se është i mbërthyer në një ekzistencë pa ndryshim, një figurë që nuk zhvillohet apo transformohet. Albani ka dekonstruktuar rolin tradicional të burrit, por i duket e kotë të luftojë sepse e do lirinë e vet më shumë se lojën e jetës që për të nuk është tjetër përveç se kurth, ndaj pranon të jetë një “i huaj”. Ai analizon gjithçka, por nuk merr vendime. Në këtë mënyrë, portreti i tij është ai i një burri të zhgënjyer, të pashpresë dhe të bllokuar mes idealizmit dhe realitetit. Shkurt, një antihero në kërkim të autenticitetit.

Gega i Motit ka një fund të hapur, që nuk ofron një zgjidhje përfundimtare, por lë lexuesin të reflektojë mbi kuptimin e jetës, vdekjes dhe marrëdhënieve njerëzore.

Botohet në Egjipt romani *Vrasje në kryeministri i* shkrimtares Diana Çuli

Vrasje në kryeministri titullohet një nga romanet e viteve të fundit të shkrimtares Diana Çuli, roman që kohët e fundit u botua në Egjipt nga shtëpia botuese *Al Arabi Publishing and Distributing*. Ky roman, pas botimit të tij, në vitin 2019 nga shtëpia botuese DUDAJ, u vlerësua në Shqipëri me çmimin e Akademisë shqiptare KULT si romani më i mirë i vitit dhe më pas u botua në Itali, nga shtëpia botuese Castelvechi. Nuk ishin të pakta vlerësimet në shtypin letrar të vendit fqinj, mes të cilëve përmendim shkrimin e profesoreshës Stefania Parmeggiani në gazetën *La Repubblica*, 13.04.2020, ku shkruan: “*Të ndjekësh hijet që Diana Çuli projekton në selinë e kryeministritë shqiptare është një ushtrim letrar interesant... Gjejmë aty një vështrim të thellë e të kthjellët të autores ndaj vendit të saj, të cilin e realizon duke skalitur personazhe me natyrë të mprehtë, duke krijuar një thriller, që shndërrohet në një lavjerrës që luhartet vazhdimisht ndaj fantazmave të vjetra dhe idealeve të shqiptarëve, të cilët duan ta shohin vendin e tyre në Europë, duke dëshmuar edhe një herë se janë në gjendje të ndryshojnë realitetin.*»

Ndërkohë, botimi në Egjipt, për shkrimtaren, siç e ka pohuar dhe vetë në disa intervista, ishte një befasi e këndshme. Pas një *thriller*-i tjetër, romani *Hoteli i Drunjtë*, botuar më herët në Kinë, kapërceu kufinj të vendit, duke kaluar në një tjetër kontinent, edhe romani *Vrasje në Kryeministri*, mbështetur nga Qendra e Librit dhe e leximit dhe nga angazhimi i palodhur i presidentit të shtëpisë botuese FAN Noli, zotit Rexhep Hida, i cili vazhdimisht përpiket të promovojë shkrimtarët shqiptarë në botë. Ndërkohë botuesit egjiptianë shkruajnë se romani «*tani po fluturon në të gjithë botën arabe – nga një panair në tjetrin ! Të paktën deri tani ai është paraqitur në katër panire të mëdha : në Abu Dhabi Book Fair, në Rabat Book Fair, Muscat Book Fair dhe në Doha Book Fair. Lexuesit po tërhiqen shumë nga libri, ai po ngjall interes të madh.*»

Ky roman, të cilin mund ta quajmë thriller politik, përshkon të gjithë rajonin e Ballkanit, duke ndjekur një komplot ndërkombëtar, kundër hyrjes së Ballkanit Perëndimor në Europë. Si shprehet vetë autorja «*Doja të shkruaja për krimin politik të organizuar, për*

grupe njerëzish, oligarkësh, ideologësh, të fiksuarish, që, për interesat e tyre nuk kursejnë individët dhe shoqërinë - gjëra që kanë ndodhur përherë në histori dhe zhanri i thriller-it më ndihmonte ta realizoja më mirë.”

Për suksesin e këtij romani, i cili është në proces botimi edhe në Maqedoninë e Veriut, ndoshta mund të kujtojmë fjalët e shkrimtares së njohur, Mira Meksit, e cila shkruan: “Sepse është, në të vërtetë, një vepër e pazakontë, rrëmbyese, pothuaj e pangjashme me ato që kemi lexuar në gjuhën shqipe gjer më tani. Dhe me gjasë, vepra më e mirë e autores. Jo vetëm për hir të strukturës, e cila ngjason me lojërat tërheqëse të iluzionistëve, një fasadë e thjeshtë në dukje, e rrokshme lehtësisht nga syri dhe mendja, por e shumëfaqte, përsormërisht e ndërlikuar, në trajtë filigranash, labirintike, gjigante, pasuruese, robëruese dhe tejet grishëse në çdo syth të saj në brendësi.”

Po edhe mendimin e Piro Mishës, një prej studiuesve të tjerë që kanë shkruar në Shqipëri për këtë libër: “Kemi të bëjmë me një prozë që nxjerr më së miri në pah gjithë cilësitë më të mira e të tashmë të njohura të prozes së Diana Çulit : Rrëfimin e shkathët; prozë e një dore tashmë të stërvitur mirë prej një përvoje të gjatë; gjuhën e pasur; zhdërvjelltësi dhe natyshmëri të dialogut. Proza e Diana Çulit është një prozë e kulturuar, e zgjuar, që lëviz natyrshëm në ambjente nga më të ndryshmit të jetës sot, duke arritur t’i bëjë ato të besueshme.»



HURMAT

Të kuqe ishin hurmat në nëntor, në kulmin e tyre
në atë shtëpi buzë rrugës, në kthesë
ku jetonte furrxhiu i vë plak, me katër vajzat e pamartuara.

Oborri i tyre i mbushur me shumëçka:
mace me kotele..., pisllek..., muzikë në kulm..., shishe të
zverdhura alkooli...,
rosa..., qilima të varur si gjuhë të kënaqura qensh..., rrotat
biçiklete...,
glasëpëllumbash...,njëdënimpërtentativearratisje...,njëpus...,
kutërbim sardesh të skuqura..., prenka..., pesë vjet burg
për vjedhje..., epilepsi...,
një kokë e lagur gruaje që krihet përjetësisht në dritare...
Në një harmoni surreale midis tyre,
ato i ngjanin subkoshiençës së dikujt
apo të një qyteti të tërë puritan.

I rrethuar me një mur të lartë,
që nuk merrej vesh se kush e kishte ngritur: ata vetë apo
ne?
Liria e të pashpresëve është tmerrësisht ngjitesë.

Por habia ime ishin hurmat, ekuilibri i i brishtë i jetës:
si nuk këputeshin vallë ashtu të mbajtura në një pikë të vetme,
në degët e thara e të zhveshura nga gjethet?!!

Rrallëkush e kalonte atë prag. Por natën,
njerëzia thoshnin se kishin parë të dilnin tek e tek te huaj
ushtarë të regjimentit në kodër
dhe nganjëherë edhe eprorët e tyre. Rrangu,
dallohej nga mënyra se si e ulnin kapelen mbi hundë.

Llamba në shtyllën e vetme në rrugë,
për arsye të panjohura,
rrinte gjithmonë e thyer.
Më mirë pa sy fare, se sa me një sy!

Por, vendasit...

Njëherë dikush më tha e zhgënjyer
se një natë të kishte parë ty duke dalë prej andej..
Një burrë me klasin tënd...?!! Kurrësi! E pamundur!
Është e lehtë të ngatërrosh fytyrat në një natë pa hënë,
që ndriçohet vetëm nga hurmat.

GEISTERBAHNHÖFE*

Duke udhëtuar në metronë e Berlinit,
përmes “Oranienburger Straße”, “Unter Den Linden”,
“Nordbahnhof”...

ku dikur trenat nuk lejohej të ndaleshin,
unë imagjinoj dritën e verdhë përtej dritareve,
siluetat e ushtarëve të Gjermanisë Lindore,
dhe aurën e braktisur të stacioneve- fantazmë.

Vetë jeta,
i ngjan një udhëtimi me metro në Berlinin e ndarë
gjatë Luftës së Ftohtë,
me stacionet e tij të pashkelur, kapitujt e anashkaluar,
si fjala vjen: unë kurrë nuk kam qenë fëmijë,
nëna ime nuk ka qenë kurrë
grua,
babai im do të vdesë pa u plakur
dhe motra ndodhet në parajsë pa vdekur akoma.

Jetë të paplota,
sikur nuk ka kohë të mjaftueshme për gjithçka...

Dikujt nuk i jepet kurrë mundësia të arrijë majën
por edhe ata që munden, nuk do të dinë të zbresin,
zbritja është një art më vete.

Dikush nuk largohet kurrë nga shtëpia,
por edhe ata që e bëjnë, nuk e gjejnë dot rrugën e kthimit;
këpucët e tyre në fund të shtratit,
plaken gjatë natës si këpucët e një shenjt.



LULJETA LLESHANAKU

Mjerimi i grimcave

poezi

Dikush lind i mbrojtur me një emër si me një mjekër,
ndërsa një tjetri i duhet ta rrisë mjekrën nga fillimi
për të fshehur padurimin, dobësitë, shenjat.

Dikush ndjek hijen e tij, dikë tjetër hija e ndjek pas,
edhe pse në fund të ditës, të gjitha hijet
na braktisin në vetminë tonë prej mishi dhe gjaku...

Por ndërsa treni rrëshqet mbi vizionin e tij,
dëgjoj rrëfimin intim mes dy grave në të majtë:
“...Po atë pasdite që varrosi të ëmën,
ai më kërkoi të bënim seks, një seks të egër si kurrë më
parë!”

Pyes veten:
sa etapa u anashkaluan
brenda asaj pasditeje të vetme funerali me baltë,
sa stacione-fantazmë?

* Stacionet fantazmë. Ky term u përdor për të përshkruar
stacione të caktuara në rrjetet e metrosë U-Bahn dhe S-Bahn
të Berlinit që u mbyllën gjatë periudhës së ndarjes së qytetit
gjatë Luftës së Ftohtë.

FUND SHTATORI

Po të le në këtë fund shtatori,
nga ky aeroport periferik
kulla e vrojtimit si një teshtimë
thyen melodramën e reve që shkojnë dhe vijnë.

Nuk është faji yt, atdheu im i vogël
vendet e vegjël nuk kanë hapësirë për të gjithë.

Pak milje me tutje, është fëmijëria ime
(e vetmja që më vjen ndërmend)
ku ullinjtë dhe njerëzit zëvendësojnë njeri-tjetrin me turne
nën qellin e prerë nga malet si një grykë e thyer shisheje,
ku stomakët bluajnë njëkohësisht hithra të zier dhe
politikë
dhe ku një dramë e vetme,
qarkullon gojë më gojë
derisa fermentohet në komedi.

Vendet e vegjël nuk kanë se ç'të fshehin dhe ku të fshehin:
te mbledhura bashkë në pak metra katrorë
e djeshmja, e sotmja, dhe zhgënjimi i nesërm
si shtrati, tavolina dhe tualeti në një qeli
e bëjnë kohën të duket iluzion.

Me dhëmbët që zverdhin nga sketicizmi acid,
si atë mëngjes kur fqinja hyri pa trokitur
dhe gjithë ngazëllim tha: “Kam parë Zotin në ëndërr
mbrëmë!”
E pse Zoti do të zgjidhte një punëtoore lavanderie
me gjinjtë e lëshuar si kosat mbi kërthizë,
e pse Zoti do të zgjidhte njërin nga ne?!!

Dhe vetëm në një aeroport të vogël si ky
ndodh të shohësh qartë gjëra që supozohet se nuk duhet
të shihen:
hamejtë përtej xhamit të terminalit
tek shtynjë valixhet në barkun e avionit,
përfshirë edhe timen

njësoj si të shohësh rropullitë e tua në sallën e operacionit,
gjithë mistikën e qenies tashmë të zhbërë.

TOKË E MIRË

Pa i rënë në sy,
unë porosita vendin e prehjes së përjetshme për t’ime më
afër të vëllait, por me atë gruas së tij akoma gjallë në mes.
Si gjithmonë,
ajo nuk do ta ketë problem të jetë personi i tepërt...

“Është tokë e mirë- më thotë entusiast në telefon
sipërmarrësi -
e larë me diell., në kodër atje në majë...,larg zhurmës së
makinave...
E ç’mund të kërkosh më tepër se kaq?!”

Në anën tjetër të murit, në këtë orë,
ime më siguri po sheh programin e saj preferuar
dhe nuk do të vonojë derikur, me një palë sy të pafajshëm
do të më bëjë atë pyetjen më të pagabueshmen nga të
gjitha:
“Çfarë kemi sonte për darkë?”

Dhe unë do ta ushqej me të njëjtën dorë tinzare
me të cilën sapo i firmosa çekun për varr.

VENDI I TË HARRUARVE

*Në vitin 1991, pas rënies së regjimit komunist,
qindra familje shqiptare më në fund lirohen
nga kampet e internimit ku ishin mbajtur plot
47 vjet pa ndërprerje.*

Hyjnë gjithë delir në qytet
nga porta jug-perëndimore, mbi rimorkio të zbuluara
kamionësh,
me jetën e tyre të lidhur fort në dengje,
ata, të sapokthyerit nga Vendi i të Harruarve.

Me vete nuk kanë çelësa,
shtëpitë që lanë pas dikur
u mbushën me gëzimin e të tjerëve,
por kanë të drejtën me vete
dhe zemërimin--
çelësin që hap të gjitha dyert!

Tri breza bashkë
i afrohen të ardhmes në rimorkion e një ZIS-i
të ndryshkur sovjetik,
me feçkën e tij metalike dhe nuhatjen prej ujku,
përmes rrugëve dytësore, nëpër muzg...

Ata i përkasin këtij vendi, por e vetmja provë që kanë
janë fotografitë familjare të viteve ‘40
me buzëqeshje rrezatuese femërore alla Judy Garland
dhe kostume burrash dopiopet alla Jean Gabin-
të konsumuara në cepa.

“A ju kujtohet, zoti Qazim? Burri që më mësoi
fizarmonikën?
Jetonte diku rrotull këtej mesa mbaj mend...”
Bishti i një tigani nga gryka e thesit
tregon lart një qiell dekada më të plakur.

Ata duken magjepsës nga larg
dhe kanë moshën e papërcaktuar të vendeve të harruara
pa një shans për sukses apo dështim
por thjesht durim dhe vetmi, fiere dhe gur.

Por ç’kishin në mend të parët e tyre
kur u vunë emra mbretërish, dijetarësh e heronjsh?
Elena, Orlando, Semiramis, Sulejman, Matilda, Benjamin...
Çfare sarkazme! Të vetmet herë kur i përdorën,
qenë gjatë apelit në kamp, dy herë në ditë.

Të hutuar,
ata kërkojnë me sy ndonjë vend
ndonjë shesh, fasadë, park a muzeum,
apo ndonjë cep të shpëtuar ndërgjegjeje,

ku të derdhin basorelievin e tyre prej bronxi,

Dhe siç ndodh rëndom me fatzinjtë në bronx
ata do të fetishizohen pjesë-pjesë,
e të prarohen pak e nga pak, nga koka te këmbët
gjunjë, bark, bërryle, hundë, gjinj...
nga duart e vizitorëve bestytë
që i fërkojnë për fat të mirë!

Ndërkohë,
shoferi i kamionit bërtet nervoz nga kabina:
“Ku dreqin t’ju zbres?!”

MJERIMI I GRIMCAVE

Ç’bën kjo rërë afrikane këtu,
ç’erë e fortë i detyroi këto grimca të purpurta
të kapërcejnë detet, qytetet e fjetur, grishjen e luginave në
mëngjes,
për të gjetur paqe mbi suprinat e mërzitshme të dritareve
me lule,
kutitë postare, kofanot e makinave dhe çatitë alpine
ne zemër të Europës?

Rërë që ndoshta vjen nga Lugina e Mbretërve
apo krahu i munguar i Amenhotep-it të Tretë,
gërryer nga erërat dhe vetmia.
Rërë që akoma mban mend sytë e gjelbër të Saharasë
shtatë milion vjet më parë
dhe prekjet e shputave të profetëve në arrati
pas një paralajmërimi të zbritur nga engjejt natën.

Uji, pushteti, luftërat, profecitë dhe botët e pashkelura
brenda këtyre kokrrizave mikroskopike.

Ata që kanë të drejtën të tregojnë historinë
dhe çfarë duhet mbajtur mend,
janë faraonët, profetët, Teba, qytetet prej balte,
edhe pse të braktisur.
Ndërsa kujtesa jonë kolektive,
ato pjesëza, grimca, gjërat e vogla pa emër,
thjesht mund të lëvizin përjetësisht nga njëri vend në
tjetrin
në kërkim të një vendi prehjeje.

GUSHT. KTHIMI NË SHTËPL...

Është gusht,
koha kur emigrantët kthehen në shtëpinë e prindërve
për pushime.

Ata dalin të zbehtë dhe pa peshë nga aeroporti
si nga një re amnezie
pas vetes tërheqin një valixhe të koduar
dhe një fëmijë që qan.

Marrin me qira një makinë gri, e ngasin butë,
me dritat e pasme ndezur,
edhe pse mbrëmja është akoma larg.

Heqin këpucët në prag të shtëpisë,
zëvendësojnë një llambë të djegur në korridor,
ndreqin çatinë, porosisin një palë proteza të reja për
nënën,
drutë e dimrit, ndihmojnë babain në vreshtë,
në klubin më të afërt vënë baste sportive,
përcëllojnë lekurën në plazhet gri,
lënë gjurmët e tyre të lehta gjithkund,
qëllimisht,
sikur përgatisin një alibi.

Me një keqardhje të vonuar që i pluskon në sy
ngushëllojnë të afërmit e të vdekurve gjatë vitit,
(Interasant, sa shumë vdiset këtu!).

Me miqtë e vjetër shkojnë për peshkim
dhe kthehen duarbosh:
nuk peshkohet dy herë në të njejtin lumë!

Ata tashmë zotërojnë dy emra,
dy gjuhë, dy shtetësi, dy fe...
apo veç jehonat e trazuara midis tyre.

Dhe ndoshta pikërisht ngaqë kanë shumë për të thënë,
nuk flasin fare;
në vend që të tregojnë për atë natë,
për motobarkën e prishur në mes të detit
dhe Circen që i ktheu varkëtarët në derra,
ata vetëm shpenzojnë pa kufi
për makina qepëse...kablo televizori...biçikleta..
dhe për mermer nga ishujt, mermer me damarë të errët,
për varret e familjes.

Dhe sapo fillojnë t’u kthehen pantallonave dhe zakoneve
të vjetra,
të pijnë nga pak, të lënë mjekër e të ndjehen në shtëpi,
dritat e pasme u ndizen krejt papritur, u ngrohin shpinën
si një pëllëmbë sa atërore aq edhe e pabesë:
“Nuk ka më vend këtu për ty, bir!
Kthehu andej nga ke ardhur...”

...me një valixhe të koduar,
dhe me një fëmijë që vetëm qan pa shkak.

LOUVRE

Duke pritur me padurim në dyert e Louvre-t
në radhë të gjata si në Ditën e Gjykimit,
të ndarë nga njëri-tjetri me heshtje
dhe nga pëshpëritjet e lehta në gjuhë të ndryshme
që fshehin lakuriqësinë tonë të përbashkët
si rrobat verore.

Minutat numërohen mbrapsht;
secili prej tyre bie me një tingull ngazëllyes
si monedhat metalike në një arkë kursimi.

Pastaj përballesh me mrekullinë, hyjnoren
me goditjen e ngjyrave që nuk e kishe menduar kurrë se
ekzistonin,
ose më mirë, kërkon me forcë brenda tyre
për ndonje papërsosmëri brenda përsosmërisë
si psh: mjerimin e dhomës së Vincenzo Peruggia-s në sytë
e Mona Lizës,
gjurmët e prerjes në kanavacën e “Dasma në Cana”,
kur u vodh dhe u transportua me varkë,
dhe furçat amatore të studentit të Jacques-Louis David
në “Kurorëzimin e Napoleonit”.

Kërkon me dëshpërim nëpër to
për të përkohshmen, tokësoren, të zakonshmen
si provë se janë reale,
e pa pushim bën foto pranë tyre
si provë të ekzistencës tënde.

Dhe pastaj vjen Rembrandt në Kavalet,
qe sikur të thotë “Kjo është e gjitha!”.
Në atë shikim gjendet gjithçka, fillimi dhe fundi,
dhe nuk ka mbetur asgjë me për të thënë apo menduar.

Ky është Louvre,
ku në të vërtetë nuk vëzhgon por vëzhgohesh,
skanohesh, me një shikim depërtues deri në qelizën më të
fshehtë.
Dhe njësoj si pas kontrollit me skaner në aeroporte,
edhe pse i ke marre mbrapsht të gjitha pjesët e tua
(rripin e pantallonave, këpucët, monedhat, orën ...)
ndjen se diçka mungon akoma,
ndjen se nuk je më i njëjti person.

Stinë

Nuk e di se për të satën herë
qielli nxinte në surratin e një këlyshi dhelpre

Isha ulur në një shkallë çimentoje
me disa zhuzhakë në fytyrë
një lule e verdhë tundej
një zgavër thellohej
ndërsa çukisnin butësisht në derë
shtatë pleq me shtatë lugë të thyera

E megjithatë në këtë heshtje të dendur
gishtat tanë shtronin çarçafë
bustet tona ngjiteshin nëpër mur
faqet vizatuan të njëjtat shenja me gëlqere
puthjau duart pleqve
ata e sollën urinën e kalit për të vrarë barërat e këqija
puthjau duart dhe u thuaj me zërin tim
se qëndroja ulur në një shkallë çimentoje
ua thuaj atyre këtë me zërin tim

Ata do të tundin kokën dhe do të shkojnë tek portat
e tjera
ndërsa ne do të vazhdojmë lundrimin tonë
në surratin e një këlyshi dhelpre

Ç’lule të bukura

Sa lule të bukura bënte piktorja në femurin tonë
blu të verdha portokalli lule të mrekullueshme

ne të gjithë nxënësit poetë të gjithë të vrullshëm të
gjithë të vdekur
të kullotur nga kuajt e ngrënë nga qentë dhe vetëm
të gjithë galopojmë duke bërtitur: pushimet e verës
erdhën pushimet e verës
ne të gjithë po galoponim mbi kuaj dhe po
hingëllnim e bënim shaka
do të kishim pushuar së qari dhe do të kishim paguar
me para në dorë
për këtë do të kishim shitur çantën e shkollës dhe
krifën
Ëndërronim gjinjtë dhe **çarçafët** dhe hingëllnim si
kuaj
poetët e orkestrës nxënës shkollash nga kudo
të ngrënë nga qentë të harruar nga vajzat
galopuam bashkë dhe bërtitëm: pushimet erdhën
pushimet
por ajo ntrashja e vitheve të piktores së heshtur të
Karaibeve
ajo na ndaloi për një çast dhe na buzëqeshi,
na pikturoi faqet qepallat dhe femurët

Pasqyra e verbër

Filli i gjakut më del nga xhepi
filli i leshit që më del nga sytë
filli i duhanit që më del nga veshët
filli i flakëve që më del nga vrimat e hundës

Ti mund të besosh se veshët e mi pinë duhan
por njerëzit mbetën të shtangur në mes të udhës
sepse sonte të gjitha shtatoret do të lyhen me të zezë
dhe do të jetë pagjumësia ime që do ta njohësh
një pagjumësi një farë lloji prej gëlqere dhe argjile
një pagjumësi si një sobë apo një derë
ose më mirë si zbrazëtia e një dere
dhe pas kësaj dere dua të flas për kujtesën

dua që të më nuhasësh si një dritare
dua që të më dëgjosh si një pemë

GELLU NAUM

Kalimi nëpër lëkurë

poezi | Përktheu: Luan Topciu

GELLU NAUM (1915–2001)

Gellu Naum është një nga poetët më të shquar të shekullit XX në letërsinë rumune dhe një ndër figurat qendrore të surealizmit europian. Lindi më 1 gusht 1915 në Bukuresht, në një familje me origjinë nga qyteti i Ohrit, prej nga prindërit e tij u shpërngulën drejt Rumanisë në fund të shekullit XIX. Studioi filozofi në Universitetin e Bukureshtit dhe më pas në Sorbonë, ku nisi një tezë doktore mbi Pierre Abélard. Në Paris u lidh me rrethin e André Breton dhe me grupin surrealit francez, ndërsa në vitin 1941 themeloi në Rumani, së bashku me Gherasim Luca, D. Trost, Paul Păun dhe Virgil Teodorescu, grupin surrealit rumun.

Kjo lëvizje letrare, aktive deri në fund të vitit 1947, përfaqëson një nga pikat më të larta të avangardës europiane të kohës. Për Gellu Naumin, kjo periudhë ndërpritet dhunshëm me vendosjen e regjimit komunist. Për gati dy dekada ai do të heshtë si poet dhe do të sigurojë jetesën si përkthyes, duke sjellë në rumanisht autorë si Diderot, Stendhal, Jules Verne, Kafka, René Char, Samuel Beckett e të tjerë.

Në vitet ’60, Gellu Naum i rikthehet poezisë dhe do të botojë një nga veprat më të njohura të tij, romanin *Zenobia* (1985), frymëzuar nga bashkëshortja e tij, Lygia. Ai jetoi mes Bukureshtit dhe Comanës, ku kalonte verën dhe shkruante.

Pas vitit 2000, vepra e tij nisi të rizbulohet dhe të botohej gjerësisht. Shtëpia Botuese Polirom ka botuar: *Rrethe identike dhe të ndryshme* (2004), *Vepra I. Poezi* (2011), *Vepra II. Prozë* (2012), *Vepra III. Teatri* (2014), si edhe *Zenobia* (2014, 2018). Në vitin 2006, në gjermanisht u botua për herë të parë *Poezia*, vëllimi i parë i veprës së tij të plotë, përkthyer nga Oskar Pastior dhe Ernest Wichner. Fitues i shumë çmimeve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Poet i margjinës, por me ndikim të thellë dhe të qëndrueshëm, Gellu Naum mbetet një nga zërat më origjinalë të poezisë europiane moderne.

dua që të më ledhatosh si një shkallë
dua që të më kqyrësh si një kullë

Vello

Të tjerët qëndronin me shpatullat ngjitur me një
dritare
me sytë si gozhdë të ngulur në trupat tanë
dhe të gjitha peshoret po merrnin frymë
por një ditë të bukur diçka lundroi në to u ngrit atje
dhe të jetohej ishte mjaft e vështirë
dhe ne ishim përmbysësit

atëherë ajo grua qëndronte në karrigen më të lartë
dhe po më shikonte
me trishtim
ishte një njohje e dukshme mes të mëdhajave dhe të
grisura nën vello
pëshpëritjet e saj më përkëdhelnin faqet
sa larg ishin atëherë velloja dhe trishtimi
shumë herë të gjetura dhe po aq shpesh të harruara
në barin e qetë të heshtjes sime.

Plaku rrinte i vdekur

Plaku rrinte i vdekur mbi plehun
e gropës së tij soditëse.
ai nuk thoshte asgjë, qante si një foshnjë brenda një
bërthame.
vinte e njëjta gjemi, vetëm udhëtarët ndryshonin.
ata i silleshin rrotull, e përkujtonin.
i moshuari rrinte i vdekur, me një kapele të hirnosur
mbi kokë.

disa dishepuj, më të qashtërit, më thellësisht të
ndoturit,
gërmonin plehun me gishtat e tyre, kërkonin krimba
për peshkim.
ne e adhuronim njëri-tjetrin, siç thuhet. Ishim aty
ndoshta rastësisht.
të tjerët vinin gjithmonë. Kishin libra dhe fletore.
i aviteshin plakut, i bënin pyetje
(ishin të njëjtat pyetje, vetëm udhëtarët ndryshonin).
thoshin: “Të respektojmë. Ja, po zhvillohet përkujtimi
yt solemn.
por pse nuk e kuptojmë mirë atë pëshpërimë që na
ka mbërritur deri këtu?
përpiku të jesh më i qartë. Kemi bileta vajtje-ardhje,
përfshirë dy vakte. Thuaj disa të vërteta.
Ne i shënojmë, i mësojmë, ia përcjellim pasardhësve.
Shkurtimisht:
Plaku rrinte i vdekur mbi plehun,
e gropës së tij soditëse.
dishepujt rregullonin copat e tyre të grisura, bënin
sikur nuk shihnin.
ishte një shfaqje më tepër e trishtuar. Ne qëndronim
përtej,
thoshim se po studionim poliglotin. Na jepte mësim
një zonjë që dinte shumë, një botaniste e rreptë.
Të tjerët afroheshin te plaku, i vendosnin dekorata
mbi pelena,
e fotografonin në pelena, në mes të tyre.
ishte i bukur, e admi(ronin), shijo(heshin).
ne merreshim me punët tona, tashmë disi më të
ndërlikuara.
bënim ç’kishim mundësi.
dishepujt luanin në kitarë, sipas veshit,
të tjerët bënin pyetje. Qielli ishte i kaltër.
disa mesdhetarë kryqëzoheshin mes tyre aty-këtu.
të tjerët thoshin: “Të respektojmë,



je një Marconi tjetër, një Edison tjetër. Shprehu, thuaj disa aforizma, dy-tri të vërteta.”
plaku përpëlitej mbi pleh, shqyente pelenat e tij. ne qëndronim më tej. Mes nesh kalonte një qetësi pa fillim e pa fund.
na vinte mirë me shpatullat mbështetur mbi ajër. të tjerët kishin ngritur një amfiteatër. E rrethonin plakun,
ia shtypnin kapelën, e spërkatin me zorë,
i kërkonin disa të vërteta.
Ai mbulonte sytë, mbushte gojën me pleh.
Vinin anije, trena të mbushur.
(Ishin të njëjtat, vetëm udhëtarët ndryshonin).
Unë të thoja diçka pa rëndësi. Dishepujt bënë sikur nuk na dëgjonin.
Ti më thoshe: “Endrigo, flet si në ’33, kur po jepje provimet e maturës.”
Unë flisja si në ’33, po jepja maturën, studioja filozofi në një dhomë me pamje nga rruga.
Të tjerët thoshin: “Po të përkujtojmë. Zvarritemi nëpër plazhe, të plagosur në luftëra.
Na shpjego qartë atë pëshpërimë, që të jep të drejtë dëshmia jote si plak.”
Dishepujt përsëritnin në mendje gabimin fillestar.
Ne ngjisim faqet tona, përkëdhelnim gishtat tanë në amfiteatër.
Luhej muzikë. Vinin anije dhe trena. Aty bëheshin parada.
Plaku përpëlitej mbi pleh. Pëshpëriste JO. Vetëm kaq pëshpëriste.
Po marrim shënime, po bëjmë stenografi.”

Dashuri e pamasë

Dy heshtje qarkullonin nëpër çdo mur dhe dilja të dëgjoja veten
Flisja me dy gojë dhe dëgjoja vetveten
me dy veshë në secilën anë të fytyrës

Dhe ishte një dashuri
ndërsa mbi kubin e saj që mezi dukej
çdo mëngjes lindnin dy diej

Të sëmurët në spitalin e Nürenbergut

Retorika është në lëvizje, mallkoj që nga mëngjesi shpendët
objektet rituale janë rrëmujëzuar përreth meje (kutia me duhan, vizatimet e dhuruara nga miqtë e gjallë ose të vdekur, soba prej hekuri e lyer me varak, ora me rërë, karrigia portokalli sëndyqi i vjetër, shkronja U, zilja zen varur në një mjekrër bukur të mprehtë, eshtrat e nxjerra nga deti dhe të pikturuara etj.)
me siguri do të bjerë shi, sepse të sëmurëve në spitalin e Nürenbergut u therrin kockat nga reumatizma
maçoku paranoik fërkoj karrigen derisa e shkatërroi.
kurora e nallënes është pranë ballit tim (një frut plastik i verdhë) dhe pranë dy vazove me majdanos të thatë
o, varsja ime e vogël e duarve të brishta, vendosa ushqimin në shkallë, zbres pak,
e kam vendosur aty pranë.

Kalimi nëpër lëkurë

Një ditë të bukur do të kaloj nëpër disa rrugina me disa ndërtesa të mbytura në dritë të verdhë
patjetër do të kaloj me krahun e majtë mbi sy me hijen e kruspulluar në rroba, në shapkë,
në jakën e hapur të këmishës
pastaj do të ndalem pak tek orbitat e mia i pështjelluar, i heshtur, i pluhurizuar
atëherë do të jetë sekonda e kalimit nëpër lëkurë sekonda e madhe, ndaj gëzohuni
sepse nuk do të shihni plantacionet e rërës dhe s’do dëgjoni gurgullimën e ujit që mbyt këpucët e mia me qafa
ndaj gëzohuni vëllezër, gëzohuni.

Çelësi i ëndrrave

Shpend në jerm, gruaja kaloi,
hapat prej qelqi lanë gjurmë të dukshme,
njerëzit ndezën teshat e tyre

për të adhurar më mirë lumin.
Mërzia e tmerrshme,
me tentakula përpirëse prej kadifeje.
Gra mbi këto pllaja të përmbytura,
gra elastike, gra të zymta,
gra prej kristali dhe prej dylli nate,
gra me gishta të pafund,
me qerpikë prej akulli të zheguar.
Do të ndërtojmë ylbere prej flakësh,
do të mbytemi të qetë në këto ujëra të helmta,
në këto ujëra metalike,
gra somnambule me qepalla të heshtura.
Bleta-shpend
gdhend një rruginë në kraharorët tuaj përvëlues.

Nga e ke blerë këtë dorë

Gruaja e dyfishtë që më ka mbirë në pëllëmbë,
i gërzit me dhëmbë gjijtë e saj me një seriozitet të natyrshëm
ajo mund të zbresë në shi
mbi këmbët e veta nëse,
mjekra plakë s’do ta ndalte me një shenjë të shkurtër,
një shenjë prej shkopinjsh dhe rrotash,
një shenjë që rrëshqet mbi ne si një shelg,
një shenjë ku ndalohet çdo demonstrim,
si një rrënjë e këmbëve të saj, në gishta,
aty ku atmosfera hapet si një kraharor
dhe prej tij rriten shpendët e trembur të syve.

Por bariu i mirë ha mjekrën e vet në çdo stinë.
Nga duart që ende s’janë djegur plotësisht,
zbërthen një kopsë prej mishi
dhe më pas zhvesh lëkurën si një këmishë.
armësharët e këmishës vërsulen përpara,
krifat valëviten, gjokset u fryhen viganë
rrugët e drejta tërhiqen mbrapsht, pemët e stepura,
rregullojnë flokët me dy gishta,
duke mermëritur një melodi.

Por truri i zgjatet vazhdimisht si një çamçakëz,
gruaja e dyfishtë argëtohet duke shtrirë.
mbi sup, kapelen prej eshke e cila ha këmbët e kandërrat që kanë kaluar në rubinet.

1.

Mëngjes. Hap sytë si për të disatën herë gjatë natës. Prej dhomës pa perde shikoj të njëjtën pamje: një qytet që po shndërrohet dalëngadalë në një përbindësh, me gjymtyrë agresive të përbërë prej tullash të kuqe me damarë prej betoni dhe hekurash të mbetur në ajër, përpjetë. Mandej, shumë shpejt del dielli, çfarë e bën pak më me shpresë zgjimin. Pamja nis e qartësohet dhe e humbet atë dozë agresiviteti që shfaqet për herë të parë. Dal në ballkonin mbas apartamentit tim, për të ndjerë më mirë temperaturën e ditës që po nis, dhe verifikoj për kushedi të satën herë se qyeti po bëhet një konvikt i madh. Ai tashmë i ngjan një fjetoreje, që po zgjerohet e po zgjerohet si barku i një obezi të pashpresë. Pallatet e ndërtuara që në kohë të komunizmit, tani mbasiqë fituam lirinë, po shtohen në mënyra nga më të shëmtuarat. Pallateve po i dalin gunga, zgjatime idiote, çibane...

Dal prej shtëpie, ulem diku, dhe hap derën e zyrës sime. Zyra ime është laptopi im dhe dera është kapaku i tij. Nuk është me rëndësi se ku ndodhem, në shtëpi, në klub, në park apo diku tjetër. Zyrën time unë e kam me vete. Urrej çdo gjë konvencionale. Zyra ime konvencionale është në qendër të qytetit, krejt afër me shtëpinë time, por unë nuk hy atje pothuajse kurrë edhe pse është 550 hapa larg.

E pra 550 hapa nuk janë asgjë, por fati im i mirë që askush nuk më kërkon një orar fiks për t'u paraqitë në punë. Askush nuk më kërkon llogari. Sepse puna ime bëhet ngado. Kudo është vend i mirë pune për profesionin tim, përveçse në zyrë.

Jam gazetar. Punoj për agjencinë telegrafike më të vogël, më të parëndësishme, më të pabesueshme dhe më të varfër të Europës, që quhet ATSH apo për së gjati: Agjencia Telegrafike Shqiptare. ATSH e ka humbur tashmë krejtësisht vlerën e vet. Atë që ka pasë dikur në kohën e komunizmit, kur si çdo media tjetër thoshte të vërteta, gjysëm të vërteta dhe gënjeshtër. Aso kohe e vetmja e vertetë që dilte prej saj qe dita dhe data; gjysëm e vertetë qe shërbimi sinoptik dhe të gjitha të tjerat qenë veç gënjeshtër.

Megjithatë, pra megjithëse i ka ikur koha, shteti i varfër postkomunist shqiptar vazhdon ta mbajë ATSH-në. Se pse e mban, nuk e di askush prej nesh që punojmë për të. Askush. Madje as drejtori vetë që vjen prej rradhëve të ngjeshura të një partie politike në pushtet.

Por ama ATSH bën ndonjëherë edhe gjëra të mira, siç është kjo e fundit përsëmbull dhe që ka lidhje me dërgimin tim me shërbim në Vjenë. Po. Ajo, agjencia pra, ka vendosur të më dërgojë me shërbim në Vjenë, prej nga duhet të raportoj për funeralin e të fundit pinjoll të familjes së Hapsburgëve, Otto von Habsburg.

Kështu pra duhet të bëj gati valixhen time të vogël, atë që nuk merr më shumë se dhjetë kile plaçka, se për aq ma kanë prerë biletën, si dhe për çantën time të laptopit, bashkë me ndonjë libër për ta lexuar gjatë udhëtimit apo në hotel.

Kam para aq sa për të zënë një pension të vogël, të vjetër, të mjerë, diku në breg të Danubit, fort larg qendrës dhe vendit ku do të ndodhë event, për të cilin edhe po nisem. Merret vesh se pensioni nuk e përfshin mëngjesin në çmim. Kam dy rrugë për mëngjesin: ose ta ha diku te ndonjë kioskë, ose mos ta ha fare. Kam idenë se do fitojë ky version i dytë, se edhe jam shëndoshur ca.

Avioni për në Vjenë nis shumë herët.

STEFAN ÇAPALIKU

WC

tregim



Në avion të ofrojnë vetëm pak muzikë nga Shtraus në zbritje, por ngandonjëherë edhe në nisje, si dhe një gotë me ujë, nëse kur kalon andej pari stjuardesa nuk të gjen në gjumë. Unë zakonisht nuk flë nëpër avionë, pasi gërhas, prandaj e përfitoj ujin. Imë shoqe si gjithmonë, më ka përgatitur nja dy sanduiçe. Kam në krah një çift pleqsh shqiptarë të cilët kanë për destinacion New York-un, ku prej vitesh u jetojnë djemtë. Është hera e parë që hipin në një fluturak kësisoj, por ama janë të lumtur se kurrë nuk ua kishte marrë mendja se djemtë do iknin nga fshati i tyre malor dhe do bëheshin të suksesshëm në New York.

Në aeroport më ka dalë me më pritë një shoku im i kahershëm i fëmijërisë, i cili ka emigruar herët në Vjenë, ku punon si bojaxhi. Ai ka lënë punën për të më dalë para me makinën e tij të mbushur kova, rrula, pika boje dhe vegla stukimi. Edhe pse nuk ka ecur në zanat, ai ka bërë goxha para dhe jeton në një vilë të veten diku në periferi të Vjenës.

Edhe pse mu lut të shkoja te shtëpia e tij, unë refuzova, duke menduar se do jetë më mirë ta eksploroj qytetin i vetëm. Në avion hëngra vetëm njërin sanduiç, tjetrin mendova ta lija për të nesërmen në mëngjes.

2.

Sot përpara se të dal nga pensioni im i vobektë hënga sanduiçin e dytë, të cilin e kisha harruar pa u futë në frigorifer. Kishte një shije të çuditshme, por unë megjithatë e hëngra dhe dola.

Ishte mëngjes herët kur dola nëpër rrugët e Vjenës. Sillja në mendje të gjitha ëndrrat që kisha pasë mbasi ra Muri i Berlinit. Edhe unë doja të ikja nga Shqipëria, edhe doja të bëhesha dikushi në profesionin time, edhe unë doja të

bëhesha i pasur, edhe unë doja të isha i famshëm. Por ja që nuk ndodhi asgjë prej tyre, por megjithatë isha mirë me shëndet dhe kjo më jepte njëfarë optimizmi.

Ndërkaq më erdhi të shkoja në banjo. Nuk e di si funksionon këtu. Kam përshtypjen se po të hysh në një bar, nuk është nevoja të porosisësh për të hyrë në banjo. Megjithatë... ja ta provojmë. Po, duhet porositur. Duhet të marrësh diçka më thotë kamerieri. Marr më të lirën. Një kafe. Dhe shkoj në banjo.

Dëshira për të fotografuar WC-të e klubeve, restauranteve, bareve, stacioneve, klinikave mjeksore, teatrove, kinemave dhe gjithçkaje tjetër publike, më kishte lindur që kur më kishin paisur ata të punës me një aparat fotografik, të cilin nuk e hiqja kurrë qafe. Këtu në Vjenë kishte plot situata interesante për të bërë fotografi, por unë preferoja ato të undergroundit, që pothuajse nuk i fiksonte askush. Siç e dini të gjithë turistët rrinë me kokën përpjetë drejt monumenteve a godinave madhështore. Kurse unë jo.

Kur dal për të vijuar rrugën, ndiej se kafja më ka bërë edhe më keq. Duhej ta dija se ajo është njëfarë diuretiku, madje i fortë.

Kështuqë edhe sot, ditën që do mbahej event i për të cilin kisha shkuar, duhej të hyja në një kafe, ku ta kisha banjon pranë. Te Kleines Cafe e Vjenës përsëmbull, një prej klubeve më të vjetër të atij qyteti. Atje është një bar i vogël, tamam ashtu siç e kishte emrin “Kleines Cafe”, që gjendej në Sheshin e Françeskaneve, në shpinë të katedrales së Shën Stefanit.

Është 16 korrik 2011, siç e thashë, dita kur do varrosej i fundmi i dinastisë së Hauburgëve, Otto von Habsburg, i njohur gjithashtu si Otto i Austrisë, ish-kreu i Shtëpisë së Habsburgëve dhe sovran i Urdhrit të Qethit të Artë, ish Princi i Kurorës që kishte vdekur hiç më pak veçse në moshën 98-vjeçare.

Simbas traditës, Otto qe vendosur të varrosej në Kriptën Perandorake në Kishën Kapuçinëve në Vjenë, kurse zemra e tij do varrosej një ditë më vonë në Pannonhalma Archabbey në Hungari.

Futem prapë në tualet dhe i përkulur ashtu mbi wc-në allafrënga, lexoja në gazetë sesi kishin ardhur për të marrë pjesë në këtë ceremoni shumë personalitete, mes tyre mbretër ose ish-monarkë. Të gjithë këto dhe të tjerë po ndjekin ndërkaq meshën e Rekuem-it në Katedralen e Shën Stefanit të Vjenës, të kryesuar nga kardinali Christoph Schönborn, e cila do pasohej nga varrimi në Kriptën Perandorake.

Ky do ishte varrimi më i fundit i një Habsburgu mbretëror në Kriptën Perandorake – pas një ceremonie shekullore – ku 145 anëtarë të tjerë të Shtëpisë së Habsburgëve, mes tyre shumë Perandorë të Shenjtë Romakë dhe Perandorë Austriakë, janë varrosur që nga viti 1633.

Parshikimet e protokollit austriak të shtetit ishin se rreth 1000 të ftuar dhe 100,000 vetë do merrnin pjesë në funeralin në Vjenë, i cili gjithashtu do transmetohej drejtpërdrejtë nga Televizioni Austriak.

Si gazetar ndërkombëtar i akredituar, më kishin lejuar që të çaja rrethimin dhe të shkoja direkt aty afër ku do bëhëj varrimi, pra tamam përballë, ku edhe gjendej kjo kafene e mrekullueshme e Vjenës së vjetër.

Dhe ja. Dëgjohet nga televizori i vetëm i klubit se një procesion mbi një kilometër i gjatë po e sjell arkivolin e Otto-s nga Katedralja e Shën Stefanit në Kriptën Perandorake. Spikeri e përsëritë disa herë se ky është «funerali i fundit i perandorit» që po ndodh në Vjenë.

Ndërkaq, e di mirë që nuk është një ndër gjërat më të bukura për të cilat mund të flasim, por të gjithëve mund të na ndodhë që të vuajmë nga diarreja, dhe për ta parandaluar një gjë të tillë, duhet të jemi të informuar mbi shkaktarët kryesorë të saj.

Duhet të dimë se diarreja shkaktohet nga viruset dhe bakteret, por gjithashtu shkaktohet edhe nga lloje të caktuara ushqimesh. Sipas dr. Shilpa Ravella, gastrointerologe dhe pjesë e stafit të Universitetit të Kolumbias, mënyra më e mirë e shmangies së këtij problemi është mbajtja e një ditari ushqimor. Sepse nëse e dini se cili ushqim ju shkakton probleme të tilla, e keni më të lehtë ta shmangni atë dhe problemet që shkakton konsumi i tij.

Sipas Institutit të Shëndetit Kombëtar Amerikan, rreth 50 milionë qytetarë amerikanë mund të jenë alergjikë ndaj qumështit. Nëse keni shqetësime në stomak pasi keni konsumuar një nga nënproduktet e qumështit, atëherë edhe ju jeni një prej tyre.

Gluteni gjithashtu mund të shkaktojë diarje te disa persona. Gjithsesi, për çdo rast sugjerohet që të mbani një ditar ku të shënoni të gjitha ushqimet që konsumoni dhe këshillohet që në shfaqjen e çdo problemi t'i drejtoheni mjekut gastroenterolog.

3.

Otto von Habsburg apo në gjermanisht: Franz Joseph Otto Robert Maria Anton Karl Max Heinrich Sixtus Xaver Felix Renatus Ludwig Gaetan Pius Ignatius, hungarez: Ferenc József Ottó Róbert Mária Antal Károly Max Heinrich Pius Sixtus Renatus i lindur më 20 nëntor 1912 ishte princi i fundit i kurorës së Austro-Hungarisë që nga viti 1916 deri

në shpërbërjen e perandorisë në nëntor 1918. Në vitin 1922, ai u bë pretenduesi i froneve të mëparshme, kreu i Shtëpisë së Habsburg-Lorenës dhe sovran i Urdhrit të Qethit të Artë pas vdekjes së babait të tij. Ai dha dorëheqjen si Sovran i Qethit të Artë në 2000 dhe si kreu i Shtëpisë Perandorake në 2007.

Si djali i madh i Karlit I dhe IV, perandorit të fundit të Austrisë dhe mbretit të Hungarisë, dhe gruas së tij, Zita e Bourbon-Parmës, Otto lindi si Franz Joseph Otto Robert Maria Anton Karl Max Heinrich Sixtus Xaver Felix Renuat Ludëig Gaetan Pius Ignatius von Habsburg, i treti në linjën e froneve, si Archduke Otto i Austrisë, Princi Mbretëror i Hungarisë, Bohemisë dhe Kroacisë. Me ardhjen e babait të tij në fron në 1916, ai kishte të ngjarë të bëhej perandor dhe mbret. Meqenëse babai i tij nuk abdikoi kurrë, Otto u konsiderua nga ai, familja e tij dhe legjitimistët austro-hungarezë si mbreti i ligjshëm perandori që nga vdekja e babait të tij në 1922.

Otto ishte aktiv në skenën politike austriake dhe evropiane që nga vitet 1930, si duke promovuar kauzën e restaurimit të Habsburgëve dhe si një ithtar i hershëm i integritimit evropian; ai ishte një kundërshtar i ashpër i nazizmit, nacionalizmit dhe komunizmit. Ai është përshkruar si një nga udhëheqësit e Rezistencës Austriake. Pas Anschluss-it të vitit 1938, u dënua me vdekje nga nazistët dhe u arratis nga Evropa në Shtetet e Bashkuara.

Otto von Habsburg ishte Zëvendës President (1957-1973) dhe President (1973-2004) i lëvizjes së Bashkimit Ndërkombëtar Paneuropian. Nga viti 1979 deri në vitin 1999, ai shërbeu si deputet i Parlamentit Evropian për Unionin Kristian Social të Bavarisë (CSU). Si një anëtar i sapozgjedhur i Parlamentit Evropian në vitin 1979, Otto tregoi një interes të madh për vendet pas Perdes së Hekurt dhe vendosi një karrige bosh në Parlamentin Evropian për të simbolizuar mungesën e tyre. Otto von Habsburg luajti një rol të dukshëm në revolucionet e vitit 1989, si bashkë-iniciator i Piknikut Pan-Europian. Më vonë ai ishte një mbështetës i fuqishëm i anëtarësimit në BE të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Një intelektual i njohur, ai botoi disa libra mbi çështjet historike dhe politike. Otto është përshkruar si një nga “arkitektët e idesë evropiane dhe të integritimit evropian” së bashku me Robert Schuman, Konrad Adenauer dhe Alcide De Gasperi.

Otto u internua në vitin 1919 dhe u rrit kryesisht në Spanjë. Nëna e tij e devotshme katolike e rriti atë sipas plan-programit të vjetër të Austro-Hungarisë, duke e përgatitur për t’u bërë monark katolik. Gjatë jetës së tij në mërgim, ai jetoi në Zvicër, Madeira, Spanjë, Belgjikë, Francë, SHBA dhe nga viti 1954 deri në vdekje, më në fund në Bavari, në rezidencën Villa Austria. Në kohën e vdekjes së tij, ai ishte shtetas i Gjermanisë, Austrisë, Hungarisë dhe Kroacisë, pasi më parë ishte pa shtetësi de jure dhe de facto, dhe posedonte pasaporta të Urdhrit të Maltës dhe Spanjës.

Në varrimin e tij qenë veshë të gjithë me kostume kombëtare dhe të krahinave nga vinin. Kurse unë nuk di sesi isha veshur dhe as që më binte ndër mend. Në këto çaste vuajtje qeshë shndërruar edhe në numëruesin më të saktë të ëndrrave të mia të perealizuara, çka ma shtonte edhe më shumë vuajtjen.

4.

Nga brenda banjos dëgjova zërin e çambërlenit apo mjeshtrit të ceremonisë, atij që i printe karvanit me një skeptër në dorën e djathtë që po i binte tre herë derës së mbyllur të kishës. E si mund të ishte e mbyllur dera e kishës atë ditë? Nuk po kuptonte asgjë prej kësaj që po ndodhte pak metra larg tij.

Mbas pak u dëgjua një zë i mekur që dilte nga brenda kishës dhe që pyeste me një ton të pafajshëm se kush ishte.

Atëhere çambërleni foli me të madhe se ishte: Princi trashëgimtar i Hungarisë dhe Bohemisë, i Dalmacisë dhe Kroacisë, Sllavonisë, Galicisë, Lodomerisë dhe Ilirisë. Duka i madh i Toskanës dhe Krakovit; Duka i Lorenit dhe Salzburgut, Stirisë, Karinthisë dhe Karniolës e Bukovinës; Princi i madh i Transilvanisë, Margravisë dhe Moravisë; Duka i Silizisë së Epërme e të Poshtme i Modenës, parmës dhe Piacencës, Guastalës dhe Osviesimit, Zatorit dhe Teshenit, Friulit, Dubrovnikut dhe Zarës; Princi i Habsburgëve, Tirolit, Kiburgut dhe Goricies dhe Gradiskies; Princi i Trentit dhe Briksenit; Markezi i Luzatisë së Epërme dhe të Poshtme dhe i Istriës; Konti i Hohenemsit dhe Feldkirshit, Bregensit dhe Sonenburgut; Lordi i Triestes dhe Kotorrit dhe Vindiç Markut; Vojvoda i madh i Serbisë...

Pastaj fill mbrapa u dëgjua sërish zëri i mekur i provincialit të kapuçinëve që nga mbrapa derës, duke thënë se ne nuk e njohim atë.

Atëhere mjeshtri i ceremonisë apo çamberleni i bie prapë derës tre herë. Kësaj radhe, si edhe më parë, është prapë i njëjti zë i mekur që pyet nga brenda se kush ishte apo e përkthyer më saktë se kush dëshëron të hyjë?

Atëhere çamberleni duket se e ngrë zërin edhe më fort duke thënë se ai që dëshëron të hyjë është: Doktor Otto von Habsburg, presidenti dhe presidenti i nderit i unionit paneuropian; antar dhe president i Parlamentit Europian, doktor honoris kauza i shumë universiteteve, qytetar nderi i shumë qyteteve, antar i shumë akademive, bartës i shumë medaljeve të dhëna si shenjë mirënjohje për kontributet e tij për paqen dhe drejtësinë.

Por prap, edhe kësaj radhe, vjen si nga një humbëtirë zëri mjeran i provincialit të kapuçinëve që nga mbas derës: Ne nuk e njohim zotërinë.

Atëhere mjeshtri i ceremonisë, i ftilluar si duket nga dy dështimet e para i bie prapë derës tre herë, kësaj here i sigurtë se do dëgjojë prapë zërin mistik të provincialit të kapuçinëve nga mbas derës, se kush dëshëron të hyjë?

Këtë herë, çambërleni flet po ashtu lehtë, mjaft njerëzisht se ai që dëshëronte të hynte ishte Otto, një dele e Perëndisë, i vdekshëm dhe mëkatar si gjithë të tjerët...

Atëhere zëri i provincialit të kapuçinëve nga mbas derës u bë krejt njerëzor, dukë thënë: Atëhere le të hyjë!

Dhe dera u hap dhe fretërit kapuçinë dolën jashtë dhe u rreshtuan në të dyja anët me qirinj të ndezuar në duar.

Ndërkaq unë dola nga banjoja e kafenesë, krejtësisht i demotivuar. A nuk donte të thoshte e gjitha kjo se, pavarësisht se çfarë ke bërë në jetë, ti në fund do konsiderohesh thjeshtë si një dele dhe kaq? A nuk ishte kjo një thirrje për demotivim? Apo një thirrje për të ndenjur i qetë sa i takon ëndrrave të tua të perealizuara dhe dështimeve të tjera në jetë?

Palermo, 15 prill 2025

GABRIELE D'ANNUNZIO

Shiu në pishnajë

Përktheu: Denis Gila

Práj. N’prag
T’pyllit nuk ndij
Fjalë që i thue
T’Njirit; por ndij
Fjalë tjera t’reja
Që flasin pikla e gjethe
T’largta.
Ndig’jo. Bie shi
Prej reve t’hapërdame.
Bie shi mbi brukët
E njelmta e t’djegme,
bie shi mbi pisha
t’leskërta e t’plota,
bie shi mbi mersina
si hyjnesha, mbi gjineshtra
t’shkëlqimta
me lule t’mbylluna,
mbi dellinja t’denduna
me përkdhelí t’mbushna,
bie shi mbi f’tyrat tona
t’pyjzueme,
bie shi mbi duart tona
t’lakuriqta
mbi teshat tona
t’lehta,
mbi mendime t’freskta
që shpirti shperfaq
t’reja,
mbi përralla t’bukra
që dje
t’rrejtne, që sot m’rrejn
O Hermionë.
A ndin? Shiu bjen
Mbi t’vetmuemen
Barishte
Me nji kërcitje që zgjat
E ndryshon nájër
Sipas degevët
Ma t’shpeshta, ma t’rralla. Ndig’jo. I
përgjigjet
Vajit kanga
E gjinkallave
Që vaji jugor
Nuk frikson
As qielli i përhimtë.
Pisha
Ka nji tingull, mersina
Tingull tjetër, e dëllinja
Prap nji tjetër, mjete
T’ndryshme
Nën t’panumërta gishta.
E t’zhytun
Jena ne në shpirtin
Pyllnor,
me jetë drusore t’gjalla;
e fytyra jote e dehun
është e butë prej shiut
si nji gjethe,
e krifat e tua
naltojnë
t’bardhat gjineshtra,
o krijesë toksore
që mban emnin
Hermionë.
Ndig’jo, ndig’jo. Akordin
E t’ajroreve gjinkalla
Pak nga pak
Ma i mbytun
Bahet poshtë vajit
Që rritet;
por nji kangë përzihet
ma e ngjirrun
që prej atje poshtë ngjitet
nga e njomta hije e hershme.
Ma i shurdhet e ma i zbehtë

Ngadalsohet, e fiket.
Veç nji notë vazhdon e dridhet,
Fiket,
rinjallet, dridhet e fiket.
Nuk ndihet zani i detit
Tesh ndihet mbi t’gjithë degën
T’zhaurijnë
Shiu i argjentë
Që pastron,
Zhaurima që ndryshon
Sipas degës
aq e dendun e aq e padendun.
Ndigjo.
Bija e ajrit
është e heshtun; por bija
E baltës larg,
bretkoca,
këndon në hijen ma t’thellë,
kush e di ku, kush e di ku!
Dhe shiu bie mbi qërpikët e tu,
Hermionë.
Bie shiu mbi qërpikët e tu t’zeza
Saqë duket sikur ti kjanë
Por prej kënaqësisjet; jo e bardhë
Por gati në t’jeshiltë kthye,
Duket sikur prej levores ti del.
E gjithë jeta ndër ne është me freskí
Mbushë,
zemra ngjoks është si pjeshkë
e paprekun,
mes qëpallave sytë
janë si gurrë mes fijeve t’barta,
dhambt n’folé
janë si bajame t’athta.
Dhe shkojmë nëpër shkurnajë
Herë t’ndamë e herë t’pajtueme
(edhe e jeshilta forcë e ashpër
Na lidhe kërcinjtë
Na ngatërron gjunjtë)
Kush e di ku, kush e di ku!
bie shi mbi f’tyrat tona
t’pyjzueme,
E shiu bie mbi f’tyrat tona
T’lakuriqta
mbi teshat tona
t’lehta,
mbi t’frekstat mendime
që shpirti shperfaq
t’reja,
mbi përralla t’bukura
që dje
m’rrejtne, që sot t’rrejn
O Hermionë.



Duhej të kishte kaluar mesnata kur pas një dite të stërlodhur nga puna e mundimshme rashë për të fjetur, edhe pse isha i bindur se nuk do të isha në gjendje të flija. Derisa mendja zuri të sorollatej nëpër një humnerë të zbrazët e të errët, pa dëshirën time m'u kujtua Kron Mati, i cili para një jave ishte gjetur i masakruar në mënyrë të tmerrshme në periferi të qytetit. Para se ta vrisnin njerëzit e pashpirt i kishin shkaktuar dhimbje të llahtarshme duke ia nxjerrë syrin e majtë, duke ia prerë gjuhën dhe krahun e majtë... Mundohesha ta largoja nga mendja trupin e tij të masakruar, po ai më ishte ngulitur në mendje si një gozhde sa më dukej sikur gjendej në një skaj të shtratit, madje shpesh e ndjeja dorën e tij si ma miklonte fytyrën me skofi... Me Kron Matin dikur shtëpitë i kemi pasur afër. Gjatë shkollës fillore dhe të mesme kemi qenë në një shkollë, madje shpesh edhe në një bankë. Edhe në fakultet kemi qenë së bashku. Pas kryerjes së fakultetit ai hyri profesor në një shkollë të mesme, kurse pas gjashtë muajve unë mezi arrita të gjej një vend pune si arsimtar në një shkollë fillore, madje në një fshat malor. Disa muaj pasi përfundoi lufta, te dytë e braktisëm punën me nxënës. Ndoshta do të vazhdonim të punonim edhe më tutje sikur në fushën e arsimit të mos ishte krijuar një kaos i tmerrshëm, të cilin nuk ishim në gjendje ta përballonim. Miku im i dashur u përkushtua në politikë, i bindur se aty mund të arrinte sukses të madh, kurse unë e gjeta rastin t'i kthehem pasionit tim nga koha e studimeve, andaj u angazhova në gazetari. Nga një aktivist i zakonshëm partiak miku im arriti të bëhet kryetari i partisë PPK. Në zgjedhjet e fundit demokratike u zgjodh kryetar i komunës, po ditën e tretë të punës u gjet i vdekur në një korie në dalje të qytetit. Trupi i tij i gjymtuar si mos më keq ishte mbuluar me degë e gjethe të lisave të vegjël. Ndoshta trupi i tij nuk do të gjendej edhe një kohë të gjatë sikur disa kalimtarë të mos i shihnin disa qen endacakë si e copëtonin trupin e tij.

Lajmi për vdekjen e mikut tim të dashur më shkaktoi tronditje në shpirt sa disa çaste më ishte dukur sikur dikush më kishte vrarë me shtatë plumba në kokë. Është dashur të kalonin disa orë derisa mendja më është këndellur pak. Me ndjenja të mpira e shpirt të plagosur i kam telefonuar vëllait të tij, Liksini, i cili është dy vjet më i vogël se Kroni... I di vrasësit e vëllait tim, më tha me zë të përvajshëm pas disa çastesh... Janë në struktura-rat udhëheqëse të partisë rivale, e cila i humbi zgjedhjet... Pse nuk shkon në prokurori t'i denoncosh vrasësit e tij pasi i ke faktet, i thashë derisa vajin nuk isha në gjendje ta frena. Ai lëshoi një qeshje të dhunshme e pastaj më tha: kam qenë në prokurori, po prokurori më ka thënë: vëllai yt është vrarë nga kundërshtarët politikë! Një gjë besoj që e di edhe ti: vrasjet politike nuk janë në mandatin tonë, po në mandatin e ndërkombëtarëve... Shko ankohu te ata nëse mendon se ke fakte... Ndoshta edhe e marrin parasysh rastin e vrasjes së vëllait tënd... Mirëpo edhe ata shumë vrasje nuk janë në gjendje t'i zbulojnë.

E ftova Liksini të vinte në lokalet e gazetës që të bisedojmë më shumë për këtë krim të llahtarshëm... Kam frikë se do të më vrasin edhe mua rivalët politikë të vëllait, më tha me zë të frikësuar... Edhe vetë e kupton çfarë gjendje kaotike është duke mbizotëruar pas luftës në vendin tonë. Kam frikë se kjo gjendje do të përkeqësohet edhe më shumë. Aktivistët e shumtë të PPK-së po vriten e vrasësit nuk po zbulohen. Ndërkombëtarët nuk po angazhohen në këtë drejtim sa duhet. Ata në raste më të shumta po bëjnë vetëm sehir...

Me Liksini kemi biseduar një kohë të gjatë për vdekjen tragjike të vëllait të tij. Në fund i premtova se do të shkruaj një artikull në gazetë, i bindur se dikush do të merrej me zbulimin e autorëve të këtij krimi makabër, i cili shkaktoi tronditje të madhe në skenën politike të vendit... Më mirë mos shkruaj fare për këtë vrasje, më tha i dëshpëruar. Kam frikë se do ta fusësh veten në telashe

BISER MEHMETI

Macja me një sy

Fragment nga romani, "Buzuku", Prishtinë, 2025



të mëdha nga të cilat mund të kesh pasoja tragjike... Dyshoj se pas vrasjes së vëllait qëndron një grup i organizuar kriminal.

Disa minuta pas bisedës me Liksini, derisa qëndroja në lokalet e gazetës, u dëgjua një detonim i fuqishëm sa dyshova sikur ndërtesa po dridhej nga tërmeti i tmerrshëm. Sapo bëra të dal jashtë e të shoh çfarë ka ndodhur, kur në zyre hyri rojtari i ndërtesës Liti. Nga shqetësimi mezi merre frymë. Më vështroi me një shikim të çuditshëm... Është djegur vetura jote, më tha me zërin që i dridhej nga keqardhja... Dikush i ka vënë eksploziv!... Dola jashtë pa frymë. Vetura ime, të cilën e kisha blerë para gjashtë muajve me kredi, ende ishte në flakë... Këmbët m'u prenë në gjunjë e sytë m'u errësuan. Përmes këtij veprimi dikush po ma tërhiqte vërejtjen të bëja kujdes, ndryshe mund të më gjente fati i Kron Matit, i thashë vetes. Edhe dy vetura të tjera që gjendeshin afër veturës sime në parkingun mbrapa ndërtesës kishin pësuar dëmtime të vogla. Vetëm të nesërmen erdhi policia, e cila për pak minuta bëri ekspertizën për djegien e veturës sime. Prita të më thirrën në prokurori për të dhënë deklaratë, po kurrë nuk më thirrën... E dija që autorët e djegies së veturës sime kurrë nuk do të zbuloheshin. Nuk mund ta largoja dyshimin që më hante si një krimb i varrit se veturën time e kanë djegur të njëjtit persona që e kanë vrarë Kron Matin.

Duhej të kishte edhe pak orë derisa nata të davaritej e vendin e saj ta zinte mëngjesi i pazakonshëm kur nga humnera e mendimeve më nxorën disa zhurma të thekshme, të cilat sikur jehonin nga një botë e largët, në të cilën dyshoja sikur isha nisur të shkoja, po që rrugën nuk isha në gjendje ta gjeja. Me sytë e mbushur me copat e një gjumi që dukej sikur më vështronte nga një skaj i dhomës zura të shikoj nga dritarja e dhomës, nga ku dëgjoheshin do krisma të thekshme, të cilat sikur më godisnin në kokë... Vetëm edhe ky shi i ftohtë i kësaj vjeshte që ka ardhur para kohe dhe e cila nuk do të largohet pa më marrë me vete, ka qenë mangut në jetën time, mendova me vete. Disa çaste e kam vështruar shiun që përplasej mbi dritaren e dhomës sime pa ditur pse e bëja një gjë të këtillë. Diçka më thoshte sikur gjatë gjithë ditës shiu nuk ishte ndalur, po vetëm tash e hetoja prezencën e tij. Ndoshta ai shi i çuditshëm për inat timin nuk do të ndalej edhe shtatë ditë të tjera... Eh, dikur kur gjatë natës qëndronim në shtrat duke bërë dashuri me Annikën çfarë kënaqësi të madhe më sillte shiut, thashë me vete edhe pse nuk dëshiroja të thosha asgjë. Ajo kohë më dukej e largët tepër sa disa herë dyshoja sikur nuk

kishte ndodhur në realitet, po në një ëndërr që nuk isha në gjendje ta harroja...

Pas disa minutash përsëri u afrova para kompjuterit e pastaj i thashë vetes me zërin që më dridhej nga do parandjenja ogurzeza: nuk do të heshti përballë këtyre krimeve që po e tronditin gjithnjë e më tepër vendin, të cilit ende nuk i janë tharë plagët e luftës. Ende ka familje që i kërkojnë të dashurit e tyre që nuk dihet nëse janë të gjallë apo të vdekur... Do të shkruaj një artikull për vrasjen e mikut tim Kron Matit! Kam vendosur të mos frikësohem nga pasojat që mund t'i kem. Koha është të tregohem sypatrembur para sfidave të jetës... Disa çaste qëndrova i shtangur, ngase nuk dija nga t'ia filloja. Në kokë kisha një turbullirë të paqartë sa më dukej sikur një zgjuar milingonash sorollateshin tërë kohën duke u ushqyer me mendimet e mia të kalbura...

Nuk vonoi dhe e braktisa dëshirën për të shkruar artikullin në gazetë. Të pamundurën nuk jam në gjendje ta bëj të mundur, mendova... U shtrina në shtrat e pastaj u mundova të flija. Kurrë më parë nuk kisha ndier një luftë të këtillë brenda vetes. Kisha frikë se në fund të asaj lufte do të dilja i humbur, pa asgjë në jetë, mbase edhe i turpëruar... Në një çast, për dreq, m'u kujtua Annika, e cila pas 13 vjet martese u largua prej meje pa kurrfarë shpjegimi. Të kaluarën së bashku e hodhi si një leckë në koshin e mbeturina. Iku prej meje si prej djallit duke më lënë në kthetrat e fatkeqësisë... Sikur të ishte ajo pranë meje do ta ndjeja veten më të qetë, sepse ajo sikur më jepte fuqi sa shpesh si me ironi i thosha: kur je pranë meje jam në gjendje të fluturoj pa krahë, të shoh pa sy e të flas pa gjuhë! Tash kur ajo nuk është pranë meje më duket sikur gjendem në një labirint nga i cili kurrë nuk do të mund të dal i gjallë... Derisa nuk e shkruaj atë artikull nuk do të mund të qetësohem, i thashë vetes derisa e shtrëngoja kokën me duart që më dridheshin nga pesha e shqetësimit...


Sërish jam ngritur nga shtrati i dërrmuar sa disa herë më bëhej sikur isha zgjuar somnambul dhe sikur kërkoja diçka e nuk e dija çka. E hapa dritën e dhomës ngadalë sikur të kisha frikë se përmes saj do të hynte ndonjë hije e panjohur. Me sy gati të mbyllur zura të vështroj shiun që binte ngadalë e prajshëm. Në një çast e ndjeva ajrin e ftohtë si zuri të ma dëbonte peshën e gjumit që më mbështillte si një vello e tejdukshme. Disa minuta e kam vështruar hapësirën që shtrihet para meje si një pikturë e leckosur nga shiu. E gjithë bota ishte kredhur në një heshtje të frikshme, e cila dyshoja se nuk do të përfundonte derisa të kalonte ajo stinë e

ftohtë e në vend të saj të shfaqej një stinë e ngrohtë. Diçka më thoshte sikur vetëm unë në atë interval kohor isha i zgjuar, madje sikur deri në mëngjes do të qëndroja zgjuar, ngase me duart e mia e kisha vrarë gjumin... Nuk më kujtohet pas sa kohësh e mbylla dritaren. Edhe pse nuk dëshiroja të afrohesha te kompjuteri një fuqi e panjohur më ka nxitur të afrohem pranë tij. Derisa e vështroja me sy të zgurdulluar kompjuteri më shëmbëllente në një qenie të gjallë, që më vështronte në mënyrë enigmatike... Nga të filloj shqetësimin tim të mundimshëm nëpër fushën e minuar, i thashë vetes. Të gjitha fjalët si të isha flutura me krahë të thyer fluturonin nëpër hapësirën e mendjes së rënduar. Në një çast më duket sikur ato kanë dalë nga koka ime e pastaj me sytë e vagëlluar i kam parë si shpërndareshin nëpër hapësirën e dhomës së ftohtë akull. Më kaploi dyshimi sikur një acar i madh ishte grumbulluar në shpirtin tim, i cili së shpejti do të shndërrohej në akull... Nëse s'e përfundoj deri në mëngjes këtë artikull do të çmendem, i thashë vetes. E ndjeja një dorë të padukshme si më shtrëngonte në qafë me fuqi të madhe duke dashur të më ngulfaste...

Derisa i shtypja tastet me gishtat që më dridheshin, më bëhej sikur me një kazmë të rëndë e godisja tokën e fortë, e cila lëshonte shkëndija të mëdha... E di se në mes të tjerash kam shkruar: u bënë shtatë ditë që kur kryetari i qytetit Kron Mati, i zgjedhur me votat e lira të qytetarëve, u vra e autorët e vrasjes nuk janë gjetur ende... Ekzistojnë dyshime se vrasësi ose vrasësit janë të njohur për organet e drejtësisë, po qëllimisht fshihen faktet... Ky vend po vlon nga krimi e korrupsioni i organizuar... Kur e përfundova shkrimin m'u bë sikur një shkëmb i rëndë rrëshqiti nga shpirti im...

Sapo jam shtrirë në shtrat për të shtatën herë, i bindur se tash jam i qetë për të fjetur, kur një zë i largët më ka depërtuar në veshin e majtë nga një largësi e pacaktuar: a je i vetëdijshëm se je duke luajtur me jetën tënde!... Nëse e dërgon këtë shkrim në gazetë, do të kesh pasoja të rënda!... Vrasësit e Kron Matit mund të të vrasin edhe ty!... Përsëri e pashë trupin tim si përpëlitej në mes të jetës e vdekjes nëpër valët e detit të tërbuar. Nuk do ta dërgoj shkrimin për botim, këmbëngula... Pasi ma kanë djegur veturën radhën e kam të ma djegin edhe trupin!... Nga ky mendim trupi dhe shpirti m'u rrëqethën. Teksa e sflisja shpirtin për ta ndjell gjumin e arratisur përtej shtatë bjeshkëve, në një skaj të imazhit m'u shfaq Kron Mati, i cili më vështronte me sy të përvajshëm... Të lutem, nxirre të vërtetën nga errësira në dritë, më tha me zë të mallëngjyeshëm... Do ta dërgoj atë shkrim në gazetë edhe nëse më vrasin kriminelët që të kanë vrarë ty, i thashë me zërin që më dridhej nga frika, e cila ishte struktur në një skaj të shpirtit... Frika po e zëvendësonte frikën tjetër edhe më të rëndë.

Në një çast shikimi m'u gozhduar në çarçafin e bardhë, i cili i shëmbëllente një qejfi të leckosur. Nuk e di si ndodhi e i thashë vetes: ngjyra e bardhë e këtij qefini po më shkakton çrregullime të mëdha në kokë... Po më duket sikur dritarja e dhomës është hapur e nga aty shiu depërton brenda e pastaj bie mbi trupin tim... Pas pak në vend të çarçafit me ngjyrë të bardhë jam mbuluar me një çarçaf me ngjyrë të kuqe. Menjëherë më kaploi bindja sikur trupi më ishte mbuluar me gjakun e trupit tim sa fillova të dyshoj sikur një njeri i panjohur, të cilin nuk arrija ta shikoja nga errësira, mendohej të ma këpuste kokën me një thikë të ndryshkur dhe gjatë asaj kohe gjithnjë lëshonte do ulërime të thekshme që u ngjanin ujkut të tërbuar. U ngrita nga shtrati i lemeritur. Një kohë të gjatë kam dyshuar sikur më mungonte koka... Çarçafi i kuq më sjell kob, i thashë vetes. Sërish jam mbuluar me çarçafin e bardhë. Trupi zuri të më dridhej nga të ftohtit. Jam ngritur ngadalë duke shikuar me dyshim në të gjitha anët e dhomës. Diçka më thoshte sikur Annika qëndronte e fshehur në një vend të padukshëm. Më duket sikur në një çast kam arritur të kridhem në kthetrat e një gjumi të rëndë nga i cili dyshoja se nuk mund të zgjohesha as pas vdekjes...



Kjo puna e gjakut, shtyrë deri në vëllazëri, fisnikëri... idolatri..." se jemi një gjak e një sua...se gjaku nuk bëhet ujë... se ..." më kujton një ngjarje me tim kushëri, në kohë të merhumit... edhe një fakt historik që nuk harrohet as sot: që gjaku më shumë se kujtdo, i takon partisë.

Ishim pirë e bërë xurxull.me një litër e ca raki bmv dhe mes bëmash të tjera mes pijetarësh të tjerë, në një lokal zgëqe, harruar a avulluar kujtese a tretur në të tjerë avuj të alkoolit..po ktheheshim së fundmi pas mesnate, për shtëpi...

Aty te kryqëzimi i qendrës me rrugën emërtuar nga ne, Broadway, na u shkrep të thyenim një xham...Natyrisht jo xham dosido dritareje, do ishte zbavitje për rrugaçë të vegjël...deshëm ndonjë xham të madh vitrine...natyrisht jo për të vjedhur ç'kish brenda, se ai që thyem, rezultoi të ish xham vitrine i një ëmbëltoreje, por thjesht për akustikë. Ishte aq heshtur përreth. As ditën e jo më natën...S'pipërinte miza... Kishim nevojë për pak zhurmë...

...Një ministër i brendshëm i asaj kohe i prirur për më shumë kopaçe rinisë së shthurur, besnik deri në vdekje a më i zellshëm se vetë merhumi, i pat tejkaluar udhëzimet e merhumit për trajtimin e rinisë që na u mpref kot nga festivali këngëtar i shpresës për hapje, që u kthye në mbyllje të mëtejshme e deri në terr për artistët...por edhe për ne...Kësisoj ky pat propozuar pas asaj heshtje të përmortshme muzikore post-festival, që edhe prishja më e vogël e qetësisë së shoqërisë tashmë në heshtje varri, qoftë edhe rrugëve, ...madje dhe një pështymë më tym, të konsiderohej "sjellje e padenjë në shoqëri" e të dënohej me jo më ca vjet burg...

...Kësisoj ai xhami që u thye me të madhe tringëllimë, pat bërë shumë zhurmë, (patëm tentuar disa herë me maja çadras, pat rënë shi), e kjo ishte më se e mjaftueshme për ti bërë nja dy vjet burg sipas ligjit të ri...(unë kisha do kohë që isha edhe i papunë e e pata të qartë idenë se veç nenit të sjelljes së padedenjë më mbulonte, përlante, përfshinte, dashamirësisht edhe një nen tjetër për parazitizmin e kësisoj e ardhmja zymltohej më tej...seç kisha dhe ca të dënuar politik nga familja(ju lutem mos u keqkuptoni: nuk po deklarohem i persekutuar...jam tepër vonë e pa përkatësi partiake)...

...Tamam atë çast një si aspirator trush, sikur na i thithi a shklluqi me një të thithur gjithë avujt a alkoolit njëheraz e na ktheu gjithshka në zhgënjendërr a realitet të qartë socialist...

... u shpërndamë vetëtimthi nga dy në një e ua mbathëm me të katërta seicili për shtëpi të vet, njeri drejt Tiranës së re e unë, tjetri, drejt vendlindjes e vendbanimit tim legjendar, Zogut të Zi...

..."Çohu shpejt...çfarë ke bërë kështu..." mu duk sikur mu dëgjua zëri përgjithësisht i butë i tim eti, kësaj rradhe paksa më i fortë... "pata ndjesinë se ishte ende natë e se s'pata fjetur veç ca minuta..." ...koka më dhimbte për tmerr nga rakia e meqë isha dhe i papunë nuk kuptoja se pse më çonin aq herët... ..."ohu më le të fle " i them me bezdi tim eti e kthehem në krahun tjetër... ëndërr të kish qenë a zhgënjendërrishte ende si muzg e dielli nuk pat lindur akoma... duhet të qe 6 e mëngjesit, ishte dimër...

"...çohu ore se ka ardhur policia...kollaj të thyesh xhamin ti..."

...aty u përmenda dhe pashë mu në derë të dhomës së gjumit, babanë me një kapterr(kështu u thoshim ne atëhere policëve...)..."

"çfarë?...për çarë..." pastaj u kujtova dhe u ngrita avash avash... Kapteri dukej i butë e i qeshur "...një sqarim të vogël në polici..." më tha.miqësisht..." pa merak..."

YLLI PANGO

Kushëriri i partisë

tregim



...Më vonë kështu rezultoi se i pat thënë dhe tim eti...

Tek dolëm më futi pak krahun, gati miqësisht dhe ashtu së bashku lamë pas tim atë që më shihte ne qërtim por edhe disi me shpresë duke menduar se do shpejt do kthehesha (fundja një xham ishte)...

(nuk qe e thënë)

Mbrritëm shpejt në rajon të policisë që kishim fatin e kishim jo më shumë se 7 minuta nga shtëpia. I thoshim edhe "ke burg" ...se kush hynte aty futej në ca qeli paraburgimi ku thuhej se palloheshe në dru...Një e tillë qe rezervuar edhe për mua(e unë që ende shpresoja se do në ftonin në ndonjë zyrë ku do më pyesnin gati shoqërisht për xhamin, do më këpusnin ndonjë gjobë e do kthehesha në shtëpi...kapterri pat qenë aq miqsor me mua por sidomos me tim atë....dukej sikur ishin miq...)

...kapteri që ishte dhe sa gjysma ime, por me shumë rrypa kryqëzuar e shtrënguar mbi xhakët blu, më shoqëroi duke më mbajtur butë për krahun nëpër një koridor të ngushtë e terr, pa dritare, derisa më ndaloi para një dërrë të vogël metalike, e hapi, më shtyu...kësaj rradhe jo butë por me egërsi brenda...e pastaj si i vuri një si lloz nga jashtë, e kyçi me një kyç të madh që kërkëlliu e së fundmi ulëriti i qetësuar: "...ashtu de...futu në burk(më kujtohet mirë, tha "burk" e jo burg) qen..."

Aty kuptova se tërë rrugës kish pasur frikë se mos i ikja a bëja ndonjë proçkë tjetër...U ndjeva vërtet krenar, si një kriminel i regjuri, për frikën që i pata shkaktuar..."Shih sa pak mjafton", mendova, "veçse një hap, një xham, një nen, për të kërcyer e gjendur si me magji, nga njera botë e zakonshme në një botë tjetër: atë të kimit të regjur..."

Pat pasur të drejtë ai shoku e miku i popullit, ministër i brendshëm me atë nenin...

...Siç mora vesh në vonë kushëririn tim e patën kapur në bulevardin e madh, mu tek ura e madhe. Lehtaz fare. Tek pullë. Nuk gjendej këmbë njeriu aty në atë orë të natës...shquhej së largu...

Unë kisha patur fatin që patrulla e policisë ish hedhur në një nga rrugët e tjera që dilnin nga qendra e shpërndaheshin drejt periferisë, por jo në atë që çonte në Zog të Zi e më tej në Laprakë...

Por fati im i vërtetë qe fshehur diku tjetër. Kushëriri im i një gjaku, pat kallzuar heroikisht, pa më të voglin hezitim, saktësisht, besnikërisht, pa as edhe një pincë nën thonj, vezë të zjera nën sqetull, varje me kokë poshtë, madje pa as edhe një shpullë, ngjarjen kriminale me autor mua. Kish përshkruar me hollësi aktin madje dhe tentativën e tij për të më këshilluar të mos e bëja. Kish analizuar saktë dhe armën e krimit: çadër kineze me majë hekri...dhe së fundmi treguar me përpikmlri adresën e saktë të shtëpisë time kuvli gjithsej 35 m katror, duke mos harruar për saktësi edhe se mbrapa nesh ndodhej një fushë drush dhe se komshi me mua jetonte një kapterr që mund tu jepte të dhëna edhe më të sakta për familjen tonë kriminale. Më vonë mora vesh se për këtë, kushon e patën përgëzuar edhe në lagje publikisht...e propozuar edhe për dekorim...

...Po këto i mora vesh shumë në vonë, kur pasi pata nisur udhën e pasosur të krimit, vijova më tej me nene e burgime të tjera konsektive shtesë, duke i dhënë fund udhës time kriminale veçse aty nga mesi i moshës së tretë, kur erdhi demokracia e kur unë pasi pata dalë edhe takova hetuesin tim të parë duke u qethur rastësisht ne mua në të njëjtën berberhane...

...ai më tregoi...po këtë do u a rrëfej në një puntatë tjetër...

..."pse shet mend e nuk na flet...apo se je bërë pishtar demokracie?

më qesëndisi..."...apo harrove se prej meje shpëtove e bëre aq pak burg...të të kish rënë ndonjë hetues tjetër, do ishte kalbur tërë jetën...

"Mor për atë të falënderoj", i them unë me përunjësi shembullore..." por sa i takon pishtarit, më ke ngatërruar", i them, "është im kusheri... pishtar demokracie...me dekret." i them..."Ay që më kallzoi te partia... Une nuk jam vecse fitil...në fikje..."

"...500 lek..." tha pastaj.. "ja fale kot atij mut shteti(po fliste hetuesi i partisë-shteti!)... i kishim ngrene pula, ç'budalla," ...Ish hetuesi, tash pensioner i ndershëm... ishte një lloj tullaci me një si push të hollë zogu në kokë...fort i brishtë e pa të keq në dukje..." ...pata harruar tu shtoj se veç burgut pata paguar edhe një gjobë, vleren 500 lek (të aso kohe) për xhamin e thyer..."

NDAHEN

ÇMIMET E

PANAIRIT

"LIBRI TË BAN TË LIRË"

Me datë 7 qershor, u mbyll edicioni i parë i panairit "Libri të ban të lirë", organizuar nga Katedralja në qytetin e Shkodrës. Pas dy ditëve plot aktivitete, me promovime dhe lexime autoriale, komisioni organizativ i Panairit ndau edhe katër çmime, duke vlerësuar kontributin e pikasur në fusha të ndryshme.

Kështu, çmimi "Shkrimtari ma i mirë" u dha për Ndue Ukajn me motivacionin: *për kontributin e vazhdueshëm në zhvillimin e letërsisë bashkëkohore shqipe në Kosovë dhe mbarë botën shqiptare, me një estetikë të re dhe tematika të mprehta shoqërore.*

Çmimi "Përkthyesi ma i mirë" u dha për Xhelal Fejzën me motivacionin: *për punën e palodhur për përhapjen e letërsisë së rajonit në gjuhën shqipe dhe ndërtimin e urave të komunikimit kulturor mes vendeve të Ballkanit.*

Çmimi "Studiuesi ma i mirë" u dha për Robert Prendushin me motivacionin: *për hulumtimin dhe analizimin e rrënjëve të muzikës dhe koreografisë shkodrane ndër shekuj.*

Mirënjohja e Panairit u nda për Lekë Tasin, *si shembull jete dhe veprë për artistët dhe shkrimtarët e rinj shqiptarë.*

Ky panair, organizim krejt i pavarur nga çdo institucion publik, iniciativë e ndërmarrë nga Stefan Çapaliku, Andreas Dushi dhe Gjovalin Çuni dhe e bështetur nga ana logjistike prej Katedrales dhe Famullisë së "Zojës së Shkodrës", shënon kështu fillimin e një tradite në qytetin e Shkodrës, duke krijuar një hapësirë të re promovimesh dhe diskutimesh për letërsinë shqipe dhe botën e librit shqip në përgjithësi.

Katedralja e Shkodrës organizon në mjediset e veta

panairin e parë të librit

"LIBRI TË BAN TË LIRË"

me pjesëmarrjen e rreth 20 botuesve

nga Shqipnia dhe Kosova

Me dataf 05-07 qershor 2025
Hapja në ora 18.30
Në oborrin e Katedrales së Shkodrës

prezantime
libra
autorë
përkthyes
lexime publike

Njëherë, në një prej dhomave të rezidencës së Jasnaja Poljanës, u zhvillua një bisedë e çuditshme. Një grua jo fort e bukur, me tipare të forta fytyre, i dorëzonte një vajze të re, simpatike, pako të trasha me para.

“E di që ju e dashuroi atë, por nuk keni para. Ja, kjo është dhurata për martesën tuaj”, - i tha ajo gjithë gëzim.

Shoqëruesja e bukur shtriu dorën me turp. Nuk mund të besonte fatin e saj!

Po kush ishte kjo bamireshë bujare, kjo zonjë misterioze? Ishte princesha Maria Volkonskaja, e cila deri atëherë mbante mbi supe hijen e beqarës së lashtë, një nofkë që ia kishte ngjitur koha dhe shoqëria.

Nëse atë çast, asaj do t'i thoshin se do të bëhej nënë e shumë fëmijëve dhe se njëri prej djemve do të konsiderohej gjeniu i letërsisë ruse, ajo nuk do ta besonte kurrë. Megjithatë, shtatë vjet pas ngjarjeve të përshkruara, Maria do të lindë një djalë që do të bëhet shkrimtari i madh rus, Lev Nikolajeviq Tolstoj.

Pse nuk ekziston asnjë portret i saj?

Në biografinë e Maria Nikolajevna Volkonskajas ka aq shumë pika të errëta, sa herë-herë duket sikur ato nuk janë rastësi. Për shembull, nuk është ruajtur asnjë pamje e plotë e saj. Tolstoj e shpjegonte këtë me faktin se nëna nuk donte të pozonte për portret, sepse nuk dille mirë në to dhe, në përgjithësi, ishte e pakënaqur me pamjen e saj.

Nëna e Tolstoit, gruaja misterioze që u bë nëna e një gjeniu

Përktheu Bujar Hudhri

Ky shpjegim duket paksa i çuditshëm. Sepse po vetë Tolstoj e përshkruan nënën si një njeri me mirësi dhe durim engjëllor, për të cilën mbi të gjitha kishte anë shpirtërore. Pse atëherë nuk mund të pranonte me durim pamjen e vet? Sidomos kur nuk bëhej fjalë për ndonjë shëmtim apo defekt fizik, por thjesht për faktin që nuk ishte aq e bukur.

Megjithatë, një imazh i Maria Volkonskajas na ka mbërritur deri sot. Ai është një portret modest, ku shfaqen dy silueta të zeza vajzash. Nën profilin e majtë, Tolstoj shkroi “Nëna ime” dhe e vulosi me firmën e tij. Maria ishte bija e një gjenerali të pasur, megjithatë, gjatë gjithë jetës së saj

është ruajtur vetëm kjo pamje fëmijërore e saj, dhe që për më tepër nuk është vetëm, por së bashku me kushërirën e saj.

Pse, edhe pasi u bë grua dhe nënë, nuk bëri të paktën një portret familjar? Mund të ketë shumë shpjegime. Për shembull, ndoshta, sepse nuk ishte aspak ajo vajza e thjeshtë dhe e përlurur që mendohet zakonisht, por i jepte më shumë rëndësi pamjes së jashtme sesa çmendohet. Një version tjetër, që mund të duket i çuditshëm, por mund të pranohet; princesha Maria që nga rinia mund të ketë pasur një sëmundje nervore, e cila do të ndikonte më vonë gjithashtu në shfaqjen e fobive të ndryshme tek ajo.

Në shtëpinë plot gëzim të familjes Trubeckoj

Hulumtuesit shpesh kalojnë pa u ndalur mbi periudhën e hershme të jetës së Maria Volkonskajas, megjithëse ajo pati një ndikim të madh në formimin e karakterit të saj. Zakonisht shkruhet se ajo u rrit nga një baba i rreptë dhe i ashpër, i cili u kujdes për një edukim të mirë në shtëpi, por e bëri atë një grua të thjeshtë, të përlurur dhe të tërhequr nga shoqëria. Megjithatë, shpesh harrohet se në fëmijërinë e hershme Maria u rrit në kushte krejt të tjera.

Maria Volkonskaja lindi më 10 nëntor 1790 në Jasnaja Poljana. Pas dy vjetësh, nëna e saj solli në jetë një vajzë tjetër, por që nuk jetoi shumë gjatë. Motra e vogël jetoi pak dhe iku gjithashtu pas nënës. Kështu, Maria mbeti vetëm me babanë, gjeneralin autoritar Nikollaj Sergejeviç Volkonskij.

Vitet e para, babai pothuajse nuk e pa vajzën e tij. Ai vazhdonte karrierën ushtarake, ndërsa Mashën e la tek të afërmit e saj nga ana e nënës. Deri në moshën 9-vjeçare, ajo u rrit në shtëpinë e xhaxhait të saj, Ivan Trubeckoj. Shtëpia e famshme e familjes Trubeckoj ishte shumë ndryshe nga rezidenca hijerëndë e gjeneralit. Atje shpesh organizoheshin vallëzime dhe mbrëmje teatrale. Në atë shtëpi vinin muzikantë dhe shkrimtarë të njohur.

Duhet të mendojmë se Masha kishte mall për atmosferën e hareshme të shtëpisë së Trubeckojve, kur babai e mori përsëri me vete në Jasnaja Poljana. Por vitet e fëmijërisë nuk kalojnë pa lënë shenja. Më vonë, duke jetuar me babanë, ajo u mësua të mbante maskën e një zonje të mbyllur dhe modeste, por brenda vetes mbeti e gjallë dhe një natyrë e zjarrtë.

Një episod i veçantë është karakteristik në këtë kuptim, i përmendur nga Tolstoj në ditarët e tij. Ai shkruan:

“Mamaja tregonte përralla shkëlqyeshëm, por vetëm në errësirë; në dritë kishte turp.”

Maria, e shoqërueshme dhe natyrshëm e talentuar, ishte aq shumë e ndrydhur nga babai, sa edhe pasi ai vdiq, kishte turp t’u tregonte në dritë përralla fëmijëve të saj. Për dhuntinë e saj të mrekullueshme si rrëfimtare flisnin edhe shoqet e ngushta të saj.

Lev Tolstoj, përpiquej në çdo mënyrë të zburonte historinë familjare, shpesh duke idealizuar shumë të afërmit e tij. Për shembull, ai kurrë nuk e pa gjallë gjyshin e tij, Nikollaj Volkonskij, por shkruante për të “një njeri jashtëzakonisht i zgjuar dhe i talentuar.”

Sipas shkrimtarit, gjyshi ishte njeri i rreptë, por i drejtë.

“Unë kurrë nuk kam dëgjuar histori për ashpërsinë apo ndëshkimet e tij... Kam dëgjuar vetëm lavdata për zgjuarsinë, drejtimin dhe kujdesin që kishte ndaj fshatarëve.”

Në këto fjalë të shkrimtarit shihet një përpjekje për të justifikuar gjyshin e tij, i cili për shumë të tjerë dukej në një dritë krejt tjetër. Bashkëkohësit e tij vërejtën se Nikollaj Volkonskij ishte njeri sarkastik, nuk duronte aspak kundërshtimin dhe krijonte një përshtypje të pakëndshme tek të tjerët. Thuhej se ishte ai që largoi të gjithë mëtonjësit e mundshëm për vajzën e tij, dhe kështu, gati e la pa martua..

Maria Volkonskaja mbante ditarë

Një pjesë e tyre është ruajtur deri sot. Në to ajo shkruante se ndonjëherë jeta e saj bëhej kaq e padurueshme, sa e kaplonin mendimet për vetëvrasje. Sigurisht, ajo e donte shumë babanë e saj dhe kurrë nuk do të vepronte në atë mënyrë, por jetesa me të ishte një provë e rëndë.

Me moshë, karakteri i babait vetëm



Portreti i nënës së Tolstoit dhe i kushërirës së saj.

Nën profilin e majtë, Tolstoj shkroi “Nëna ime” dhe vulosi me firmën e tij.



Princi Nikollaj Sergejviç Volkonskij, gjyshi i Lev Tolstoit

përkeqësohej. Ai kërkonte nënshttrim të pakushtëzuar dhe mund të zemërohej për arsye të kota. E vërteta ishte se ai me të vërtetë e donte vajzën e tij, por në këtë dashuri kishte shumë kontroll prej babai, që herë pas here kalonte në despotizëm.

Çfarë karakteri kishte ajo? Lev Tolstoj e adhuronte nënën e tij, por praktikisht nuk e njohu, sepse ishte vetëm dy vjeç kur ajo ndërroi jetë. Nga ditarët, letrat dhe kujtimet e tij përftohet një imazh idealizuar i nënës, i bukur, por që pak ngjan me realitetin – si një statujë mermeri, jo si një njeri i gjallë.

Nipërit e Tolstoit kujtonin se në familjen e tyre kishte një të ashtuquajtur kult të Marias Volkonskajas. Lev Nikolajeviči e përshkruante atë si një qenie të mbinatyrshme, thjesht një engjëll në mish dhe kocka. Ai shpesh theksonte besimin e saj fetar, përlësinë dhe durimin.

Por, a ishte në të vërtetë nëna e tij kështu? Nga faqet e letrave dhe shënimeve të ditarit të Marias del një imazh pak më ndryshe. Ajo padyshim ishte një njeri i mirë dhe i kujdesshëm, por kishte një mendje të gjallë dhe analitike — herë-herë në fjalët e saj ndjehet edhe një ironi e hollë.

Ajo kishte edhe ambicie të caktuara. Merrej me krijimtari letrare — shkruante poezi, përralla, novela dhe madje edhe shkrime pedagogjike. Maria Nikolajevna hartoi një program edukimi për fëmijët në frymën e mendimtarit të pavarur dhe iluministit Jean-Jacques Rousseau, që padyshim dëshmon për pikëpamjet e saj përparimtare.

Maria mund të ishte edhe kokëfortë — për shembull, në kundërshtim me mendimin e të afërmeve, ajo i dha shoqërueses së saj 75 mijë rubla. Kjo ishte një shifër jashtëzakonisht e madhe për kohën! Një akt i tillë i pabesueshëm bujarie ngjalli zhurmë në të gjithë shoqërinë e lartë. Madje filluan të thonin se princeshë Marias i kishte ikur mendja.

Duket se prirja për krijimtarinë letrare, pak ekscentrizëm dhe madje dashuria për Rousseau, Tolstoj i trashëgoi pikërisht nga nëna.

Martesa e pabarabartë

Gati gjithçka që Tolstoj tregonte për nënën e tij e mësonte vetëm nga të afërmit e saj. Ata të gjithë në një zë pohonin se martesa e saj ishte “jashtëzakonisht e lumtur”. Ata madje insistonin fort në këtë version.

Pse ishte kaq e rëndësishme për ta? Sepse ata vetë e kishin organizuar këtë martesë.

E gjitha nisi kështu: kur në hisen e princeshës 31-vjeçare Maria Volkonskaja ra një pasuri e madhe, të afërmit e saj u përfshinë menjëherë. Maria ishte e sigurt se nuk do të martohej kurrë, ndaj ndante bujarisht trashëgiminë e madhe që kishte marrë nga babai.

Veprimet ekscentrike të Marias i trembnin të afërmit, të cilët vendosën ta martonin me nxitim.

Mendonin: një princeshë jo e bukur, që tashmë të gjithë e shikonin si “beqare e lashtë”, martohet me një oficer të bukur dhe të hijshëm. Ajo ishte 32 vjeçe, ai 28.

Në ditët tona kjo diferencë moshe nuk do të shqetësonte askënd, por në shekullin e 19-të kjo martesë dukej e pabarabartë

Nikollaj Tolstoj e kaloi rininë e tij pa e vrarë mendjen, ishte një lojtar i pasionuar dhe një aventurier. Në moshën 28-vjeçare, pothuaj ndodhej në prag të falimentimit. Vetëm një martesë e favorshme mund ta shpëtonte nga turpi.

Martesa me Marian i dukej një zgjidhje shkëlqyer. Nga babai, princesha kishte trashëguar toka të mëdha, qindra bujkrobër dhe shumë para. Ai pothuajse nuk kishte asgjë në dorë. Pasuria familjare e kontit Nikollaj Tolstoj, Nikolskoe-Vjazemskoe, ishte shitur për të shlyer borxhet.

Ata u martuan më 9 korrik 1822 në kishën e fshatit Jasenevë. Ajo kishte mbi 800 bujkrobër, ndërsa për të thuhet se “nuk kishte asnjë”.

Menjëherë pas martesës, gjërat për kont Nikollajin u përmirësuan. Ai filloi të shlyente borxhet dhe më vonë, duke shitur shtëpinë e gruas në Moskë, bleu përsëri pronën e tij që e kishte pasur trashëgim.

A ishte Maria e lumtur në martesë?

Sipas legjendës familjare, martesa mes Marias Volkonskajas dhe Nikollaj Tolstoit filloi si një marrëveshje interesi, por përfundoi si një idil familjar. Kjo version përsëritet pafundësisht në pothuajse të gjitha biografitë e Tolstoit.

Por, a ishte kjo me të vërtetë kështu?

Ka shumë mundësi që Nikollaj Tolstoj të ndihej tepër mirënjohës ndaj gruas së tij, por a arriti ta donte atë vërtet? Shumë studiues shmangin me kujdes faktin se para martesës, Nikollaj ishte i dashuruar në kushërirën e tij të tretë, Tatjanën. Dhe kjo nuk ishte thjesht një dashuri kalimtare. Ata ishin rritur në të njëjtën shtëpi dhe mes tyre kishte gjithmonë një lidhje të fortë që vetëm forcohej me kalimin e viteve.

Tatjana refuzoi propozimin e Nikolas për martesë. Ajo ishte një vajzë e zgjuar dhe e kuptonte se ai kishte nevojë për një rast më të favorshëm. Pak kohë më vonë, ai u martua me Mari-n.

Por Tatjana gjithmonë ishte aty pranë. Ajo arriti madje të krijonte miqësi me gruan e Nikollajt dhe me kënaqësi merrej me fëmijët e tij. Çfarë ndjente në këto momente Maria? Me fjalë, ajo ishte plot miqësi, por brenda saj e gërryente një xhelozia e fortë.

Një arsye tjetër për brengë ishte se burri shpesh mungonte në shtëpi. Ai nuk u shërua kurrë plotësisht nga prirja për alkool dhe lojëra fati, edhe pse u bë shumë më i matur në pasionet e tij.

Gjatë tetë viteve të martesës, Maria i solli burrit pesë



Konti Nikollaj Iljiç Tolstoj, babai i Lev Tolstoit

fëmijë — katër djem dhe një vajzë. Fëmija i katërt ishte Lev Tolstoj — i lindur në vitin 1828.

Shtatzanitë e shumta e dëmtuan rëndë shëndetin e saj tashmë të brishtë. Në vitin e fundit të jetës, ajo vuante nga një sëmundje nervore.

Vdekja e parakohshme

Motra e Tolstoit më vonë shkruante se nëna kishte ndërruar jetë nga një inflamacion i trurit. Ajo lexonte libra duke i mbajtur kokëposhtë, thoshte “Zoti di çfarë” dhe në përgjithësi sillej mjaft çuditshëm. Sipas fjalëve të vajzës, kjo ishte pasojë e një lëndimi në kokë që nëna kishte marrë kur e tundnin në lisharës.

Por vajza nuk mund të mbante mend nënën e saj, e cila vdiq pak pas lindjes së saj. Historia me litarët duket mjaft e çuditshme, prandaj shumë të tjerë preferojnë versionin që nëna e Tolstoit vdiq për shkak të pasojave të lindjes së vështirë.

Gjithashtu nuk mund të përjashtohet mundësia që sëmundja nervore e Marisë kishte nisur të zhvillohej shumë më përpara. Atëherë gjithçka bëhet më kuptimplotë – frika për t’u parë në portrete, frika për të treguar përralla në dritë, dhe sjellja e çuditshme e saj që vërehej nga shumë njerëz.

Është krejt e mundshme që shpirti i brishtë i Marisë nuk mundi t’i përballojë vuajtjet. Fillimisht, për shumë vite ajo e ndrydhte natyrën e saj të gjallë, për të sakrifikuar veten për babanë. Më pas, ajo duhej t’i përgjigjej rolit të gruas dhe nënës shembullore, duke mbyllur sytë ndaj dashurisë së burrit për një tjetër dhe duke u munduar të mos i kushtonte vëmendje talljeve që thuheshin në shoqëri për shkak të martesës së tyre jo të barabartë.

Në romanin “Lufta dhe paqja”, Tolstoi do të mishërojë imazhin e nënës në figurën e Maria Bolkonskajas. Ndërsa në figurën e Nikollait Rostovit dallohen qartë tiparet e babait të tij. Në roman linjat e këtyre personazheve përfundojnë mirë – ata janë të lumtur në martesë, kanë tre fëmijë dhe presin të katërtin. Nikollai është shndërruar në një pronar të kujdesshëm dhe madje ka arritur të shumëfishojë pasurinë e tij.

Në realitet, historia familjare përfundoi ndryshe — tetë vjet pas martesës, Maria vdiq. Ajo ishte vetëm 39 vjeçe. Babai i Tolstoit i bëri sërish propozim për fejesë kushërirës së tij, Tatjanës. Edhe këtë herë ajo refuzoi të bëhej gruaja e tij, por pranoi të kujdesej për fëmijët e tij deri në fund të jetës.

Kështu ndodhi në fakt. Tatjana Jergolskaja u bë një nënë e dashur për të gjithë fëmijët e tij dhe nuk i la as kur ai ndërroi jetë.

Nikollaj i mbijetoi gruas së tij, Marias, vetëm shtatë vjet. As ai, as ajo nuk e mësuan kurrë se djali i tyre Lev do të bëhej një shkrimtar i madh.

Lev Tolstoj idealizonte nënën, duke e paraqitur atë si një engjëll të gjallë. Por ajo ishte njeri i gjallë — me dobësitë, mangësitë, frikërat dhe dyshimet e veta. Nga kjo, nëna e tij nuk bëhet më pak e vyer, përkundrazi, bëhet më prekëse dhe më njerëzore. Figura e saj e ndritshme e përshkoi shpirtin e shkrimtarit dhe e ndihmoi në momentet më të vështira. Megjithëse ai, pothuaj nuk e njohu nënën gjatë jetës, gjithmonë e ndjente praninë e saj të padukshme.



Personazhi i Maria Bollkonskajas nga filmi “Lufta dhe Paqja”, që mishëron nënën e Tolstoit



Rita Petro

Născută cu picioarele înainte

Traducere de LUAN TOPCIU

